



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



T R A N S K R I P T

i mbledhjes së tetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 30.10.2014, e cila filloi në orën 10:00.

Kryesuesi: I lutem sekretarisë, të konstatojnë prezencën e këshilltarëve komunalë për këtë mbledhje.

Të nderuar,

Para se të fillojmë me rendin e ditës, më lejoni të përshëndes, në radhë të parë, Kryetarin e Komunës së Prishtinës, z. Shpend Ahmetin, nënkryetarin dhe stafin e Kryetarit, të gjithë drejtorët e drejtorive, ju përshëndes juve të nderuar këshilltarë, ju të pranishëm, po shoh të OSBE-së, të KFOR-it, nëse janë këtu, përfaqësues të mjeteve të informimit dhe të gjithë ju prezent!

Më lejoni të hapi mbledhjen e tetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, me këtë rend dite.

Para se të fillojmë me rendin e ditës, kërkoj falje se nja tri pika nuk janë të parapara në rendin e ditës, mirëpo për shkak të ngutësisë, na duhet gjithsesi t'i shqyrtojmë, por me lejen e juaj.

Nën një, është arsyetimi i pikave, pse duhet të jenë për këtë mbledhje e ju nuk e keni marr materialin. E lus Kryetarin e Komunës që të japë sqarime.

Shpend Ahmeti: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kuvendit komunal,

I kemi disa propozimndryshime të rendit të ditës. E para, është pika numër 3, Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshime në Planin rregullues të lagjes "Mati 1", në Prishtinë, ta tërheqim nga rendi i ditës, për shkak se kjo është bërë në rend të ditës me shpejtësi, në mënyrë që të zhblllokohet puna në rrugën "Enver Maloku" për shkak të një marrëveshje e cila është bërë qe një kohë. D.m.th., vitin e kaluar është bërë një marrëveshje me një pronar të tokës atje, e cila marrëveshje ka qenë në kundërshtim me Planin rregullues, mirëpo në fund ajo marrëveshje nuk është bërë, por në përgjithësi vendimi për shpronësim ka qenë gati, edhe i nënshkruar nga Kryetari, Isa Mustafa. Pasi nuk ka marrëveshje, ne kemi vendosur me vazhduar me shpronësim dhe nuk ka nevojë për ndryshimin tani, ndryshimi i planit rregullues "Mati 1" shkon në procedurë të rregullt kur t'i vije koha.

Faqe 1 nga 100

Pika e dytë, që dëshirojmë ta fusim në rend të ditës, është një çështje që e kemi diskutuar që një kohë të gjatë, edhe në KPF e kemi diskutuar, ka qenë rishikimi i buxhetit, i cili ka kaluar në Kuvendin komunal, mirëpo nuk ka pasur rishikim në Kuvendin e Kosovës, prandaj kemi përgatitur kërkesë për Ministrinë që të na aprovojë lëvizje deri në 15%, në bazë të atij vendimi për rishikim. Kemi menduar se mundemi pa kaluar në Kuvend edhe një herë, vetëm me vendim të KPF-së. Unë e kam takuar ministrin Beqaj të hënën, kam kërkuar që a bënë kështu me KPF, ai ka thënë se nuk ka bazë ligjore, prandaj e kemi sjellë në Kuvend atë vendim të KPF-së, që tash të kalohet në Kuvend me pajtim të të gjitha grupeve parlamentare.

Dhe, të tjerat që kanë të bëjnë me lokacionet, për dy shtatore, njëra është shtatorja e Osman Dumoshit, që tash është në diskutim pothuajse që shtatë vite, dhe me kërkesë të Shoqatës së të Burgosurve, kanë kërkuar që me procedurë më të shpejtuar, të mund ta vendosim për këtë 28 Nëntor që po vjen. Unë mendoj që, së paku një vendim politik, do tua sqaroj edhe lokacionin, ka qenë lokacioni i fundit që është kërkuar nga Shoqata e të Burgosurve tek Universiteti i Prishtinës. Kjo është njëra pikë dhe, e dyta, është kërkesa e intelektualëve të Vlorës. Pas një diskutimi që kemi bërë me disa, edhe me këshilltarin e Presidentit, Bujar Leskaj, që ka qenë përpara, na ka ardhur për vendosjen e shtatores së Ismail Qemajlit në Prishtinë. Kjo iniciativë qenka marr që një kohë të gjatë dhe të premtën e kaluar Këshilli Bashkiak i Vlorës, ka marr vendim që ne ta vendosim shtatoren e Hasan Prishtinës në Vlorë, ndërsa në anën tjetër të vendoset shtatorja e Ismail Qemalit në Prishtinë. Kjo kërkesë tash, përmes Ambasadës së Shqipërisë ... në mbledhjen e tetorit.

Prandaj, po kërkoj mirëkuptim që këto pikat të cilat i përmenda, ta ndryshojmë rendin e ditës. E di që ka shqetësime për pikën nr. 8, po ua lë grupeve parlamentare, le të deklarohen se a duan ta shqyrtojnë këtë apo jo, ka ardhur me vonesë nga projekti i Gërmisë, që është i financuar nga Komisioni Evropian, që po ju duhet një studim, i cili nënkupton një shumë prej 15.000 € që është një subvencionim. Po e them, nëse nuk ka gatishmëri, tërhiqet edhe kjo, ka ardhur kërkesa e tyre me urgjencë, por le të deklarohen grupet parlamentare se si po duan.

Nuk është se jemi duke insistuar me e futur këtë pikën numër 8, por le të diskutohet dhe të vendos vetë Kuvendi se a duhet.

Kryesuesi: Faleminderit, Kryetar!

Për këtë mbledhje është propozohet ky

REND DITE:

1. **Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë;**
2. **Propozimvendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetore, për vitin 2014;**
3. **Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Propozimplanit për ndryshimin dhe plotësimin e Planit rregullues të lagjes "Sofalia" në Prishtinë;**
4. **Shqyrtimi i Raportit financiar tremujor, për periudhën korrik – shtator 2014;**

Faqe 2 nga 100

5. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim Policisë së Kosovës;
6. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit në fshatin Hajvali;
7. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e përmendores së Ismail Qemajlit;
8. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e përmendores së Osman Dumoshit;
9. Propozimvendimi për ndërtimin e lokaleve afariste me partneritet publiko - privat;
10. Propozim vendimi për subvencionimin e mjeteve financiare për studimin e natyrës në Parkun e Gërmisë;
11. Propozimrregullorja për hapjen e kutive të ankesave;
12. Informatë për zgjidhjen e rastit të pronave në lagjen "Dodona";
13. Informatë për fillimin e procesit edukativo - arsimor 2014- 2015;
14. Informatë rreth mbjelljeve vjeshtore;
15. Pyetje dhe përgjigje
16. Të ndryshme.

Propozuam që ta heqim pikën e katërt nga rendi i ditës.

A jeni për me hequr?

Numëroni votat, ju lutem!

Pra, shumica janë që të hiqet pika, Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshime në Planin rregullues të lagjes "Mati 1", në Prishtinë.

Tani pyes anëtarët e Kuvendit, kush është që të punojmë me këtë rend të ditës?

Ju lutem, me ngritje të dorës.

Fjalën e ka Shefki Gashi!

Shefki Gashi: (Për shkak të mosdëgjimit të diskutimit, nuk ka mundur të jepet transkripti.)

Kryesuesi: Mirë, pra, faleminderit!

Arsyetimet i patëm se pse i shtimë këto pika të rendit të ditës.

Faleminderit!

Urdhëro, Sami!

Sami Hamiti: Faleminderit, Kryesues!

Pasi po dal për herë të parë,

Përshëndes Kryetarin,

Nënkryetarin,

Stafin dhe kolegët e mi asamblistë,

Po ashtu edhe përfaqësuesit e mediave, të cilët monitorojnë këtë mbledhje!

Unë desha vetëm të jap disa, për plotësimin e rendit të ditës, sepse ishim te lokacioni i dy shtatoreve, duhet ta përmendim se për shtatoren e Osman Dumoshit, ekzistojnë

edhe pëlqimet, sepse ajo punë ka shkuar deri në procedurën e vendosjes në Kuvend, kurse për shtatoren e Ismail Qemalit, në parim të vendoset. Pasi që ekzistojnë këto marrëveshjet, në parim të vendoset si lokacion dhe të kërkohet pëlqimi, pasi që është brenda pjesës së Universitetit.

Pjesa tjetër, për rishikim, këtë që e përmendi, është e vërtet që ne e kemi trajtuar, është një çështje ligjore që, pasi që Kuvendi i Kosovës nuk ka mbajtur mbledhje me e rishikuar buxhetin, ekziston ai vendimi i Ministrit që, brenda kornizave, brenda 15%-it, dhe mendoj se është obligim ligjor, dhe nuk kemi asgjë kundër, sepse është brenda kornizave të asaj që e kemi vendosur në Kuvend.

Është e vërtet që është bërë pak, Shefkiu këtu po e përmend, është e vërtetë, prandaj edhe dola të jap edhe në këtë pjesë sqarime, që nuk janë qitë më herët, prandaj po themi që të funksionalizojmë në këtë pjesë edhe çështja e rishikimit, edhe çështja e shtatoreve ka qenë. Z. Kryetar, të lus, për hera të tjera të mos mbetet, se gjithmonë po mbetet te administrata në këtë anë, të plotësohen dhe kompletohen pikat e rendit të ditës. Ne i kemi debatuar dje, i kemi pasur 2-3 pika, një e tërhoqe prej pikave që kanë hyrë, herëve të tjera të jetë i kompletuar rendi i ditës kur te trajtojmë në Kuvend.

Faleminderit!

Përndryshe, e përkrahi plotësimin e rendit të ditës.

Kryesuesi: Faleminderit, Sami!

Fjalën e ka Ylli Hoxha!

Ylli Hoxha:

Dy çështje, kryesues. E para, të gjitha çështjet që janë në rend të ditës, i kemi diskutuar në Komitet për Politikë dhe Financa dhe në konsultimet që i kemi pasur me Kryetarin, d.m.th. nuk janë befasi që na vijnë, janë pasojë e proceseve të cilat nuk kanë ecur në drejtime tjera për të cilat jemi marr vesh.

Një kërkesë prej grupit të asamblastëve të LVV-së është që, për mbledhjet e ardhshme, ose ndajeni mbledhjen në dy pjesë, ose thirrini dy mbledhje, por mos na bini rend të ditës me pesëmbëdhjetë pika, sepse pjesa e fundit e ditës po bëhet e lodhshme dhe një pjesë e asamblastëve po e lëshojnë sallën, dhe po humb kuptimi i debatit të cilin duhet ta ketë asambleja e qytetit.

Ju faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Kjo e fundit, por duke mos e përjashtuar edhe të parën që e the, është shumë e arsyeshme, mirëpo situata po na e dikton se 16-17 pika të rendit të ditës vërtet është mundim, por po besoj se për mbledhjet tjera do t'i ndajmë.

Faleminderit shumë!

Dikush tjetër?

Urdhëro, Shemsi!

Shemsi Veseli: Atëherë,

z. Kryetar, ju përshëndes juve,

Nënkryetar,
Drejtorë,
Kolegë,
Përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike,
Përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të OSBE-së,
Në aspektin e funksionalitetit, Kryetar, unë mendoj që, pa pasur ndërmend që ta kundërshtoj as unë rendin e ditës, por për hir të konstruktivitetit, është mirë bile shefat e grupeve parlamentare të partive politike, si pjesë përbërëse, të njoftohen nëse vijnë këto pika në situatën, ta quaj kështu, jo të rregullt.
Ne si Grup parlamentar, nuk kemi qenë të informuar për rishikimin e buxhetit, sidomos për këtë pjesën, sa kam informacione unë jo, tash Yll nuk e di, por, megjithatë, po them për hir të konstruktivitetit, se nuk ka çka na mbetet hatri këtu asgjë, për arsye se është shumë parimore kjo që po e them, d.m.th. bile shefat, e pastaj shefat i njoftojnë grupet parlamentare. Për këtë arsye e kam, unë pajtohem me propozimin e Grupit parlamentar të grupit të LVV-së sa i përket mbledhjeve, mos me qenë i stërngarkuar rendi i ditës, sidomos kur janë pikat shumë përmbajtjesore dhe të rëndësishme që të diskutohen.
Faleminderit shumë!

Kryesuesi: Komitetin për Politikë dhe Financa, kështu që po e shfrytëzoj rastin edhe në këtë mbledhje, kërkoj nga Grupi parlamentar i PDK-së të përcaktohet për një anëtarë të rregullt për Komitetin për Politikë dhe Financa, do të thotë në mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa, jeni në dijeni se ka qenë Muhamet Selmani dhe i kemi diskutuar këto pika.
Urdhëro, Shemsi!

Shemsi Veseli: Kryesues, unë mendoj, meqë është nxjerr Udhëzimi administrativ për rregullimin e komiteteve, realisht unë mendoj se PDK-së i takojnë dy anëtarë e jo një. Nuk kemi se çka e diskutojmë, se ky është Udhëzim administrativ dhe mund të flasim edhe nëse fillon prej janarit të vitit 2015. Nuk po flas unë sipas dëshirës, por po flas sipas rregullores, e cila është, Udhëzimit administrativ, se Prishtina duhet t'i ketë njëmbëdhjetë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, për arsye se e ka numrin maksimal të këshilltarëve 51 vetë.
Po, ani, prej janarit, por, megjithatë, d.m.th jemi duke folur për një muaj ditë.

Kryesuesi: Faleminderit, Shemsi!
Këtë çështje e diskutojmë për më vonë qysh do të jetë, Udhëzimi administrativ hynë në fuqi prej 1 janarit të vitit të ardhshëm, por në këto dy mbledhje sa na mbesin, është mirë që dikush të caktohet prej jush një anëtarë, e pastaj të shikojmë ndoshta edhe dy.
Urdhëro, Lirak!

Lirak Çelaj: Ato që i tha shumicën Shemsiu, edhe në emër të Grupit natyrisht, por ne kemi deklaruar disa herë, qe disa muaj, që ne do të marrim pjesë në Komitet si anëtarë të rregullt me atë një post, edhe pse nuk pajtohemi që të përfaqësohemi vetëm me një

anëtarë, por nuk na kanë ardhur ftesat për Komitet. Këtë vërejtje e kemi adresuar edhe në mbledhjen e kaluar, që nuk jemi informuar për mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa. Ne do të marrim pjesë deri në janar si anëtarë të rregullt, jo si vëzhgues. Nuk jemi ftuar, nuk kemi pasur rend të ditës, e kemi caktuar, e kemi diskutuar, nëse duhet prapë e përsërisim.

Kryesuesi: Do të thotë, Lirak Çelaj është anëtarë i KPF-së prej PDK-së.

A pajtoheni?

Ju lutem, me ngritje të dorës.

A pajtoheni që Lirak Çelaj të jetë anëtarë në KPF?

Konstatohet se me shumicën e votave u vendos.

Tash fillojmë me rendin e ditës.

Sofije Bunjaku, pastaj Flamuri.

Sofie Bunjaku: Përshëndetje, kryesues,

Përshëndetje Kryetar dhe të gjithë të pranishëm!

Grupi ynë parlamentar pajtohet me rendin e ditës, por me një vërejtje të vogël. Herëve të tjera të mos ndodhin ndryshime, të mos bëhen ndryshimet brenda mbledhjes kur kemi, pra herëve tjera t'i kushtohet kujdes më i madh.

Kryesuesi: Mirë, faleminderit!

Urdhëro, Flamur, e ke fjalën!

Flamur Shala: (Për shkak të mos dëgjimit, diskutimi nuk ka mundur të nxirret në transkript.)

Kryesuesi: Dikush tjetër?

Nëse nuk ka, atëherë e qes në votim rendin e ditës për këtë mbledhje.

Kush është për, kuptohet me plotësime dhe ndryshime?

Konstatohet se me shumicën e votave, aprovohet rendi i ditës për këtë mbledhje.

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë

Kryesuesi: A ka dikush vërejtje?

Me ngritje të dorës.

Urdhëro, Ylli!

Ylli Hoxha: Faleminderit, kryesues!

Në pikën e tretë të rendit të ditës, te Projektbuxheti i vitit 2015, korniza afatmesme, nuk reflektohet qëndrimi i LVV-së, do të thotë në proces. Është mirë që të reflektohet, të thuhet ky ka qenë qëndrimi i LVV-së, thuhet vetëm është diskutuar nga LVV-ja, konsideroj se duhet të përmirësohet.

Faqe 6 nga 100

Kryesuesi: Mirë, faleminderit!

Do të hyjnë në proces vërejtja të cilën e pati Ylli Hoxha.
Urdhëro, Agim!

Agim Gashi: (Për shkak të mos dëgjimit, diskutimi nuk ka mundur të nxirret në transkript.)

Kryesuesi:

Ju lutem, i përmirësoni këto.
Dikush tjetër?
Urdhëro, Sadri.

Sadri Ramabaja:

Faleminderit, kryesues!

Një vërejtje shumë të vogël.

Kryesuesi: Veç një moment. Ju lutem, po e shoh se kjo pjesa e djathtë nuk po punojnë mikrofonat, kërkoj që të rregullohen.

Fjalën e ka Sadri Ramabaja.

Sadri Ramabaja: Faleminderit!

Një vërejtje të vogël, por që do duhej që të përmirësohet, për shkak se e prish kuptimin e asaj çka kam thënë. Te pika që flet për buxhetin, në vend të fjalës *per fide* është shënuar si duket gabimisht teknikisht *profite*, që del komplet diçka tjetër.

E bëra këtë vërejtje, për të ju treguar këtyre çka shkruajnë se ne i lexojmë këto!
Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, Sadri!

Fjalën e ka Kreshnik Ahmeti.

Kreshnik Ahmeti: Faleminderit, Kryesues!

Te pika e pestë, ku e kemi diskutuar Rregulloren për Gërmi, nuk janë përfshirë propozimet të cilat i kam dhënë, d.m.th. është shkruar vetëm se kam folur në emër të Grupit dhe kam shprehur përkrahjen e grupit për këtë Rregullore. Kanë qenë tri propozime dhe gjithashtu kam pasur një pyetje për sqarim, por që nuk kam marr përgjigje as atë ditë, por as me shkrim.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Dikush tjetër?

Fjalën e ka Visar Arifaj.
Urdhëro, Visar!

Visar Arifi: Faleminderit!

Vetëm desha me e plotësuar ankesën e Kreshnikut, se pyetjen që e kam bërë edhe unë për të njëjtën pikë të rendit të ditës, nuk kam marr përgjigje as atë ditë, as deri sot. Ka qenë lidhur me qentë se si duhet me qenë të lidhur, sipas Rregullores, në Parkun e Gërmisë, se ka qenë pak jo e qartë në Rregullore.
Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

A ka dikush tjetër?

Nëse jo, e qes në votim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kush është për?

Konstatohet se me shumicën e votave, aprovohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

A ka kundër?

Jo.

A abstenon dikush?

Jo.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

Pika e dytë

Propozim-vendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2014.

Kryesuesi: Fjalën e ka Kryetari i Komunës.

Shpend Ahmeti: Faleminderit, kryesues!

E shpjegoi edhe Samiu, që unë nuk mendoj se ka nevojë për diskutim shtesë në këtë pikë. Ka qenë parimisht në Komitetin për Politikë dhe Financa, ka qenë ideja ta qojmë prej Komitetit, nëse ata e kthejnë, e kalojmë në Kuvend, sepse është brenda vendimit të Kuvendit që ka kaluar në rishikim. Prandaj, unë kisha kërkuar që të hidhet në votë menjëherë, sepse nuk ka ndonjë dallim.

Kryesuesi: Faleminderit, Kryetar!

A ka dikush diçka?

Nëse jo, atëherë e qesim në votim.

Kush është për miratimin e Vendimit për rregullimin e ndarjeve buxhetore?

Konstatohet se me shumicën e votave aprovohet Vendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2015.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

Pika e tretë

Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Propozmplanit për ndryshimin dhe plotësimin e Planit rregullues të lagjes "Sofalia" në Prishtinë.

Kryesuesi: Fjalën e ka drejtori i Urbanizmit, Liburn Aliu.

Urdhëro, Liburn!

Liburn Aliu: Ju faleminderit!

Pra, edhe plotësim ndryshimi i Planit rregullues "Sofalia", hynë në vazhden e plotësim ndryshimeve të planeve rregulluese, për të cilat kontrata është lidhur shumë kohë më parë, mirëpo nuk ka mundur të kryhet, meqenëse për një kohë kanë qenë të gjitha këto procese të pezulluara me një vendim të Ministrisë, atëherë, meqë pritej që të na vije Udhëzimi administrativ për Ligjin e ri të planifikimit dhe, meqë ai udhëzim ende nuk ka ardhur, atëherë na është dhënë leja që të vazhdojmë me planet rregulluese, aty ku ka mbetur të vazhdohet puna.

Tash është plani i dytë, i cili do të prezantohet para jush dhe do të lihet në dispozicion, pastaj që të mund të jepen edhe vërejtjet.

Unë nuk do të kisha hyrë në detaje, dua që të përmend se janë bërë disa dëgjime publike, janë ftuar qytetarët e Sofalisë në shumë raste, edhe këtu në këtë sallë të Kuvendit, që të marrin vërejtjet e tyre, dhe kemi kërkuar që Kompania t'i inkorporoj ato vërejtje.

Tash, meqenëse këtu e kemi prezent edhe kompaninë projektuese, e cila e ka bërë këtë draft plan, ka qenë prej kohës pra e angazhuar, le ta bëjë prezantimin dhe pastaj të votohet.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor!

Fjalën e kanë përfaqësuesit e kompanisë!

Përfaqësuesi i kompanisë, Jona Burrja!

Faleminderit!

Ne jemi kompania "Vizion Projekt", që është kompania kontraktuese nga Komuna për hartimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullativ urban "Sofali", i cili është miratuar në vitin 2007.

Ky plan ka kaluar nëpër faza, nëpër procedura, në të cilat çdo plan, çdo revidim, çdo ndryshim dhe plotësim i planit duhet të kalojnë fillimisht materialet bazë të cilat merren në terren, por edhe në bashkëpunim, veçanërisht me drejtoritë në kuadër të Komunës.

Në veçanti, kisha dashur me falënderuar drejtorinë e Urbanizmit dhe drejtoritë e tjera, të cilat kanë qenë gjithmonë të disponuara me materiale që ne i kemi kërkuar, kanë qenë pjesë e projektimit, pjesë e hartimit. Përfshirë këtu, kisha dashur edhe një falënderim për përfaqësuesit, qytetarët e zonës. Pak a shumë, secila zonë ka pasur përfaqësinë e vet dhe kanë qenë vazhdimisht në kontakt me neve që të mund ta arrijmë një plan sa më të implementueshëm.

Në pika të shkurta, po kaloj në gjendjen ekzistuese, është gjithçka që është marrë, informacioni nga terreni dhe nga drejtoritë në kuadër të Komunës, por edhe jashtë saj. Zona në studim, kufiri i zonës është plani kadastral, i cili është marr nga Drejtoria e Kadastrit, ku janë identifikuar format dhe numri i parcelave të cilat bëjnë pjesë brenda kufirit. Plani gjeodezik, reliefi i zonës, janë evidentuar të gjitha rrugët ekzistuese që janë në zonë, përveç që janë evidentuar dhe janë paraqitur në hartë, janë ndarë dhe

kategorizuar sipas sipërfaqes d.m.th. që janë shtruar me asfalt, me kubëza, me beton, me zhavorr. Kjo ka qenë shumë e rëndësishme, më pas kur kemi bërë propozimin e ri të rrugëve, destinimi i objekteve, flas gjithmonë për gjendjen ekzistuese, tendenca për banimin individual, por këtu ka edhe objekte të tjera administrative dhe kryesisht arsimore, pjesa këtu e AUK-ut, përgjithësisht janë të grupuara, etazhiteti i objekteve. Në vazhdim është gjendja e objekteve që nga vizita në terren, është konstatuar se gjendja e objekteve është e mirë, kjo edhe fal faktit se shumica e tyre janë ndërtuar pas vitit 2000, gjendja e tyre është relativisht e mirë. Shfrytëzueshmëria e objekteve ka qenë një tjetër hartë, statusi i pronësisë mbi objektin, d.m.th. që shikoni këtu me njolla të kuqe, janë pronësi private, por janë mbi objekte edhe mbi pronën, por veçanërisht kjo hartë flet për pronësinë mbi objektin. Viti i ndërtimit ka qenë një tjetër hartë, pastaj hartat në vazhdim janë të gjitha harta që tregojnë situatën reale lidhur me formalitetin ose informalitetin, kështu është kyçja në internet, largimi i mbeturinave, mënyra e ngrohjes, telefonia fikse dhe në këtë hartë është paraqitur pronësia e tokës. Gjithçka që është me ngjyrë, pavarësisht tonalitetit të ngjyrës, e kuqe, e gjelbër apo e verdhë, pavarësisht cila ngjyrë është, gjithçka që është me ngjyrë është pronë shoqërore. Ajo që është me ngjyrën e kuqe, që është edhe në sipërfaqen më të madhe, është pronë e Komunës, të gjitha këto të tjerat janë të ministrive apo të drejtorive tjera, por që gjithsesi ngelën pronë shoqërore. Pjesa tjetër e cila nuk është e përfshirë në, e cila është pa ngjyrë, është pronë private individuale e banorëve të zonës.

Në hartën e fundit lidhur me gjendjen ekzistuese të zonës, janë paraqitur të gjitha parcelat, të cilat janë pajisur me leje ndërtimi, me njollat e verdha janë të gjitha parcelat të cilat disponojnë leje ndërtimi për objektet në fjalë. Më tej është kyçja në rrjetin elektro-energjetik, në rrjetin e ujësjellësit, ku sikurse pritej 100% e objekteve e kanë kyçjen në këto të dy rrjetet, është rrjeti i kanalizimit 100% i shtëpive dhe objekteve që janë aty. Më tej është një pasqyrë e rrjetit elektro-energjetik, gjendja ekzistuese, po ashtu një pasqyrë e rrjetit të ujësjellësit, gjendja ekzistuese.

... një analizë e përgjithshme që neve na ka ndihmuar pastaj në fazat e tjera të propozimit, derisa kemi dal në zgjidhjen urbane finale.

Faza tjetër, nëpër të cilën ka kaluar projekti, kanë qenë skenarët ku janë bërë disa propozime lidhur me zgjidhjen e zonës, dhe pastaj është përzgjedhur ai që ka qenë më i përshtatshmi që është pranuar së gjëri edhe nga qytetarët dhe, mbi të gjitha, që ka qenë në përputhje të plotë me planin zhvillimor urban.

Duhet të theksohet se, vitin e kaluar, pasi që ne jemi kontraktuar nga Komuna për ndryshimin dhe plotësimin e Planit rregullativ, është miratuar plani zhvillimor urban, i cili na tregon neve mënyrën e hartimit dhe të trajtimit të komplet zonës, kështu plani jonë, ky ndryshim dhe ky plotësim, shkon në përputhshmëri të plotë me planin zhvillimor urban, i cili është si nivel më i përgjithshëm se sa plani jonë që është i kufizuar për një zonë.

Këtu është plani i 2007-ës, është plani rregullativ i 2007-ës kjo hartë është harta e destinimeve dhe e rrugëve e cila është marr nga 2007-ta.

Me njollat e kuqe janë të gjitha ankesat dhe sugjerimet që ne i kemi marr nga qytetarët banorë të zonës. Sikurse tha edhe drejtori pak më parë, qytetarët kanë qenë të kyçur në hartimin e këtij plani dhe janë marr parasysh të gjitha ankesat dhe sugjerimet e

tyre, të cilat më duhet ta theksoj, kanë qenë shumë më të mëdha sesa numri që është paraqitur në hartë, por kur një ankesë është përsëritur dy apo tri herë, ne e kemi paraqitur vetëm me një njollë të vetme, kështu që, mund ta merrni me mend që është diku, tri herë më shumë ka pasur ankesa sesa njollat e kuqe që i shikoni.

Këtu është bërë një ndarje e tërësive, e cila na ndihmon neve gjatë hartimit të planit, edhe në vazhdim është destinimi i sipërfaqeve për zonën.

Këtu janë dy harta të vogla, njëra është plani zhvillimor urban, tjetra është plani rregullativ i kaluar i 2007-ës, i cili ne e revidojmë, dhe harta e madhe është propozimi ynë për zonën. Destinimi i sipërfaqeve, gjithçka që shikoni me ngjyrë të verdhë është e destinuar për banimin individual me ose pa afarizëm, me ngjyrën e kaltër mund ta shihni ngjashmërinë me planin zhvillimor urban që është plani tek i cili ne jemi bazuar, me ngjyrën e kaltër është paraqitur destinimi për shërbime shoqërore shërbime publike, që do të thotë shkolla, çerdhe, njësi të mjekësisë familjare apo edhe shërbime të tjera të cilat Komuna i parasheh për zonën në fjalë, por jo vetëm mund të jenë edhe për qytetin. Është e paraparë për këto shërbime që do të jenë shoqërore, mund të ketë shtëpi kulture, mund të ketë një shtëpi të pleqve, gjithçka që Komuna ka nevojë për me vendosë për zonën në fjalë, por edhe për qytetin në tërësi.

Me ngjyrën e gjelbër është paraqitur gjelbërimi, me ngjyrën më të errët është gjelbërimi i lartë dhe me ngjyrën e gjelbër më të çelur është gjelbërimi i ulët i cili përfshin edhe rekreacionin që mund të ketë terrene sportive, pishina të hapura edhe parkingje shoqërore, janë të përfshira brenda shiritit të gjelbër me ngjyrë më të çelur. Në hartën në vazhdim është paraqitur vetëm banimi është heqë çdo lloj destinimi çoftë gjelbërimi këtu apo shërbime shoqërore edhe është identifikuar vetëm njolla që janë të destinuar thjeshtë vetëm për banim individual me ose pa afarizëm.

Tek harta e rrugëve janë rrugët i kemi kategorizuar në katër ndarje që është, rrugë kryesore e kemi me ngjyrë të kaltër është rruga që qon tek Parku i Gërmisë, rruga tjetër kryesore, më tej kemi rrugët rrjedhëse që janë paraqitur me ngjyrë të kuqe. Rrugët kryesore rrjeti i rrugëve kryesore është bazuar kryesisht tek plani zhvillimor urban, sepse ai ka qenë plani tek i cili ne jemi nisur kur kemi bërë ndryshimin dhe plotësimin e planit rregullativ të 2007-ës.

Me ngjyrën vjollcë më tej janë paraqitur rrugët rrjedhëse, këto janë rrugët rrjedhëse në brendësi të zonës. Ajo çfarë duhet të theksojë në këtë rast është se jemi munduar maksimalisht ku ka qenë e mundur kuptohet, me i ruajtur rrugët ekzistuese kjo ka qenë edhe një kërkesë e vetë qytetarëve të zonës, vet qytetarët e zonës kanë kërkuar që të ruhen rrugët ekzistuese, edhe aty ku të jetë e mundur të bëhet edhe zgjerimi i tyre.

Në këtë hartë janë paraqitur profilet e rrugëve, ajo çfarë ka qenë tendencë që jemi nisur edhe nga plani zhvillimor urban edhe ne si projektues, Komuna vet, edhe vetë qytetarët, ka qenë ti japim përparësi këmbësorëve dhe çiklistëve. Meqenëse kjo është zonë që ka shumë gjelbërim dhe është e destinuar për banim individual sipas PZHU-s edhe siç e shihni secila rrugë ka vetëm dy korsi për makinat që janë më se të mjaftueshme për qarkullimin e brendshëm edhe lidhjen me qytetin, dhe secila rrugë ka trotuare e disa prej tyre kanë edhe shtigje për biçikleta. Kemi pasur tendenca me ju dhënë mundësi qytetarëve që të lëvizin sigurt në këmbë pa mjete të motorizuara.

Tek rrugët e propozuara kjo hartë paraqet, me ngjyrën e bardhë janë komplet rrugët pavarësisht kategorisë, i kishim këtu sipas kategorizimeve, a në këtë rrugë është rrjeti i pastër ku shihen me ngjyrë të bardhë të gjitha rrugët e zonës pavarësisht kategorisë se cilës i përkasin. Kjo hartë është bërë që me qenë më i qartë rrejtë vetë si është i lidhur edhe rrjeti në tërësi i rrugëve kryesore në brendësi të zonës, ndërsa në vazhdim kjo ishte për rrugët kryesore të zonës që janë bazuar kryesisht tek plani zhvillimor urban por edhe te gjendja ekzistuese. Ndërsa harta tjetër, janë rrugët kryesore bashkë me rrugët e brendshme lokale që i shikoni rrugën me ngjyrën e verdhë.

Tani, tek rrugët lokale më duhet të theksoj diçka, ky është propozimi që neve kemi bërë për zonën, këto janë rrugët që ne kemi propozuar për blloqet e brendshme, rrugët lokale janë rrugët që i shërbejnë blloqeve në veçanti, disa prej tyre janë me fund e disa jo.

Ajo çka është e rëndësishme është se përmes kësaj edhe përmes pjesës tekstuale që shoqëron planin, ne kemi lënë mundësinë qytetarëve që rrugët e brendshme të bllokut meqenëse janë veçanërisht në shërbim për ta që janë rezident të zonës të kenë mundësi ata me bë një propozim dhe me ardhur me një zgjidhje të veten si bllok, për me qenë më konkrete po flasim supozojmë ky blloku. Ne kemi bërë propozimin për zgjidhjen e brendshme të rrugëve secila parcelë preket nga rruga dhe ka një funksionalitet shumë të mirë, por nëse banorët e këtij blloku kanë një zgjidhje që ata mendojnë se është më e mirë për ta, ata mundën me ardhur me një propozim në zyrat e Urbanizmit në Komunë dhe propozimi i tyre do merret para sysh për implementim, kështu që këto rrugë janë fleksibël, janë paraqitur është dhënë propozimi ynë ka mundësi ndryshimi nëse i gjithë blloku bie dakord për me e pasur një rrjet tjetër të brendshëm.

Pjerrësia e rrugëve, këtu janë paraqitur rrugët kryesore dhe pjerrësitë. Pjerrësia e rrugëve ka qenë një problematikë në vete sepse "Sofalia" është një nga zonat me më pjerrësi në qytet, dhe kemi bërë të mundur që pjerrtësia maksimale e rrugëve të mos i kalojë 12%. Përgjithësisht sillen 7 deri në 8% , 12% është pjerrtësia maksimale që ne jemi munduar me sjell në këtë zonë mos me e kaluar 12% sepse përndryshe vetëm bëhet problematike sidomos në muajt e dimrit.

Në këtë hartë janë paraqitur kushtet e rregullimit, këtu i kemi të gjitha destinimet së bashku me kushtet në fjalë, ngjyra e verdhë është për destinim individual me ose pa afarizëm. Brenda ngjyrës së verdhë nëse vini re ka një tonalitet më të errët të ngjyrës përgjatë rrugës kryesore që është kjo këtu, këtu është paraparë për banim individual me afarizëm me katet e përdhës.

Koeficientat e kësaj zone janë, koeficienti i shfrytëzimit të parcelës është 0.4, ndërsa 0.8 është koeficienti i ndërtimit. E njëjta është edhe për këto parcelat me ngjyrën më të errët d.m.th ky shirit që shtrihet përgjatë rrugës kryesore edhe për këto blloqet këtu, të cilat këto blloqet me ngjyrën më të errët ja këto, ky këtu, edhe ky shiriti komplet edhe kjo, janë paraparë banim individual me afarizëm në përdhës. Në këtë rast kemi 04 dhe 08 koeficientat, e në këtë rast kemi 0.3 dhe 0.8, ndërsa e gjithë pjesa tjetër me ngjyrën e verdhë që është banim individual pa afarizëm ka koeficient shfrytëzimi 0.3 që është i parcelës dhe koeficienti ndërtimor është 0.8. Këto koeficient janë marr në

përputhshmëri të plotë në planin zhvillimor urban që i ka paraparë dhe ka lanë segmentet sa deri në sa duhet të shkoj shfrytëzueshmëria e parcelës për këto zona.

Dua të theksoj te banimi individual, i cili zë sipërfaqen më të madhe, i cili është banim individual pa afarizëm, përmes klauzolës së veçantë në pjesën tekstuale kemi dhënë mundësinë që qytetarët të cilët kanë nevojë për një shërbim të veçantë, apo ata individë të cilët marrin iniciativë për me sjell një shërbim tjetër në zonë mund ta implementojnë këtë sigurisht në bazë të rregullave që mos të emetojë zhurmë, mos të ketë rrezik të eksplozimit dhe tiparet e tjera që janë të rrezikshme për zonën, ai mund ta realizoj një shërbim tjetër brenda zonës të banimit individual vetëm nëse merr pëlqimin për një rreze prej 50 metrave të fqinjësisë që ka për rreth. Pra, edhe në këtë zonë ku ka vetëm banim individual mundemi me i implementuar shërbimet e tjera, por me pëlqimin e banorëve për një rreze prej 50 metrash.

Tek shërbimet shoqërore që janë me ngjyrë të kaltër, tek shërbimet shoqërore janë, do ta shohim edhe tek harta në vazhdim, kemi vendosur shërbime të cilat kjo zonë ka nevojë që është: shkollën 8 vjeçare, njësitë kopsht çerdhe ,kemi pasur tendencë me mbuluar komplet zonën, por janë shfrytëzuar parcelat shoqërore të komunës, edhe njësia tjetër që është për mjekësinë familjare.

Tek gjelbërimi dy kategoritë e gjelbërimit këtu sigurisht nuk ka trajtim të veçantë për derisa është gjelbërim, i vetmi dallim është gjelbërimi i lartë në zonat me ngjyrë më të errët këtu edhe kjo hapësirë. Ndërsa ngjyra më e çelur është gjelbërim me shërbimet e tjera që mund të jenë sportive rekreacioni.

Tek harta e fundit është ajo që përmenda pak më parë janë vendosur të gjitha shërbimet për të cilat kjo zonë ka nevojë që janë katër njësi kopsht çerdhe që shkojnë sipas rrezes dhe e mbulojnë zonën, një shkollë nëntë vjeçare edhe njësia e mjekësisë familjare.

Këto shërbime meqenëse Komuna ka shumë prona në këtë zonë ka gati 50% të sipërfaqes totale, ne i kemi vendosur vetëm në pronat komunale kështu që edhe realizohet shërbimi i nevojshëm edhe nuk cenojmë pronën private.

Kjo ishte edhe harta e fundit lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e Planit rregullativ, kjo është një procedurë që ka zgjatur shumë muaj kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm me Komunën si pjesë e hartimit, po ashtu edhe me qytetarët, por u munduam që për një kohë shumë të shkurtër të bëjmë një përmbledhje.

Faleminderit.

Kryesuesi: Faleminderit!

Atëherë hapim diskutimin.

Shkojmë sipas grupeve parlamentare.

Urdhëro, Mustafë!

Mustafë Krasniqi, GP i LDK-së: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për Kryetarin,

Ekzekutivin,

Kolegë të nderuar,

Mediat,

Të gjithë të pranishëm,

Por, edhe përfaqësuesit e Kompanisë, të cilët janë marr me hartimin e planit rregullativ të Sofalisë!

Ne si Grup, e kemi mbajtur takimin dhe e kemi diskutuar edhe këtë pikë prej të gjitha pikave që i kemi pasur, e kemi analizuar dhe kemi diskutuar bukur gjatë. Mendojmë që është punuar mirë në këtë drejtim dhe e falënderojmë, si dhe kemi fjalë të mira për kompaninë që është marr me këtë punë dhe ka punuar bukur gjatë, sidomos me pjesën që janë marr parasysh vërejtjet dhe shqetësimet e qytetarëve të asaj pjese atje.

Parimisht, ne do ta përkrahim që ky propozimvendim të dalë dhe të shkoj për diskutim publik, por i kemi edhe shqetësimet tona, që i kemi dhënë brenda grupit dhe këtu do t'i shprehi, disa prej tyre i kam thënë edhe në takimin e Komitetit për Planifikim që e kemi pasur. Por në theks të veçantë ose si shqetësim më i madh për ne, është shiriti gjelbërues që është i paraparë në rrugën kryesore prej pjesës që tangon me pronën komunale, deri te pjesa e unazës atje, që është thujse te Liqeni i Gërmisë, ana e djathtë. Këtë po e them për shkak se në këtë pjesë janë bukur një numër i madh i objekteve të ndërtuara çoftë me leje, çoftë edhe pa leje, të cilat janë në proces të legalizimit.

Me plan ekzistues që ka qenë te Planit rregullativ të Sofalisë, në këtë hapësirë po ashtu ka qenë hapësirë gjelbëruese, një gjelbërim i lehtë, por me një koeficient të ndërtimit të ulët të objekteve të karakterit të banimit, por edhe të karakterit për sport dhe rekreacion. Prandaj, në bazë të saj janë lëshuar dhe janë dhënë lejet, për të cilat pronarët kanë investuar dhe ndërtuar. Unë e di që në atë pjesë ka shumë objekte pa leje, por janë në procesin e legalizimit, ka objekte që edhe në kohë të fundit edhe janë duke i ekzekutuar punimet, do të thotë kanë leje dhe janë duke i kryer punët.

Shqetësimi ynë është që Kompania ose përfaqësuesit e Kompanisë që i kemi këtu, unë e kam shtruar këtë pyetje edhe në Komitet për Planifikim, se sa janë konsultuar me hartuesit e planit zhvillimor urban. Përndryshe, ne e kemi votuar Planin zhvillimor urban dhe aty kemi thënë që çdo plan rregullativ që është në fuqi duhet të implementohet në Planin zhvillimor urban. Në bazë të kësaj, është dashur që edhe kjo pjesë këtu të trajtohet dhe të shikohet se si të veprohet tutje.

Shqetësimi ynë është, jemi dakord të krijojmë hapësira gjelbëruese, çoftë edhe këtu ku është paraparë një shirit i tillë, mirëpo duhet ta them, ka të bëjë me dhjetëra hektar, është një sipërfaqe e madhe, dhe sigurisht do të jetë një kosto e papërbalueshme e shpronësimit të kësaj hapësire.

Prandaj, duhet të mendohet edhe pjesa tjetër se a mundet nesër Drejtoria, por në këtë rast ekzekutivi i Komunës, së bashku me Kryetarin, ta përballoj këtë.

Unë edhe njëherë po e them, gjatë kësaj kohës të diskutimit publik dhe takimeve të tjera që kemi me i pasur, çoftë edhe në Komitet për Planifikim, si kompani edhe njëherë të konsultoni hartuesit e Planit zhvillimor urban dhe te shohin se a është inkorporuar Plani zhvillimor në Planin zhvillimor urban dhe të shikohet edhe njëherë, se kjo nuk është shqetësim vetëm i imi apo i të gjithë grupit, por është shqetësim i të gjithë atyre pronarëve që çoftë atyre që kanë ndërtuar, çoftë edhe asaj pjesës tjetër që i kanë sipërfaqet e veta.

Përndryshe, për pjesën tjetër ne nuk kemi ndonjë vërejtje, se disa vërejtje të karakterit më të ulët i kemi dhënë edhe në Komitetin për planifikim.

Nuk do ta zgjati më tepër, sepse sigurisht gjatë kësaj periudhe mujore deri sa të vjen drafti final, ne do të kemi kohë prapë secili me e dhënë kontributin në këtë drejtim. Parimisht, ne do ta përkrahim dhe do ta japim votën për të ecur tutje për diskutim publik.
Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, Mustafë!
Fjalën e ka Ylli!

Ylli Hoxha, GP i LVV-së: Faleminderit, Kryesues!

E ndaj shqetësimin për temën, subjektin d.m.th. subjektin e kemi të njëjtë, por drejtimin mund ta kemi të kundërt për shqetësimin e kësaj, për rripin e gjelbër. Janë dy çështje do të thotë të cilat do t'i ngritja. Në mbledhjen e KPF-së, na u tha se kjo zonë ka qenë e planifikuar për zonë rekreacioni edhe në kohën e qeverive të kaluara. Lejet eventuale të cilat do të mund të lëshoheshin për këtë zonë, do të duhej të ishin për objekte rekreative, siç është një klub shahu, klub tenisi, një basen apo diçka tjetër. Gjendja në terren është krejtësisht ndryshe, gjendja në terren është shtëpi banimi, i koncentruar me do shtëpi të mëdha, të cilat nuk kanë të bëjnë hiç me qendra rekreative.

Në pyetjen të cilën ia shtrova njëres prej zyrtareve të urbanizmit, tha se disa janë edhe me leje aty, por nuk e di se çka kanë bërë ata aty.

E para është, mendoj që duhet Drejtoria e Urbanizmit të merret seriozisht me mënyrën se si janë lëshuar ato leje, ta analizojë se kush i ka lëshuar ato leje, e të merr njëfarë përgjegjësie lidhur me atë veprim, se nuk është bërë mirë që është krijuar ajo gjendje.

Çështja e dytë, ka të bëjë po ashtu me fjalën e shpronësimit, e përmendi kolegu më herët. Në një prej dokumenteve që e kemi shqyrtuar në këtë sallë, pak metra më sipër, d.m.th. në vazhdim të këtij rripi, kanë dal dy parcela të cilat realisht kanë qenë të shpronësuara, por janë kthyer në pronë private në proces të falsifikuar.

Unë jam i shqetësuar, sepse kam dëgjuar nga shumë qytetarë të vjetër se ky rrip ka qenë i shpronësuar në një kohë në Prishtinë në krijimin e Parkut të Gërmisë.

Do ta lusja Komunën që brenda këtij procesi, të verifikojë nëse është shpronësuar ndonjëherë ky rrip i gjelbër, e nëse po, atëherë si është e mundur që këto toka të kthehen në pronë private! Mendoj se është një proces që duhet ta ndjekim paralelisht me këtë diskutim, ndoshta nuk e pengon aprovimin e planit rregullues, sepse mund të jenë procese komplementare, por ia kemi borxh qytetit që të verifikojmë se a është ai rrip i shpronësuar ndonjëherë dhe si ka mundur që ajo pronë të kthehet në pronë private.

Ju faleminderit!

Ne si grup do ta përkrahim, megjithatë të futet në diskutim publik.

Kryesuesi : Faleminderit, Ylli!
Përfaqësues të PDK-ës?

Laura Zherka, GP i PDK-së: Përhëndetje për të gjithë!

Ne si grup i asamblistëve të PDK-ës, e kemi shqyrtuar draftplanin rregullues, d.m.th. për plotësimin e Planit rregullues të lagjes "Sofalia". Edhe ne si grup mendojmë se duhet të

vazhdojmë ta lëmë në diskutim, të vazhdojë plani. Mirëpo, po ashtu edhe para disa ditësh në Komitetin për Planifikim, i kemi dhënë disa, të them, vërejtje apo propozime për plotësimin e këtij dokumenti.

Së pari, po filloj me sipërfaqen. D.m.th. dihet se në këtë zonë ka më tepër zonë publike apo shoqërore dhe kjo në dokument nuk është e paraqitur në metra katrorë apo në hektarë sa është pronë. Mendova që sot do ta marrim një përgjigje të tillë, e morëm diku 50%, por mendoj se më tepër se 50% i takon pronës publike. Pastaj, si tjetër propozim për plotësim të këtij dokumenti, mendojmë që është edhe tek skenarët, po ndalem tek skenarët, katër skenarët të cilët i keni paraqitur, dhe mendoj që janë thelbi i një dokumenti të planifikimit.

Tek skenarët, tërësitë, që i keni ndarë nëpër zona, secila tërësi parashihet objekte, ndërtim i objekteve, etazhiteti duhet pak më tepër me u fokusuar në këtë drejtim, kur e dimë se kjo zonë ka më tepër peizazhe të bukura gjelbërimi. Edhe atë ditë kemi thënë që çështjet mjedisore, mjedisi nuk është trajtuar. Derisa ju keni marr lëvdata për çështjen e organizimit të rrjetit rrugor, paraqitjet të profili urban të gjendjes me furnizim me energjisë elektrike, pastaj të gjithë rrjetin e kanalizimit, ujësjellësit, edhe diçka tjetër, të jenë ekspertët të cilët kanë punuar zakonisht ka qenë praktik që të jetë lista e emrave dhe kualifikimi i ekspertëve të cilët punojnë në dokumentet e planifikimit.

Në bazë të asaj çka kemi lexuar dhe çka na keni ofruar në këtë dokument, unë edhe atë ditë ju thash, mendoj se kompania e juaj ka më tepër ekspertizë në inxhinieri sesa në pjesën e arkitekturës dhe planifikimit.

Tjetër, është bashkëpunimi me Komunën, bashkëpunimet, takimet që i keni pasur me pronarët, bashkëpunimi me Komunën të jetë pak më preciz, të precizohen objektet publike ku do të ndërtohen në ngastra, rrezen e keni paraqitur, d.m.th. kriteret të gjithat i keni paraqitur, të cilat janë në secilin dokument të planifikimit. Mirëpo, të saktësohet ku do të jetë qendra e kulturës, terrenet e sportit e të gjitha këto. Mirëpo, tek skenarët të keni kujdes të jepni më tepër propozime, i keni ndarë, d.m.th. keni luajtur me sipërfaqe diku një tërësi në njërin skenarë ka sipërfaqe më të madhe, kurse në tjetrin më të vogël, mirëpo kjo është planifikim. Duhet të jetë e precizuar ku do të ndërtohet secili objekt në të ardhmen.

Përndryshe, edhe ne si Grup mendojmë se duhet të vazhdojmë tutje, mirëpo duke i marr parasysh të gjitha këto vërejtje dhe propozime.

Ju faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, Laura!

Prej AKR-së?

Islam Pacolli.

Islam Pacolli, GP i AKR-së

Përhëndetje Kryesues,

Përhëndetje Kryetar,

Drejtore,

Kolegë,

Media dhe vëzhgues!

Sigurisht që kjo është një pikë shumë e rëndësishme për neve si Grup i asamblistëve komunalë të AKR-ës, dhe ne e kemi shqyrtuar këtë çështje, e kemi trajtuar.

Më vjen mirë që bëhen këto planifikime, por në takimin e Komitetit për Politikë dhe Financa unë posaçërisht kam bërë disa kërkesa, të cilat nuk i kam marr ato përgjigje. Kanë qenë disa pyetje të cilat është shumë e rëndësishme që ne të dimë që në këtë projekt implimimin e financave të buxhetit të Komunës, për arsye që sigurisht që duke marr parasysh që nuk e kemi të saktë edhe planifikimin që ka qenë më herrët, ndryshimi sigurisht që do të ndodhë, dhe aty implikimi për arsye që disa objekte janë me leje, por a janë zbatuar në bazë të lejes ato, ne nuk kemi informata.

Është e mirë që kjo të bëhet një llogari, të shqyrtohet dhe natyrisht të shkoj përpara. Unë e përcjella me vëmendje këtë projekt, hapësira gjelbëruese ka deri diku, mendimi im është që nuk është e mjaftueshme, po të kishte qenë edhe më shumë unë kisha me qenë përkrahës ende më i madh. Dhe pjesa rekreative sportive duke marr parasysh që kjo zonë njihet si zonë jo e industrisë e banimeve të larta dhe e këtyre tjerave, por si zonë që e ka një ajër të mirë për shëndetin e qytetarit. Mendimi im është që, ky të shqyrtohet ende dhe të shtohet gjelbërimi dhe pjesa rekreative, kështu që të përmirësohet vërtet dhe mos të ndryshon emërtimin apo kahjen.

Sigurisht që, edhe ne e ndajmë të njëjtin shqetësim në rast se ka prona të uzurpuara, mendoj që në rast se ka nuk dua të paragjykoj për arsye se nuk kemi asi informata, por në rast se ka kishte me qenë mirë që ato të lirohen, ti jepet hapësira publike qytetarit për arsye që, hapësira publike është e të gjithë qytetarëve.

Mendoj që duke marr parasysh që nuk e kemi detalin saktësisht edhe ngarkesa e ndërtimit, por si sugjerim kisha pasur dëshirë që të them dhe të sugjeroj që kjo mos të ngarkohet apo stërngarkohet me ndërtime, por të ruhet ajo kahje të cilën e ka pasur deri më sot apo edhe për çka është thirrur Sofalia, Gërmia dhe të gjitha ato afër njëra me tjetrën e kanë një trajtim pak më ndryshe, më të veçantë, të cilën mos te ndryshojmë tani.

Mendoj që prapë, me supozim po them, që trajtimet të bëhen adekuate apo janë bërë adekuate, shumë është e rëndësishme infrastruktura për aq sa planifikohet, le të jenë një infrastrukturë adekuate dhe të parashihet përnjëherë me u bërë ajo që, mos të ketë ndërhyrje prapë pas një kohe për ndryshime për arsye që çdo herë po shkon buxheti tek infrastruktura e dyfishtë. Një infrastrukturë e dyfishtë e them që, kur sot bëhet një rrugë apo çka do që të jenë rreth infrastrukturës dhe pas 3-4 viteve duhet me ndërhyrë se nuk është bërë adekuate. Do të thotë një cilësi të jenë më e lartë, një kontroll më e thuktë dhe ne si grup i Asamblesë Komunale të AKR-ës e përkrahim që të shkon në shqyrtim, d.m.th tutje, e përkrahim.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, Islam!

Grupi parlamentar i AAK-ës?

Imer Rusinovci.

Imer Rusinovci, GP i AAK-së: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për ju,

Përshëndetje për të gjithë!

Ne si Grup parlamentar i AAK-ës, e kemi shqyrtuar me kujdes këtë material. Normalisht që përkrahim çdo iniciativë, përkatësisht çdo plan rregullues që është konform kriterëve të mirëfillta. Jemi të shqetësuar për një dukuri, që po më duket se parafolësit nuk e potencuan deri më tash, nuk ka lidhje që një Kuvend komunal i kaluar ka qenë me një garniturë tjetër njerëzish ose me departamente tjera, por mendoj se funksionaliteti duhet të jetë i njëjtë. Në këtë konotacion, unë konsideroj se nuk kemi arsye dhe nevojë të përdorim standarde të dyfishta për derisa. Një pjesë e caktuar e pronave private kanë leje ndërtimi, atëherë edhe pronarëve të tjerë legalë ose legjitim duhet t'u takojë ose jo. Këto gjëra duhet t'i definojë, d.m.th. ekipi i cili konsideroj që ka bashkëpunuar me hartuesit e Planit të zhvillimit urban dhe, në anën tjetër, po që se që nuk e di se nuk kam pretendim as dëshirë me paragjykuar, ka letra të falsifikuara, d.m.th. të sanksionohen para ligjit dhe njëherë e përgjithmonë të dihet ajo, sepse unë mendoj se nuk ka jurist që thotë se ka prona të uzurpuara, ka uzurpatorë, prona ka pronar dhe i dihet burimi ose origjinaliteti i saj. Në këtë konotacion, mendoj se ne e përkrahim që të shkojë për diskutim publik, por këto çështje duhet të saktësohen me një përpikëri të saktë.
Ju faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, Imer!
Nga Partia e Drejtësisë?
Urdhëro, z. Feti!

Feti Mehdiu, GP i PD-së: Faleminderit, z. kryesues!

Përshëndetje për Kryetarin,
Drejtorët dhe stafin udhëheqës,

Të gjitha mjetet para nesh që ndjekin punën e këtij Kuvendi,
Këshilltarë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës!

Ne e kemi shikuar nuk kemi pasur mundësi të hymë shumë në detale për shkak profesionalizimit, nuk jemi fort të informuar për këtë, por ato çka i dëgjuam këtu, me shumë vërejtje dhe sugjerime, pajtohemi dhe mund t'i shtojmë diçka.

Nga ajo që shohim, që kemi parë dhe vumë re, njëherë kompaninë e urojmë për punën që e ka bërë, sidomos jemi të kënaqur shumë me ato stazat e biçiklistëve, edhe pse atje nuk është terreni i përshtatshëm, por na vjen mirë që është paraparë të realizohet.

Te rruga u bënë shumë vërejtje, që mendojmë posaçërisht me theksuar edhe unë, të ruhet ambienti, sepse është afër Gërmisë, tek ndërtimet të kihet parasysh se çfarë ndërtohet aty. Kompania e ka parasysh dhe mua më erdhi shumë mirë që kishte bërë shumë konsultime me ata banorët e vendit aty, ata duhet të vazhdojnë edhe më tutje.

Te rruga, me sa e mora vesh, edhe tash kur e prezantuan thanë që mjafton rruga, e përmenden është dy shirita, dy korsi. Ne mendojmë që për te rruga duhet me pasur kujdes pak më shumë, rrugët sa më të gjëra të jenë, është aq më mirë.

Konkretisht, tash përballë Shkollës Normale një mur që është aty, tash ndërtohet një objekt, mua po më duket tash me sy kur e kam parë aty, por Kompania do ta ketë parasysh në çoftë se ai ndërtim do të realizohet aty ku është muri, edhe prej te muri e tutje nuk kanë mundësi udhëtarët me shkel, aty mungon hapësira për një trotuar kah të ecin kalimtarët.

Këto gjëra sigurisht profesionalisht do t'i shohin më mirë, por ti kenë parasysh edhe sugjerimet

që u bënë nga kolegët parafolës këtu.

Unë uroj edhe njëherë dhe përsëritës, dhe gjithsesi të ketë parasysh harmonizimin e realizimit të atij projekti si e shohin Kompania, me inspektionin, sepse na ka ndodhur, e përmendën edhe këtu disa kolegë, që mos të vijë puna me bërë korrigjim pas dy apo tri vite, për shkak se ato korrigjime nëse kushtojnë, kanë çmim, atëherë duhet me i kërkuar kush i bëri ato gabimet, unë nuk besoj se do të vjen puna me kompaninë, por gjithsesi duhet t'i ketë parasysh.

Ne e përkrahim, e çojmë më tutje, dhe sigurisht presim edhe ndihmën e qytetarëve, se sigurisht edhe ata mund të kenë sugjerime të tjera. Hapësirë shoqërore i them unë, tash komunale, shoqërore kishte mjaft ky rajon, le ta verifikojnë si e shohin ata vendës që jetojnë aty, ata qytetarë, por edhe i gjithë qyteti i Prishtinës mund të mendoj për atë punë. Ju faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, profesor!

Nga Lëvizja për Bashkim?

Abetare Fazliu.

Abetare Fazliu, GP i LB-së:

Përsëritës për të gjithë!

Me disa plotësime që i dhanë të tjerët, edhe ne e përkrahim dhe mendojmë se duhet të shqyrtohet dhe të vazhdojë në diskutim publik, që edhe ata të mund të kenë ndonjë sugjerim apo diçka që të shtojnë.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Nga Partia e Fortë?

Visar Arifaj.

Visar Arifaj, GP i PF-së: Faleminderit!

Pa dashur me i përsëritur fjalët e parafolësve, mendoj se është shumë ide e mirë, sidomos pjesa e shiritit të gjelbër, duke e pasur parasysh që Sofalia nuk është vetëm një lagje, një lagje tjetër e Prishtinës, por për faktin që e lidh parkun e Gërmisë me qytetin, duhet me u analizuar ndoshta shumë më detajisht sesa ka me qenë funksionale kjo pjesa që e lidh pjesën tjetër të qytetit me Gërminë, sepse nëse këtu nuk bëhet punë e mirë, atëherë njerëzit kanë me prituar shumë me shkuar në Gërmi, qysh është deri sot.

Po pajtohem edhe me faktin që duhet ndoshta pak më shumë me u sqaruar, këto pjesët tjera të cilat nuk janë të ndërtuara, edhe mos me qenë të parapara vetëm për ndërtim, por me pasur edhe ide tjera.

Përveç kësaj, edhe ne e përkrahim që kjo të vazhdojë në diskutim publik.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, Visar!

Nga Lista Srpska?

Nenad Miladinovic, GP i Listës Srpska: Hvala predsedavajuci!

Pozdravljam sve prisutne u Sali.

Slozicu se sa nekim primedbama sefova poslanickih grupa, i diskutantima koji su ranije imali rec, ali uglavnom podrzavam ovaj projekt.

Kryesuesi: Faleminderit!

A ka dikush që do ta merr fjalën?

Urdhëro, Agim!

Agim Gashi: Faleminderit!

Tash dilema po del te rripi përbri rrugës, krahu i djathtë dhe i majtë. Harta e mëhershme e Pronës e identifikon si pronë private, nëse gaboj, le të më përmirësojë përfaqësuesi i Kompanisë. Gjithmonë kur bëhen plotësimet dhe ndryshimet në planet rregullative, duhet të dihet edhe kostoja e ndryshimit dhe koha e implementimit.

Në çoftë se ne, po paragjykoj, tash ky ndryshim përbri rrugës në të dy krahët miratohet si zonë e gjelbër, rrip i gjelbër, Komuna nuk do të mund t'i mbajë peng pronarët në atë vend një kohë të pa caktuar, se ata do ta kërkojnë riskun e vet për pronësi. Edhe pse ne e dimë historikisht që ajo zonë ka qenë e shpronësuar, nxënës kur kemi qenë në Shkollën Normale, e mbajmë në mend atë punë, por më vonë qysh i kanë përfituar ata është çështje tjetër. Nuk po lëshohemi tash në atë punë, sepse Komuna deri më tash nuk ka mundur ta vërtetojë të kundërtën deri më tash, prandaj duhet t'i besojmë kësaj që është. Do të ishte mirë që, se planet rregullative bëhen për interesa të atyre që jetojnë aty, prandaj duhet të kemi parasysh edhe kërkesat e tyre, edhe ne këtu nuk do të mundemi t'i ngrehim gishtat lartë dhe të themi ne vendosim kështu dhe kjo punë është kryer, dhe të shkelim mbi interesin e atyre që jetojnë aty, e kanë pronën aty. Kjo punë duhet të diskutohet edhe më tutje dhe të shihet, të gjendet një version i mundshëm, i përbalueshëm, me një kosto të përbalueshme të Komunës dhe me një mundësi për të ruajtur hapësirën gjelbëruese sa është e mundur.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Urdhëro, Shem!

Shemsi Veseli: Faleminderit, Kryesues!

Meqë e di që drejtori e pati ndërmend, por i kërkoj ndjesë, sepse më lypet me çështjen që duhet ta them.

Duke e përkrahur të gjithë fjalën që e tha kolegja në emër të Grupit parlamentar, unë po dua vetëm me tërheq vëmendjen për diçka që nuk e thanë kolegët.

Është e pajustificueshme, nuk ka të bëjë vetëm me mandatin e juaj, por po foli për Kuvendin komunal deri tash, ndërrohen shumë plane rregulluese dhe asnjëherë Drejtoria për Urbanizëm para këtij Kuvendi, po flas me përgjegjësi morale, se kam qenë edhe në mandatet tjera, nuk është dal me një analizë të thuktë, për të thënë se në cilën shkallë

është implementuar ai plan rregullues, i cili tash po duhet me u revidu, ku janë problemet, në cilën shkallë, faktikisht kanë përgjegjësi ata që janë marr me projektimin, se ne shpesh herë e kemi tendencën për t'i kritikuar vetëm investitorët, realisht qytetarët, por jo, ju lutem, këto kanë të bëjnë në përgjithësi me Ligjin e planifikimit, edhe ndërtuesit, edhe investitorët, faktikisht edhe qytetarët, dhe në anën tjetër edhe ata që kanë marr pjesë në projekte. Se shëmtimin dhe degradimin e qytetit e kanë këto kompanitë gati dhe shumica e tyre që janë marr edhe kanë qitë në letër gjërat të cilat kanë qenë si fontanë dëshirash e tyre, dhe është manipuluar ky Kuvend dhe e ka miratuar, faktikisht, për shkak të mos transparencës që nuk ka pasur.

Në anën tjetër, të ju them të drejtën, po më habit pak fakti edhe nga kompania, që është çështje shumë elementare, nuk i jap emrat e atyre që kanë bërë zgjidhje, incizimi gjeodezik, po ju them me kompetencë, se nevoja më ka shtyrë me i mësuar këto gjëra, ju është bërë përmes hartave në kabinet, asnjëherë gati nuk është dal në terren për ta shikuar gjendjen faktike. E për këtë arsye kemi probleme, tash siç e thanë kolegët, se aty dalin shtëpitë që janë të ndërtuara, ndërsa atje e paraqet që ka gjelbërim apo gjëra tjera.

Prandaj, duhet ta kemi parasysh, d.m.th. se kush janë autorët, që edhe nëse nuk bëhet zgjidhje e mirë, të ketë fjalë miradije për ta, por nëse faktikisht nuk është bërë zgjidhje e mirë, atëherë është shumë normale të jap edhe llogaridhënie për këtë drejtim, se këtu është në pyetje paraja publike. Ne kemi plan që kushton edhe 235.000, edhe 300.000 € dhe faktikisht brenda atyre pesë viteve nuk e dimë shkallën e implementimit.

Shtrohet pyetja tash, z. Drejtor, me atë përbërje që e ke ti në atë drejtorat, a do të mundesh me bërë reforma, kur në mesin e atyre ka pikërisht që ka pasur ndoshta, se kanë shkallë të përgjegjësisë të degradimit të qytetit, të dhënieve, ndoshta tash që po del edhe lejeve, të cilët janë faktikisht me dokumente fiktive ose faktikisht që janë mashtruar, që e përmendi kolegu Ylli, ose diçka tjetër.

Thjesht, për informim për kolegët që kemi qenë prej fillimit, dua të them që te prona është e vërtet se diçka nuk është në rregull, por me dokumentet që janë dal para gjykatave, ky Kuvend nuk ka pasur qare pa e miratuar. Kanë dal tash ato a janë fiktive apo janë të falsifikuara, apo janë burimore, ajo është çështje e organeve të hetuesisë, por ne e dimë që e kemi humbur projektin madhor të qendrës rekreative sportive, që ka qenë donacion i zviceranëve, pikërisht për shkak se ka qenë kontestuese prona. E dinë edhe Samiu, e dinë edhe plotë kolegë këtu që janë.

Prandaj, po them kjo është çështje që organet e hetuesisë duhet me u marr me këto gjëra, mirëpo çështja është që, e lus kompaninë se kur të vjen finalja, për arsye se pajtohem plotësisht edhe me kolegun, Imerin, edhe me Agimin, tash se planifikimi bëhet për qytetarin. Unë kam tash disa vërejtje që ju kanë drejtuar edhe kompanive, edhe juve drejtorëve, edhe gjëra tjera dhe, normalisht, nëse donë me pasur sukses në implementimin e planeve rregulluese, atëherë duhet ta dëgjojmë dëshirën e atyre qytetarëve, se pikërisht zgjidhja bëhet për hir të atyre qytetarëve.

Faleminderit shumë!

Kryesuesi: Faleminderit, Shem!

Urdhëro, Shefki!

Shefki Gashi: Kompaninë, nuk kam se çka të ju shtoj këtyre çka e thanë se jam në mesin e atyre që jam pak njohës i arkitekturës dhe urbanistikës, por këto çka i tha Shemi së fundit, unë po e ndiej veten të manipuluar që pesëmbëdhjetë vite në Komunë këtu prej Kompanive projektuese të komunës së Prishtinës. Atëherë pata thënë në fillim, ju lutem mos projektoni në formë të video gemave prej kabineteve, prej zyrave të tyre pa dal me e pa gjendjen në terren atje, dhe na ka ndodhur që as 10% e projekteve që i kemi miratuar dhe i kemi paguar me pare nuk janë implementuar dhe nuk mund të implementohen. Dhe sot ka lloj-lloj konfliktesh, lloj-lloj njerëzish kanë marr objekte të ndryshme me ndërtuar dhe nuk munden se plani është asi soji i paraparë livadh, ka pasur raste kur kanë dal edhe 7-8 objekte të mbrojtura e ata nuk e kanë planifikuar fare aty.

Kështu që, përgjegjësinë le te merr ai i cili e ka marr se çdo herë këta shokë që janë në pushtet tash gjithçka e adresojnë në pushtetin e kaluar, do të korrigojmë, do të kqyrim, do ti padisim, do ti çojmë në prokurori, do ti çojmë këndeje, për ato punë ne asnjë centë nuk e kemi marr se nuk kanë qenë punë tona, ne i kemi aprovuar se na e ka mbushur mendjen si Kompani e regjistruar, e licencuar që dinë që ai projekt duhet të implementohet. Për ata ju çoni 4000 padi se unë nuk përgjigjem kurrë në atë e as nuk kam kurrfarë përgjegjësie se jam asamblist i Komunës, e kam votuar e do ta votoj edhe këtë që e bini ju, por siç thanë Agimi dhe Shemi ju duhet shtëpi për shtëpi se i merrni 100-200 mijë euro, e unë këtu që diskutoj më bien 95€ për këtë që diskutoj dhe çka më ... gjatë javës, kështu që i merrni paret merrni edhe përgjegjësin. Nuk është e vërtet që Kompanitë dhe mafia e ndërtimit ka qenë ajo që e përgojoni sot, mafi e ndërtimit kanë qenë arkitektët dhe inxhinierët nuk ka pasur kush që ka mundur të shpëtoj me ju thënë shtoj edhe dy kat se nuk ka gajle, hajt ti paguma ti mu, zgjerohu edhe pak ma andej, dhe ka ndodhur kjo çka ka ndodhur.

Prandaj këtë që e tha Ylli, Agim mos hesht se je Zyre ligjore po i thua veti, po rin aty, po të shikojmë të gjithë ty si njohës i ligjeve, mos më ri aty se nuk kam nevojë se e qesim dikë që është më i mirë, të doket bile, nuk na e vranë syrin. E dinë mirë që në vitet e 70-ta prej lumit të Tauk Bashçes lartë, deri tek Kroni i Hajdukut, shoku e din, është e eksproprijuar jo e nacionalizuar, Yll, qysh i kanë nacionalizuar si tokën time për "drzhavni neprijatelj", është e eksproprijume me plan për qendra rekreativo-sportive. Por, në atë ligj të atyre shokëve atje, e keni pasur ju atë ligj që nëse dhjetë vite nuk shfrytëzohet , kthehet në gjendjen fillestare, pronari është ai i cili e ka pasur.

A është ashtu Agim?

E tash, nuk është implementuar ai projekt dhe njerëzit i kanë bërë letrat pronarët, sikur që tha Agimi, ne kemi qenë udhëtarë të asaj gjithmonë, prej gjashtë vjetësh, kështu që ua ka kthyer pronat, i kanë blerë shqiptarët, për fat të mirë tash i kanë, ua pafshin hajrin, njëqind rob në të u bëfshin. Duhet me adaptuar, zonja apo zonjusha e kompanisë, atyre ndërtimeve dhe asaj prone komplet planin, e mos të vijnë qytetarët e me nejt me pankarta para dere për qejf të dikujt që po dua me i qitur zë vetit, unë që e shpëtova Prishtinën, që i rrënova ose pse nuk i lash me u ndërtuar dy shtëpi ose katër shtëpi.

Puna e heronjve është përfunduar, po e shihni, nuk kemi vend ku me i qitur më heronjtë, është mbushur, prandaj, ju lutem, të jeni serioz, punojeni ashtu qysh mundet me u implementuar në mënyrën më shkencore. Derisa ka ditur me u zbuluar.... edhe ju një plan detal mundeni me e zbuluar.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, Shefki!
Urdhëroni, Hatixhe!

Hatixhe Pupovci : Faleminderit, kryesues!

Desha ta përgëzoj kompaninë e cila e ka bërë Planin rregullues të kësaj pjese të Prishtinës. Mendoj se, meqenëse kjo pjesë e Prishtinës paska mjaft pronë publike, atëherë do të kishte qenë mirë që atje të ndërtohej një shtëpi për pleq, meqenëse lokacioni është shumë i përshtatshëm, mendoj për shkak të planit të Gërmis edhe për shkak të nevojave që ekzistojnë, si pasojë e mënyrës së jetesës në kohën në të cilën po jetojmë. Prandaj, ndoshta në ato hapësira të përbashkëta kishte qenë mirë diku të parashihet edhe një, apo të planifikohet edhe një shtëpi e pleqve.
Ju faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, Hatixhe!
Urdhëroni, Kimet!

Kimet Zeqa: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje Kryetar dhe të pranishëm.

Mi mori fjalët doktoresha Hatixhe, që tha një shtëpi të pleqve. Që tha 50% pronë shoqërore private, e përgëzoj kompaninë edhe arkitekten, zonjën, më pëlqeu shumë projektuesi, por prej përvojës sime ose që jam e Prishtinës, që kam lindur këtu e krejt, mos të jenë shembull edhe Sofalia si Pejtoni, se asnjë planifikim urbanistik deri më tash që është bërë, nuk është realizuar, ndoshta tash e masë do të realizohen. Por, ajo është një zonë ekologjike, mendoj se edhe arkitektët duhet me punuar në këtë drejtim, mos të ndërtohen ndërtesa të larta, e të jetë një shembull, e jo me u bastarduar apo me shkatërruar një plan urbanistik, apo le të ndërtohen si Pejtoni, që ka qenë e jo tash si është bërë pas 50 viteve, le të jenë afatgjate, se dikush tha pas katër viteve, por mundet edhe pas 40-50 viteve me ndërtuar objekte të larta. Kisha me dëshiruar me pru një ligj, që atje mos me u ndërtuar objekte të larta. Shembulli për mua është Pejtoni i shkatërruar.
Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!
Ramabaja, pastaj Ylli.
Urdhëro, Ylli!

Ylli Hoxha:

Me Shefkiun, mirë që e përmendi, se qe po del Shefkiu që po e din rastin për të cilin po flasim, edhe është i informuar plotësisht, dhe po më vjen shumë mirë.
Ky rrip, po supozoj, është eksproprijuar për me u bërë zonë e gjelbër dhe kur bëhet zonë e gjelbër nuk ndërtohet, nuk ka çka me u implementuar, vetëm në çoftë se e lenë bari. Nuk e kuptoj unë se si ka mundur me u kthyer me konstatimin që e ka implementuar projektin, do të thotë edhe Gërmia është eksproprijuar me të njëjtin qëllim, çka me bë tash

edhe livadhin e Gërmisë me e kthyer, sepse ai është i njëjti projekt, livadh është, livadh ka mbetur, rruga është bërë në mes, livadh ka mbetur në të majtë dhe në të djathtë, ajo është implementimi i projektit të gjelbër, nuk është me bërë ... , a po kupton?! Por, sidoqoftë, edhe nëse e ke mirë ti, Komuna na ka borxh për këtë zonë, le ta merr dhe ta analizojë a është ekspropriuar. Nëse është ekspropriuar, në çfarë baze ligjore është kthyer ajo tokë dhe a ka qenë e ligjshme apo jo. Ta bëjmë një debat mbi këtë temë, sepse nuk bënë hektarë e hektarë të Komunës ne me thënë po na shpronësohen me një interpretim gjysmak ligjor. Le të ketë një dokument, i cili në formë të shkruar na vjen në Kuvend edhe thotë toka është shpronësuar, i është kthyer pronarëve mbi këtë apo atë nen të ligjit. Përndryshe, kërkoi zyrtarisht si Grup i asamblistëve, që kjo të na vjen në një seancë të ardhshme, ose zyrtarisht të na vjen secilit në veçanti, pra si sqarim edhe nga Drejtoria e Urbanizmit edhe nga ajo e Pronës, edhe ajo e Kadastrit.

Kryesuesi: Faleminderit, Ylli!
Urdhëro, Lirak!

Lirak Çelaj:

Pa dashur ti përsëris shumë gjëra, me të cilat pajtohem me shumë komente prej kolegëve që u thanë, unë kisha dashur vetëm të theksoj apo të kërkoj ta ketë parasysh kompania, por edhe Drejtorati dhe Kryetari, që është mirë që të diskutohet me qytetarët, të merren edhe propozimet e tyre dhe iniciativat e tyre, por jo gjithmonë qytetarët kanë vizion të qartë se si duhet të zhvillohet ndonjë lagje apo ndonjë pjesë urbane.

Ata mund të dalin me kërkesa, siç e tha parafolësja, që ajo pjesë të bëhet me ndërtesa të larta krejt, sepse mund ta shohin ndonjë interes të përfitimit, dhe ne nuk duhet t'i pranojmë këto gjëra. Unë mendoj që qytetarët jo gjithmonë janë vizionar, ata mund t'i dinë cilat janë nevojat e tyre imediate që i kanë, por atyre duhet të ju ofrohet një vizion, ndoshta kur ta shohin ata do ta përkrahin, por duhet të shkohet me disa propozime më konkrete, të cilat nganjëherë mund të jenë ndryshime edhe më radikale, e jo vetëm Komuna në përgjithësi, por qeverisjet komunale duhet të jenë më të guximshme, ndonjëherë edhe të rrënojnë jo vetëm kur është puna pa leje.

Mund të jetë një objekt me leje, por nëse ndryshimi i qytetit është për të mirën e zhvillimit të qytetit, ne duhet t'i bëjmë edhe rrënimet e tilla, natyrisht duke i kompensuar dhe duke mos e dëmtuar asnjë qytetarë.

Prandaj, unë mendoj se kjo është një pjesë që nuk i përket vetëm banorëve të kësaj lagjeje, në kuptimin e asaj që është interes i të gjithë qytetarëve, sidomos për shkak të parkut dhe për shkak të gjelbërimit, dhe duhet të kenë parasysh vullnetin e të gjithë qytetarëve të Prishtinës.

Faleminderit!

Kryesuesi: Mirë, faleminderit!
Urdhëro, Flamur!

Flamur Shala: Faleminderit shumë!

Mua më bëri përshtypje kjo kërkesa e Yllit, lidhur me atë, d.m.th. që i kërkoi Komunës që në një mbledhje të na vij me një interpretim ligjor.

Unë mendoj se ne kemi të drejtë të kërkojmë interpretim ligjor, por ka mundësi që Komuna të mos e bëjë atë dhe ka të drejtë të mos e bëjë, kështu mendoj.

Nëse Yllit i intereson shumë interpretimi ligjor për këtë çështje, le të hulumtojë vet, bashkë me grupin e tij, dhe le të na vij ai vet me interpretim ligjor, më së miri është kështu, lidhur me këto prona, lidhur me eksproprijimin e tyre etj.

Faleminderit!

Kryesuesi : Urdhëro, Sadri!

Po më vjen keq prej Sadriut, qe dy herë po e ngrit dorën.

Urdhëro, Ylli!

Ylli Hoxha: Flamur, faleminderit që po ma jap këtë të drejt me dal me hulumtuar, unë ashtu-kështu e hulumtoj këtë çështje, pa asnjë dyshim, mundohem të kryej punë. Nuk e di pse po të pengon që Komuna si institucion të na vjen me një sqarim, nuk po them që është bërë nami aty. Komuna si institucion, i bie asamblistëve një sqarim ligjor se çka ka ndodhur atje, është një kërkesë e thjeshtë, besoj është legjitime ta dimë ne si Kuvend se çka ka ndodhur me atë rrip, nëse është eksproprijuar, si ka ndodhur që të kthehet në prona private?!

Është një pyetje legjitime e një asamblistit, një përfaqësuesi në këtë Kuvend.

Kryesuesi : Flamur, urdhëro!

Flamur Shala: Komuna udhëhiqet nga Lëvizja Vetëvendosje dhe Ylli është në LVV. Nëse këta nuk komunikojnë në kuptim institucional edhe për këto sqarime, nuk mund të obligohet tash një Kuvend të kërkoj nga Komuna që të ketë interpretime ligjore nga ajo, në këtë kuptim po e them unë. Prandaj, është e mundshme që ta bëjë këtë kërkesë Ylli dhe duhet ta bëjë vet, e Komuna nëse donë na e jep këtë interpretim. Unë mendoj që nuk e ka atë obligim Komuna të na e bëjë interpretimin ligjor, dikush tjetër do duhej ta bënte.

Faleminderit!

Kryesuesi : Faleminderit!

Urdhëro, Sadri!

Sadri Ramabaja: S'ka gjë, sepse Flamuri të krijon mundësi të gjuhesh në portë krejt shpirtshëm, sepse nuk merr vesh shumë në politikë. Problemi është ky, ai e kupton Komunën, grupin institucional, si parti, do të thotë e identifikon partinë me shtetin, grupin institucional me shtetin. Kjo është fatkeqësia e përrallagjinjëve që na kanë ardhur në Kuvend këtu. Fatkeqësia tjetër është, sepse këtu po përvijohen dy grupime interesash. Në fjalën e kryesuesit të Grupit parlamentar të LDK-së, u pa se ka tendenca të rehabilitohen uzurpuesit e rripit të gjelbër dhe të legalizohen pastaj edhe të tjerët. Ndërkaq, në fjalën e të gjithë të tjerëve po thujse u pa se ka tendenca shumë të qarta që të vjen në pozicionin e mbrojtësit të interesit publik.

Kjo do të ishte mirë që të tejkalohet. Unë kisha parasysh një propozim shumë konkret, se nuk është fjala këtu vetëm tek ky Plan rregullues që na u prezantua sot, kishin të drejtë kolegët parafolës, se jo rrallë, në fakt pikërisht ndërmarrjet projektuese ishin ato që koketonin jo thjesht vetëm me investitorët mafiozë, por edhe me politikanët mafiozë, sepse ato miratime i kanë marr në fund me nënshkrimin e Kryetarit të mëparshëm të Komunës. Por, fatkeqësia është se institucionet nuk kanë funksionuar, prandaj kam një propozim shumë konkret për Kryetarin e Komunës, për Kuvendin këtu dhe për drejtoritë përkatëse, se ka ardhur koha që definitivisht të krijojmë një komision hetimor të përhershëm, që do të merret me këto çështje, sepse nuk janë, nuk është vetëm lagjja "Sofalia" që përballlet me këtë problem. Pastaj, ky Komision hetimor i përhershëm, i përbërë prej zyrtarëve të drejtorive përkatëse, dhe që të jetë edhe më i fuqishëm politikisht, edhe prej dy apo tre anëtarëve të këtij Kuvendi, të merret në mënyrë të përhershme me problemet e uzurpimit të hapësirës publike.

A bën, të lutem, vetëm pak, vetëm ta përfundoj, pastaj vazhdoni.

Dhe kjo, z. Shefki Gashi mund të jetë njëri nga anëtarët e këtij Komisioni, sepse e njeh këtë periudhë jashtëzakonisht mirë.

E qartë, po tërë kohën në temë isha, çështje tjetër është se a e merr vesh apo jo!

Meqë kemi të bëjmë me 50% që na prezantohet si pronë publike, e në realitet ne jemi këtu, nuk vijmë prej Marsit, ajo zonë nuk është 50% pronë publike, është e uzurpuar. Ndërkaq, te eksproprijimi, shkëmbimi dhe procedurat tjera juridike që janë kryer në vitet e 80-ta, sidomos në kohën e Millosheviqit, Gashi e dinë shumë mirë se aty pronarë real kanë qenë serbët. Ata kanë marr pronat, për atë pronë janë këmbyer në Çagllavicë, dhe sot rastësisht pse është gjetur ajo te Sofalia atje, mund të gjenden të tjerat, po të krijohet një Komision i tillë, do të verifikohet se kemi të bëjmë me dokumente në mënyrë eksplicite të falsifikuara, prandaj nuk mund të bëhemi si Kuvend këtu retushues të dokumentacioneve të falsifikuara.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Muhamet Selmani!

Urdhëro, replikë, të lutem dy minuta, Flamur!

Flamur Shala: Z. Sadri Ramabaja, unë e di që e ke kokën stalinizëm, e ke kokën stalinist i përbetuar, këtë e di, dhe ty me të ardhur n'kuti, e dimë që krejt LDK-në e qet para topi, para pushke, por nuk ke mundësi me bërë këtë, e para. E dyta, duhet të mësohesh me demokracinë e këtij vendi, sepse demokracia e këtij vendi i ka marr këmbët e veta dhe po ecën përpara.

E treta, ti ende nuk e njeh Prishtinën, sepse mbi dy lagje nuk i dinë ku janë bile, e Prishtinën për me e njohur, duhet me u lindur në të, duhet me u rritur në të dhe duhet me u shkolluar në të.

Ti je ai, i cili ke jetuar jashtë dhe kalldrëmet e qyteteve të mëdha po donë me i sjell në Prishtinë, por nuk mund t'i bish, sepse nuk të punon mendja me i sjell ato kalldrëme, nuk të punon mendja, sepse ke shkuar me kokën stalinist, ke qëndruar me kokën stalinist, dhe

je kthyer me kokën stalinist dhe po flet me kokën staliniste.
Ti je një stalinist i përbetuar. Kjo kohë i ka shkelur ato ideologji.

Kryesuesi: Faleminderit!

Ju lutem, me kësi fjalori më mos të diskutoj askush.
Urdhëro, Mustafë!

Mustafë Krasniqi: Kryesues, në rregull, unë këtu do të jem, kërkova ta marr fjalën, edhe pse nga kolegu Ramabaja nuk mu përmend emri, por u thirr në kryesues të Grupit, po besoj që aludoj në fjalën e tij, meqë e dhashë në fillim dhe po e them edhe njëherë, dhe po e sqaroj edhe njëherë se nuk pajtoj me fjalën e tij, dhe nuk pajtoj posaçërisht me pjesën që e tha, që ne ose fjala ime në këtë rast edhe grupi që e përfaqësova në këtë temë, jemi ata që merremi për legalizimin e uzurpatorëve. Në asnjë rast nuk e thash këtë dhe nuk jemi, nuk kërkojmë të legalizohen uzurpatorët, por a janë uzurpatorë apo janë pronarë të ligjshëm, këtë e thotë dikush tjetër. Ne po thirrmi në bazë të një Plani zhvillimor që e kemi para veti dhe në bazë të gjitha të dhënave që kjo tokë është tokë private, dhe kërkuam që, në bashkëpunim me të gjithë pronarët, edhe me ne këtu, të trajtohet si duhet dhe të merren parasysh edhe diskutimet e të tjerëve që thanë të bëhet një analizë e thuktë se a do të jetë e përballueshme në aspektin financiar prej Kuvendit të Komunës, prej ekzekutivit, prej Kryetarit, që kjo pronë të trajtohet si e tillë, komplet shirit gjelbërues, dhe të gjitha ato ndërtime që janë bërë, çoftë me leje, dhe janë duke u ndërtuar me leje, edhe ndërtimeve që janë pa leje në proces të legalizimit, të rrënohen. Prandaj, këtu duhet të shikohet dhe duhet të mendojmë. E thamë edhe njëherë që të mirën e qytetarit, posaçërisht të Sofalisë, është planifikuar dhe planifikohet të bëhet ky plotësim ndryshim i këtij plani.

Edhe njëherë po e them, nuk kam kërkuar, por edhe në asnjë rast nuk e thash, që ne jemi ata që kërkojmë që të legalizohen uzurpatorët, por të merren parasysh pronarët e asaj pjese. Tjetër kush është ai që mundet me na dhënë përgjigje a janë uzurpatorë, apo nuk janë uzurpatorë të pronave të tilla.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Urdhëro, Muhamet!

Muhamet Selmani: Faleminderit!

Kryesues, po ndalem pak tek rendi i ditës. Rendi i ditës besoj është mjaft i gjatë dhe na mjafton të gjithëve me e diskutuar rendin e ditës, e mos me dal jashtë temave, por është një send që zakonisht po ndodhë në këtë Kuvend. Sa herë që mblidhemi këtu, gjithmonë hapen tema prej disa njerëzve, të cilët të shikojmë historinë e tyre, të gjithë që bëjnë zhurmë kanë disa transfere, si transfere të lira, dhe e shtroj një pyetje: Çka kishim bërë ne, mos me i pasur këta apo kësi sendesh?!

Faleminderit shumë, dhe të lutem përmbaju rendit, ose-ose në mënyrë demonstrative e lëshoj mbledhjen.

Sadri Ramabaja: Nëse kthehet shiriti, Mustafa e sheh se foli për legalizim, për mundësi, dhe kur ta lexojmë ekstraktin do ta verifikoni. Ndërkaq te Flamuri, unë nuk merrem me Flamurin, sepse nuk jemi të barabartë. Kaq!

Kryesuesi: Faleminderit!
Flamur dhe Sadri, ju lutem.
Urdhëro, Mustafë!

Mustafë Krasniqi:

Vetëm një sqarim, prapë, edhe një fjalë shumë të shkurtë. Unë e thashë dhe prapë po e them, e potencova se ato objekte, me sa e di unë, janë të gjitha në proces të legalizimit, këtë e thashë dhe kjo mund të verifikohet. Në asnjë formë ndryshe as nuk e kam thënë, as nuk e kam menduar me e thënë.

Kryesuesi: Faleminderit!
Urdhëro, z. Pireva!

Sylejman Pireva: Duke ju përshëndetur të gjithëve, nga Kryetari e deri tek gazetari, shprehi dy çështje në prezantimin këtu. Unë nuk jam ndonjë arkitekt, që mund të flas me kompetencë, por për dy gjëra besoj se kam të drejtë.

Kompania që paraqet projektin rregullues të planit rregullues etj. por edhe Komuna që ka planifikime përkitazi me këtë, është e çuditshme që kurrë nuk kemi afatizime, deri kur do të ketë diskutim publik, sa zgjat kjo periudhë, një muaj, dy apo tre, do të thotë ne nuk merremi asnjëherë me afatet. Unë jam për atë që të ketë kufizime në kohë për implementim të çdo gjëje, për rregullimin e çdo gjëje, prandaj edhe për diskutimet e tyre.

Veç kësaj, unë kurrë nuk e shoh zhvillimin e Prishtinës se si është mirë të duket sot, gjithmonë kam parasysh se si do ta shohin gjeneratat edhe pas një shekulli Prishtinën, në mënyrë që tash mos të bëhen gabimet, do të thotë në ndërtimet, në zhvillim, në hapa, që mos të na mallkojnë gjeneratat tjera, sepse nuk ja paskan qëlluar këtë, ose pse kanë qenë subjektiv apo të verbër për këtë. Kjo mendoj se nuk i shkon për dije, por mjafton të lirohemi prej komplekseve dhe interesave të ngushta dhe mendoj se mund të ja qëllojmë siç është më së miri.

Dhe, krejt në fund, përkitazi me dialogun dhe replikën e dy kolegëve këtu, konsideroj që nuk i takojnë megjithatë një akti moral të një intelektualit tonë të merremi me këto insinuata. Unë mendoj se, nganjëherë duke e qortuar tjetrin, del tjetri ndoshta edhe më i skajshëm sesa vet ai për të cilin merret në kritikë.

Ju faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Afati në vendim është i paraparë, diskutimi publik tridhjetë ditë, e kemi në vendim.

Fjalën, e ka Shyqa.

Urdhëro, Shiqeri!

Shiqeri Spahiu: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për të gjithë!

Do të mundohem të mos përsëritëm dhe të kthehem konkret në planin që na u prezantua këtu, në këtë asamble.

Dua një konstatim të përgjithshëm që, nuk ka plan perfekt të kryer dhe nuk bëhet kurrë, përpos projekteve kryesore, projekteve zbatuese. Edhe me ligj, pikërisht pse është një gjendje se gjithherë zhvillohet, prandaj edhe me ligje është paraparë që të bëhet revidimi i tyre në çdo pesë vite, dhe në këtë kontest kemi të bëjmë edhe me planin në fjalë.

Unë dua dokumente, më tepër jam i hendikepuar se kjo CD më ka ardhur e zbrazët dhe nuk kam pasur mundësi vërtet të hyjë brenda dhe ti shoh disa nga parametrat që është material shumë voluminoz, por e di që në raport me planin i cili është hartuar 2007-ën ka qenë rreth 250 hektarë më duket e sipërfaqes, ajo është pak me rëndësi, ndërsa numri i banorëve ka qenë më duket rreth 5.000 e diçka sipas profilit të atëhershëm urban. Ndërsa, gjithashtu ka qenë i planifikuar për të ardhmen, por edhe në këtë periudhë deri në 20 - 21.000, tani a ka ndryshuar, meqenëse janë ndryshuar disa parametra në koeficient, flas në sipërfaqen shfrytëzuese, dhe sa është paraparë, d.m.th që në planin e ardhshëm pesë vjeçar ky plan të realizohet dhe për sa banorë është planifikuar?

Nën dy, po i shohim në këto njolla që janë më se të domosdoshme për këtë regjion, mirëpo besoj se duke pasur parasysh që është një plan me sipërfaqe që e ceka a ka pasur mundësi dhe duhet të hulumtohen që të caktohen edhe ndoshta disa njolla që u tha edhe më herrët këtu për objekte dhe për interes publik. Nëse ka mundësi ju lutem, rrjeti rrugor të kthehet edhe njëherë në sllajd e kam një pyetje konkrete, ndoshta edhe nuk e kam vërejtur, nëse shkojmë nga pjesa perëndimore jugperëndimore gjegjësisht ndër "Kinderdorf" që dilet në rrugën lartë tek Velania, meqenëse është bërë incizimi gjeodezik dhe e keni disnivelimin e asaj sipërfaqeje ndër "Kinderdorf" ju lutem a ka pasur mundësi dhe a ka mundësi të projektohet një rrugë e cila do ta lidh rrugën që quhet tash "1 Tetori" me rrugën "Isa Kastrati" menjëherë që mos të hyhet laurint nëpër lagjen e Velanisë sepse ka pasur, dhe ka vërejtje nga qytetarët. E para, të krijohen kushtet për një trafik më të qetë në atë zonë, dhe nën dy, të krijohet mundësia që vërtet të dilet më shpejtë nga pjesa e rrugës në Tauk-Bashçe në Gërmi me gjithë pjesën e Matiçanit dhe zonën tjetër.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit Shiqeri!

Edhe unë mendoj se kështu duhet të diskutohet lidhur me planin urbanistik. Fjalën, e ka tani Visari.

Visar Arifi: Faleminderit kryesues!

Një kërkesë që kisha dashur me pas, jo vetëm në këtë Plan rregullues, por edhe në përgjithësi në të gjitha Planet rregulluese, është që të merret parasysh jo vetëm lartësia e objekteve të cilat do të lejohen me u ndërtuar ose marrin leje, mirëpo ta ketë edhe një rregullim estetik, që të mos aprovohet një pamje që mundet me e shëmtuar një rrugë. P.sh. këtu e kemi rastin me "Rezidencën Jusaj", që është me të vërtet një shëmti, sa herë nisesh për në Gërmi. Pra, çdo Plan rregullues të mos ketë kushte, ndoshta vetëm të lartësisë së objektit që lejohet të ndërtohet, mirëpo të ketë ndoshta disa linja të materialeve, të pjesëve ose thjeshtë të kërkojë një arsyetim estetik për ta marr lejen që të ndërtohet në atë pjesë. Faleminderit!

Përndryshe, zilja që u përdorë prej fillimit, mu duk ide shumë e mirë, kështu që shpresoj se do të përdoret më shpesh, sidomos në rastet e debateve të panevojshme.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Urdhëro, Fadil!

Fadil Gashi: Faleminderit, Kryesues!

I dëgjova diskutimet, disa i fajësuan qytetarët, por problemi nuk është tek qytetarët. Problemi kryesor është tek ai i cili ia ka dhënë lejen aty, ai duhet me dhënë përgjegjësi se gjithmonë qytetarët – qytetarët, kah e morri ai lejen, qysh e ndërtoj, kush ia dha lejen, derisa nuk japin këta përgjegjësi, prapë edhe këta kështu munden me vepruar, edhe Vetëvendosja mundet me vepruar sikur këta të parët. Do të thotë, kur do të sigurohet jeta e qytetarit, vetëm qytetari paska faj!

Ju faleminderit.

Kryesuesi: Faleminderit!

Dikush tjetër?

Më duket se nuk ka.

Ne e kemi kuorumin me siguri. Para se me kaluar në votim, fjalën ia japim drejtorit të Urbanizmit.

Urdhëro, drejtor!

Liburn Aliu: Ju faleminderit!

Këtu u ngritën disa çështje, pra u ngrit çështja e rripit të gjelbër, për të cilin do të ndalem më gjatë, dhe u ngritën çështje tjera që kanë të bëjnë me gjendjen ekzistuese. Në analizën e gjendjes ekzistuese që kanë të bëjnë me rrugët dhe gjithë situatën në raport me sa duhet t'i përshtatemi në situatës, apo duhet pra ta dëgjojmë përfundimisht zërin e qytetarëve dhe të vendosim vetëm ashtu, apo të kemi një vizion që t'i kundërvihemi asaj e të qesim diçka të re, të bëjmë një ndryshim të madh.

Për sa i përket rripit të gjelbër, janë disa çështje. E para, është Plani zhvillimor urban. Në Plan zhvillimor urban thuhet që ajo është zonë e gjelbër. Planin zhvillimor urban, në shtator të vitit të kaluar, e ka votuar ky Kuvend. Plani zhvillimor urban është si dokument më i lartë se sa Plani rregullativ, dhe Plani rregullativ i subordinohet Planit zhvillimor urban. Ju thatë që kur e keni votuar Planin zhvillimor urban, është thënë që ky plan zhvillimor urban t'i përshtatet planeve ekzistuese rregullative, por nuk ka ndodhur kështu. Plani zhvillimor urban nuk i ka respektuar ato. Ne kemi raste konkrete gjithandej, nëpër secilin plan kemi probleme dhe kontrast të madh në mes të planeve rregulluese ekzistuese dhe Planit zhvillimor urban. Ta zëmë, në lagjen "Kalabria" është një pjesë ku janë dhënë lejet ndërtimore për ndërtime të larta dhe është paraparë me Plan rregullues ndërtim i lartë, Plani zhvillimor urban e ka kthyer në ndërtim individual dhe tash ka leje, e cila është dhënë e nuk ka mundur të realizohet, ai vjen dhe kërkon vazhdimin e lejes, ne nuk mundemi t'ia japim, sepse tash Plani zhvillimor urban e parasheh ndërtim të ulët.

Tjetra, për sa i përket kësaj zone, para se Plani rregullativ "Sofalia" i vjetri, ta bëjë zonë ku ndërtohen objektet rekreative sportive ka qenë zonë e gjelbëruar, ka qenë zonë e gjelbëruar dhe këtu u përmend shumë mirë që ka qenë zonë e eksproprijuar, dhe ne kemi marr edhe atë parasysh. Pra, nëse ka qenë e eksproprijuar dikur dhe ka qenë gjelbërim, i cili e ka lidhur Tauk-Bashçen me Gërminë dhe përnjëherë pas lufte në atë tollovinë e madhe, ato tokat komunale janë kthyer në toka private, dhe tash këto toka private duhet me u kthyer në objekte ndërtimi, këtu duhet me u ndal pak. Nëse themi ka toka private, jo domosdoshmërisht duhet me pasur ndërtim.

Në pjesën ku është Gërmia, përtej unazës, ka toka të panumërta private, dhe të gjithë ata qytetarë vijë dhe kërkojnë që ne të ju lejojmë atyre ndërtim, po edhe Plani zhvillimor urban, edhe zona e Gërmisë është i shpallur si park, është zonë ku nuk mund të lejohet ndërtimi, pavarësisht që ato janë prona private. Edhe këto këtu, janë prona private, mund të jenë edhe gjelbërim, pse mos të jen gjelbërim, pse duhet domosdoshmërisht aty të ndryshohet, sidomos kur e kemi parasysh që dikur ka qenë gjelbërim, i cili e ka lidhur Tauk-Bahçen me Gërminë dhe ka qenë madje e shpronësuar, unë nuk jam që përherë të kthehet në ndërtim. Çka është edhe më e keqe, kur është kthyer në ndërtim herën e kaluar ka qenë ndërtim me një koeficient të ulët për objektet rekreative sportive, dhe janë dhënë disa leje, dhe janë ndërtuar shtëpi banimi kur i kam shikuar ato projekte, dhe jam dakord që duhet marr masa, dhe duhet me shikuar këtë punë, dhe duhet me i hetuar ato rastet krejt, dhe duhet në fund të fundit të japin përgjegjësi edhe zyrtarët që e kanë bërë. Ti e shikon që objekti në kopërtinën e vet, projekti quhet rekreativo - sportiv dhe është një shtëpi në të cilën, në dhomat e fjetjes i ka do asi pesha që i kanë vizatuar ato pesha, dhe thotë është objekt rekreativo - sportiv, dhe në fund e keni ndërtesën, i keni objektet aty, çfarë mund ti shihni, duhet me u ndërmarr masa, dakord jam, edhe do të marrim masa për atë, po ju siguroj.

Tjetra, për sa i përket kësaj zone, duhet ta keni parasysh edhe një element tjetër, jo vetëm brenda zonës, brenda brezit të gjelbërimit, të gjitha këto prona publike kur janë kthyer në prona private, para se të ndodhë Plani rregullativ, ka paraprirë një proces shumë i dëmshëm në krejt komunën e Prishtinës, jo vetëm në këtë lagje. Ka qenë parcializimi, pra sot po duhet me e përshtat, pra kompania po duhet me i pyet qytetarët dhe me shikuar e me i qitë rrugët aty pari ku normalisht janë vetvetiu, rrugët aty që i kanë ndarë vet qytetarët, madje jo që i kanë ndarë qytetarët, por i kanë ndarë gjeodetët.

Mos harroni, që urbanistët më të mëdhenj të Prishtinës nuk janë urbanistë të vërtet ose planifikues, janë gjeodetët, gjeodetët e kanë bërë urbanizmin e Prishtinës. Zonën Prishtina e Re, para se me u bërë plani rregullativ, është parcializuar deri me nga dy ari, dhe në fund tash ne duhet me bërë urbanizëm aty në ato thërmiat e pronave që janë lejuar me u ndarë, janë lejuar me u ndarë. Pra, nëse kanë qenë ara dikur me forma çfarë kanë qenë, forma të parregullta, trekëndësh e katërkëndësh e çrregullt, e të ndryshme, këto janë lejuar me u parcializuar, janë ndarë secili qysh ka dashur për vete. Tash ne duhet me bërë planifikim aty, nuk mundet me u bërë planifikim më aty.

Prandaj, një ndër çështjet kryesore që kanë me qenë për vitin 2015, e që unë do të kisha dashtë së bashku me juve ta diskutojmë deri në fund, e të ju prezantojmë ne si Drejtori se çka do të bëhet, është rregullimi i tokës urbane para se të ndodhë planifikimi. Kjo është dashur të ndodhë nga 99-ta e kënde, kjo ka ndodhur vetëm në vitet e 70-ta. Viteve të 90-

ta është shkatërruar, në kohën e Millosheviqit, normalisht nuk është rikoperuar pas luftës. Prandaj, kur flasim për këto zona ku kemi ndërtime ekzistuese, ne duhet me e përshtatë se ka ndërtesa, shumica prej tyre kanë edhe leje ose nuk mund ti rrënoh të gjitha, dhe ti ke me shkuar me e përshtat situatën aty për me mundë me krijuar kushte sa më të mira për ata qytetarë që jetojnë aty. A për zonat ku nuk kemi ndërtime, duhet ta fillojmë me çdo kusht rirregullimin e tokave është i domosdoshëm për me mundë me pas planifikim të mirëfilltë sikur që ndodhë në cilindo qytet jashtë Kosovës, të madh po flasim.

Çka do të kisha dashur tjetër të shtoj, që më iku pak filli, po për çështjen e matjeve gjeodezike ju e përmendët për gjendjen ekzistuese.

Të gjitha paratë e mbetura që nuk kemi mundur ti realizojmë planet rregulluese sepse kanë qenë të shkëputura një kohë, i kemi qitë në tender Kompanitë që bëjnë matjet gjeodezike, për me i bërë matjet e mirëfillta në gjithë qytetin. Neve së pari na interesojnë matjet e sakta gjeodezike, për këtë gjendje ekzistuese ne do ta dimë si është gjendja ekzistuese. P.sh e kemi rirregullimin e Planit kadastral të lagjes "Mati1", kur e kemi shikuar ajo është bërë prej ortofotos, pra nuk ka dalje të matjeve të mirëfilltë në terren, e ne duhet ti bëjmë matjet e mirëfillta që ta kemi gjendjen ekzistuese dhe këtë e kemi iniciuar. Këtë e kemi iniciuar, jemi duke i sistemuar të gjitha vërejtjet e qytetarëve për me mundë me i pas parasysh edhe kur bëhet fjalë për Planin zhvillimor urban.

Nëse jeni dakord, edhe unë jam i mendimit që Plani zhvillimor urban me të gjitha këto probleme që është, edhe ky konkretisht, tash ne mund ta iniciojmë së bashku idenë e rishikimit të tij për shumë çështje, se ka vërejtje të panumërta. Unë nuk e di çka kemi me bërë me lagjen "Kalabria" , nuk e di se si kemi me vazhduar tutje kur kemi një disklepancë tepër të madhe. Në anën tjetër Ligji nuk e parasheh Planin zhvillimor urban, e parasheh vetëm Planin zhvillimor Komunal, idenë e kemi që këto të dyja ti inkorporojmë në një plan.

Pra, në fund po kthehemi tek ky plani, shiriti i gjelbër është i paraparë, nën një me Plan zhvillimor urban dhe nuk kemi se si ta shkelim atë.

E dyta, ka qenë zonë historikisht e gjelbër në atë periudhë ku janë ndërtuar disa ndërtime, nuk kisha thënë që të ecim më tutje e ta prekim, ta ndryshojmë vetëm se janë prona private, prona private ka edhe diku tjetër.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor!

A pati dikush ndonjë pyetje për drejtorin?

Urdhëro, Sami!

Sami Hamiti:

Kryesues, ne diskutuam pak paraprakisht edhe me drejtorin, çështjen, po flasim për këtë pjesën e shiritit të gjelbër.

Asnjë nuk është kontestuese që ajo pronë është eksproprijuar viteve të 80-ta, dhe është përkufizuar si zonë për rekreacion dhe sport. Asgjë nuk ka ndodhur me planin e 2007-ës, tjetër send është çka ka ndodhur në terren. Është përkufizuar njësoj, pjesë për ndërtime, për rekreacion dhe sport, sepse është eksproprijuar jo për shirit të gjelbër, por për objekte rekreative sportive. Po, po, unë po të flas me kompetencë, nuk desha deri tani me u bërë,

është eksproprijuar dhe ka pasur plus plan detal në pjesën se çka do të ndërtohet si vizion në atë kohë. Ajo nuk ka ndodhur, unë nuk dua të hyj tash në pjesën e asaj elementit si është kthyer dhe kush është fajtor, unë e di zyrtari ligjor që është këtu, nuk po donë nganjëherë me dhënë përgjigje në kuptimin se nuk po donë të interferohet.

Është e vërtet që ne e kemi kërkuar në atë kohë kur kemi ardhur, pas kthimit, të diskutojmë çështjen se si janë kthyer dhe është llogaritur që në kohën kur është kthyer në vitet '91-'92-'93 -'94, është një prej ligjeve që nuk e ka trajtuar UNMIK-u si ligj diskriminues ... edhe në atë kohë kur janë kthyer, tash e dinë Nora dhe këta të tjerët, që me prona nuk kanë administruar vendorët, vetëm kanë menaxhuar dhe kanë zbatuar. Por, nëse edhe këto ndarje që po thotë drejtori, janë bërë jashtë ligjit, duhet të shihen a janë bërë me ndarje, me vendime gjyqësore, a janë bërë ndarje me vendime të Kuvendit, apo janë bërë ndarje me ligj. A e ka lejuar ligji, se tek e fundit planifikimi, e dini sigurisht edhe Kompania që është, që kufijtë e pronave pak a shumë nuk i sheh, por ne jemi në një situatë që në implementim.

Unë prapë insistoj të themi që atë plan zhvillimor qysh po interpretohet, të kërkohet një implementim prej hartuesit të planit zhvillimor urban për atë pjesë, sepse po themi nuk e vëmë në dyshim atë që po e thotë drejtori, që ka probleme sigurisht edhe diku tjetër që mundet me pasur diskrepanca. Por, të kërkohet interpretim çka është menduar, dihet që jo të bëhet, por të thuhet që me Planin zhvillimor urban do të inkorporohen planet rregullative ekzistuese dhe të kërkohet me interpretim.

Nuk është hera e parë që kërkohet, është kërkuar përplotë raste të tjera.

Faleminderit!

Kryesuesi

Faleminderit, Sami!

Urdhëro, Laura!

Laura Zherka: Faleminderit, Kryesues!

Së pari e kam për kompaninë, se në fillim harrova me ju thënë, bëhet incizimi detal i gjendjes d.m.th të evidentohet, atë ditë ju kam përmendur në Komitet për Urbanizëm, të bëhet evidentimi i objekteve cilat kanë leje ndërtimi, cilat nuk kanë leje, edhe cilat janë në proces të legalizimit, d.m.th kanë aplikuar në Komunë për t'u legalizuar.

Tjetra, kompensimi tani më i pronarëve, cilët janë, çfarë forme, d.m.th të merren mundësitë të bashkëpunohet këtu me Komunën, me Drejtorin e Urbanizmit dhe të gjenden mënyra për kompensim të pronarëve. U tha edhe më herët se shumë shpesh, qytetarët nuk kanë faj pse kanë ndërtuar, në çoftë se dikush nuk i ka kontrolluar ata edhe në çoftë se kanë ndërtuar në pronat private, d.m.th. ajo pronë atje e ka statusin e pronës private.

Tjetër, rishikimi i Planit zhvillimor urban, unë nuk e di drejtor pse të shkojmë me rishikim të Planit zhvillimor urban, ku Plani zhvillimor urban për shumë pak kohë do të hiqet nga niveli i planifikimit në tërësi, do të thotë kemi me shkuar me hartat zonale, ku në të ardhmen nuk do të kemi nevojë as për plane rregulluese më tutje.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!
Urdhëro, Kryetar!

Shpend Ahmeti: Faleminderit Laura, sepse për këtë jemi konsultuar edhe me Ministrinë e Planifikimit dhe me konsulentët e USAID-it që kanë punuar në ligj. Është e vërtet që Plani zhvillimor urban zëvendësohet me Planin zhvillimor komunal dhe planet rregullative ndërrohen me hartat e hollësishme zonale. Ne do ta kemi një hartë zonale të qytetit, ku do të flasim për të gjitha planet sa i përket arkitekturës, mirëpo Plani zhvillimor urban mbetet në fuqi, pa marr parasysh kalimit të ligjit i cili është në fuqi dhe nuk ka plane zhvillimore urbane në të, por sipas Ministrisë dhe sipas konsulentëve të USAID-it, nevojitet një dokument i ri, me ç' rast kalimi i dokumentit të ri do ta shfuqizonte Planin zhvillimor urban.

Në këtë rast, sipas tyre, strategjia më e mirë është që të bëhet një mishërim apo përbashkim i Planit zhvillimor komunal me Planin zhvillimor urban dhe ajo të quhet Plani zhvillimor komunal, me ç' rast do të shfuqizohej Plani zhvillimor urban dhe do të na lejonte pastaj që t'i kemi diskutimet më të hollësishme.

Në përgjithësi, Plani zhvillimor urban nuk duhet t'i ketë këto detaje që i ka sot, sepse Plani rregullativ shkon në detaje, dhe kjo e ka bllokuar shumë qytetin, sepse i cakton në disa vende edhe çfarë lloje të fabrikave duhet të kemi në zonën industriale, d.m.th. duhet me pasur më shumë liri që gjatë hartimit të Planit rregullativ të specifikohet deri në detaje.

Plani zhvillimor urban duhet ta ketë parasysh, sa banorë do t'i ketë qyteti, si planifikojmë në zhvillimin e qytetit, sa banorë do të banojnë në secilën lagje, dhe po ashtu ta ketë edhe planin e mobilitetit, e pastaj të kalojmë në këto hartat zonale.

Prandaj, kjo është në fuqi deri sa ta shfuqizojmë me ndonjë vendim apo ndonjë dokument tjetër.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, Kryetar!
Urdhëro, Islam!

Islam Pacolli: Faleminderit, Kryesues!

Unë me të vërtet kisha pasur dëshirë që këto debate ti kthehen realisht temës, për çka edhe ne humbim kohën këtu.

Kjo zonë njihet gjithmonë si zonë gjelbëruese dhe për atë edhe më herët e kërkova që kjo të parashihet sa më shumë, d.m.th gjelbërim dhe të shkon përpara.

Drejtorin e kisha lutur që ka filluar projektin, le të shkon përpara me projekt dhe le ti realizojmë, të japim një shembull nëse mundemi me arritur një shembull sado i vogël që ky planifikim është, një shembull për zhvillim të qytetit tonë, për arsye që kur të bëhen këto debate nuk kisha pasur dëshirë që ne të bëjmë debat me ngjyra politike, për arsye që kjo zonë, këta qytetarë janë të gjithë qytetarëve dhe ne nuk duam ta kthejmë në suaza politike debatin kur e marrim parasysh që ne bisedojmë për një zonë të qytetarit, pavarësisht kush aty banon, dhe të trajtohen në mënyrën më të mirë të mundshme dhe të shkon përpara.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, Islam!
Urdhëro, Shiqeri!

Shiqeri Spahiu: Mua më duhet vetëm një reagim, ju lutem!

Edhe pse nuk jam i prirë që për çdo gjë të lirohem, por megjithatë me diskutimin e drejtorit Aliu, Liburnit, ndër tjerash u cek rreth matjeve gjeodezike që e morën në fjalë Matiçanin, gjegjësisht zonën "Mat".

Unë dua që të ju kujtoj, jo, ju lutem, ju lutem, unë ju dëgjova, do ta them, po e them për arsye se nuk dua me manipuluar me opinion, sepse Kadastri, rendi i tretë i matjeve ekziston, që është bërë nga Agjencioni Kadastral i Kosovës, gjegjësisht nga kompania kontraktuese e tyre, nën mbikëqyrjen e GIZ-it, e cila është partnere me Komunën, dhe në këtë drejtim Komuna ka qenë pjesë e mbikëqyrjes dhe aty janë mbi 520-530 pika. Duhet ta dimë, edhe ju që çdo pikë që është vendosur është konstatuar nga ekspertët, dhe çdo matës, çdo gjeodet që punon, çoftë edhe ai i licencuar, edhe ai i Komunës, për bazë i ka këto pika se 500 pika janë vlerësuar sipas tyre, se unë nuk jam gjeodet, që mjaftojnë që nga këto pika të bëjnë fillimin e matjeve tjera. Duke pasur parasysh se është avancuar shumë teknologjia, duke pasur parasysh se sot e kemi edhe Kopostin, nivelin d.m.th. qendror, i cili është kompatibil me rrjetin evropian gjeodezik, nuk them se nuk ka shmangie e nuk ka gabime, por ato gabime gjithherë korrigjohen, përmirësohen edhe nga ana e kadastrit.

Prandaj, është bërë nga këtu apo aty, nuk është në rregull, sepse nuk e shoh se është diskutim në nivel sa për t'u marr shembull.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, Shyq.

Të lutem, ne askënd nuk e kemi thirrur me ardhur këtu, ne na ka zgjedhur dikush, i kemi do vota dhe duhet të jemi të durueshëm.

Urdhëro, drejtor!

Liburn Aliu: Rikonstruktimi i Kadastrit "Matit1", rikonstruktimin të cilin e ka bërë Agjencioni Kadastral, neve na është dashtë shumë kur kemi filluar me hasur në objekte të cilat po dalin jo mirë në aspektin kadastral, dhe ato matje gjeodezike në atë rikonstruktim të kadastrit nuk kanë vlejtur për neve, përpos matjeve të objekteve të cilat janë bërë deri në vitin 2010.

Nuk mundem me thënë për tolerancën tash saktë, por me gjeodetët i kemi marr e i kemi qitë në kësi, përpos objekteve të cilave iu janë bërë matjet deri në vitin 2010, pra janë objekte të cilave iu është bërë matja në vend ato janë të sakta, për ato mund të flitet për tolerancë plus - minus të pranueshme. Për këto që janë bërë mandej me rikonstruktim të kadastrit, ka shumë objekte të cilat larg janë prej realitetit.

Tash çka do të bëjmë ne, çka po synojmë ne, kur vjen puna te një Plani rregullativ, tjetër është rasti i këtij, sepse ky është nga e kaluara dhe nuk kemi mundur të inicojmë më tash, sepse në kontratë është gjendja ekzistuese se këta e kanë të definuar më me kontratë. Për

projektet Planet rregullative që do të bëhen në të ardhmen, Komuna duhet të mbajë përgjegjësi për gjendjen ekzistuese për informacionin që të ju ofroj informacionin e saktë. Ne duhet t'i bëjmë matjet dhe t'i verifikojmë ato, dhe të jemi edhe duke u bazuar në Planin zhvillimor urban dhe në planet e përgjithshme, t'ia japim thjesht shtigjet kah ka me shkuar një kompani, të mos ketë shumë elemente të subjektivitetit.

Pra, Komuna duhet ta marr përgjegjësinë e vet deri në maksimum, e në këtë rast jemi duke synuar me e bërë këtë incizim të gjendjes faktike në terren.

Për sa i përket Kadastrit "Mati 1", mund ta lëmë për seancën e ardhshme, në detaje ua përshkruaj problemet.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor.

Urdhëro, Sadri!

Sadri Ramabaja: Faleminderit, kryesues!

Agjencioni Kadastral, Plani kadastral, dhe zyrat tjera që kanë qenë të obliguara t'i ofrojnë materialin bazik për ndërtimin e këtij plani, ne po jemi dëshmitar se megjithatë ju kanë ofruar atë, çka po del se është e uzurpuar një pjesë e asaj prone.

Z. Hamiti, por edhe të tjerët që janë marr me ligjet, e dinë që në vitin 1989 ka qenë viti i suspendimit të autonomisë dhe as UNMIK-u nuk i ka marr ligjet e aprovuara, pra pas kësaj date si ligje valide dhe askush nuk mund të fshihet me kthim prone. E din edhe drejtori i Zyrës ligjore që me ligjet pas këtij viti, nuk mund të ketë arsyetim mbulesë. Prandaj, për lehtësim pune edhe të Komisionit që propozova, por edhe zyrave profesionale planifikuese për planet rregullative etj. do të ishte shumë e dobishme që të informohen me kohë, se ligjet që janë aprovuar pas vitit '89 nuk janë valide.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, Sadri!

Urdhëro, Sami!

Sami Hamiti: Faleminderit, kryesues!

Për z. Ramabaja, është e vërtet që është suspenduar autonomia në 89-ën dhe një mori ligjesh që janë aprovuar pas asaj janë shpallur diskriminuese.

Unë e lus që në "Gazetën zyrtare" të marr prej UNMIK-ut, le te merr në evidencë, le te shoh cilat ligje janë diskriminuese e cilat nuk janë. Nuk e kanë trajtuar diskriminues, unë mendoj që është diskriminues z. Ramabaja, ..., por nuk e ka trajtuar UNMIK-u në atë kohë si ligj diskriminues, se jua kanë kthyer edhe 3-4 shqiptarëve. Prandaj, në listën e pjesës së ligjeve që nuk janë trajtuar diskriminues, është edhe kthimi i pronës.

Prandaj, unë po flas me kompetencë, mundesh me gjetur, e gjen në evidencë dhe e shoh se nuk është diskriminuese.

Kryesuesi: Faleminderit, Sami!

Më duket se u shterën diskutimet.

Atëherë, e qes në votim.

Kush është për miratimin e kësaj pike të rendit të ditës?

A ka kundër?

Apstenime?

Me shumicë votash u aprovua pika e rendit të ditës.

Kryesuesi: Kalojmë në pikën e katërt.

Pika e katërt:

Shqyrtimi i raportit financiar tremujor, për periudhën korrik –shtator 2014.

Kryesuesi: Urdhëroni, Kryetar!

Shpend Ahmeti: Para jush, edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, e kemi prezantuar raportin tremujor buxhetor, por, realisht, është raporti nëntëmujor. Këtë e kemi thënë disa herë, që nuk ka kuptim me i nxjerrë shpenzimet veç të tre muajve, por zakonisht shihet çdo tre muaj, raportohet për periudhën si ka shkuar implementimi i të hyrave dhe shpenzimeve. Kisha pas dëshirë që komentet që i bëni, t'i bëni në dy rrafshe. E para, është që në të kaluarën ka pasur edhe vërejtje rreth raportit, pra që të diskutohet a janë tash të përfshira të gjitha informatat të cilat anëtarët e Kuvendit komunal i kanë kërkuar. E di që Samiu i ka pasur disa vërejtje, shpresoj që tash ato janë përmbushur, posaçërisht, jo veç në aspektin e kodeve buxhetore, 14, 20, 21, por edhe informatave për investime kapitale në projektet veç e veç, në mënyrë që anëtarët e Kuvendit Komuna, ta shohin dhe ta kenë parasysh gjendjen aktuale që e kemi. Sa i përket raportit, mund të them se trendi ka vazhduar, unë do ti përsëris disa gjëra, por, në fakt, ato janë vërejtjet të cilat i kemi pasur, apo shënimet të cilat i kemi pas në raportin gjashtë mujor. E para, që dua të flas, është për të hyrat, mbeten ato çështjet e njëjta, të cilat i kemi diskutuar sa i përket realizimit të të hyrave qëndrojmë mirë pothuajse në të gjitha kategoritë, por, natyrisht, problem kryesor sikurse edhe në periudhën gjashtëmujore qëndron te të hyrat prej lejeve të ndërtimit dhe arsytet pak a shumë janë të njëjta, ka qenë që tash e një kohë marrja e lejeve sipas planeve rregullative. Është e vërtetë që ka shkaktuar një adaptim tek kompanitë të cilat tash po e dinë që duhet të marrin leje vetëm sipas planeve rregullative, por më duhet të potencojë që edhe herëve të kaluare, edhe kësaj radhe, e kemi edhe një çështje të numrit të aplikimeve për leje dhe, po ashtu edhe të rënies së mbledhjes së tatimeve në shitblerje të pronës, që do të thotë se në përgjithësi kemi edhe një rënie ekonomike, por nuk do të flas aq shumë për situatën ekonomike në Kosovë, sepse edhe bankat kanë raportuar një rritje të kursimeve, që do të thotë që edhe për shkak të gjendjes politike në vend njerëzit ka filluar edhe të kursejnë më shumë edhe nuk ka aq shumë shpenzime, megjithatë pjesa kryesore, sipas neve, pse të hyrat janë në këtë nivel nga taksat për leje të ndërtimit, qëndron në faktin se ka ndodhur me të vërtetë një riformimi i mënyrës së dhënies së lejes dhe ndaljen së ndërtimit pa leje që e kemi pas në komunën tonë.

Sa i përket tatimit në pronën e paluajtshme, vazhdon po ashtu ai trendi i mirë dhe pozitiv i rritjes së mbledhjes në pronën e paluajtshme. I kemi ndërmarr disa masa. Masa e fundit ka qenë bllokimi i të gjitha llogarive bankare të personave që kanë më shumë se 5000 € borxh, kjo është masë e cila është e kërkuar edhe me ligj që të bëhet. Në të

kaluarën, ka qenë arsytimi që bankat nuk po bashkëpunojnë. Mund të them se kemi pasur një bashkëpunim të plotë me të gjitha bankat, që personat të cilët kanë borxhe të mëdha, ne nuk mund të ua marrim nga llogaria, por i kemi kompetencat që, sikurse edhe Administrata Tatimore, të kërkojmë bllokimin e llogarive përderisa nuk behët një marrëveshje me Komunën për pagesën e tatimit në pronë. Pothuajse të gjithat të hyrat të cilat janë të nivelit më të lartë, janë në plan, siç e thash, me vet përjashtimin e taksave për lejet e ndërtimit. Në tabelën tjetër i keni të paraqitur edhe krahasimet me vitin 2013. Sa i përket planifikimit dhe realizimit, edhe këtu, në qoftë se e shihni, ka dy dallime. Vitin e kaluar nuk kemi pasur mbledhje aq të mirë të tatimit në pronë në krahasim me sivjet, d.m.th. është një dallim, mirëpo dallimi më i madh është në taksa për lejet e ndërtimit. Për periudhën e njëjtë të viti të kaluar, ka qenë diku rreth 8 milion €, ndërsa për periudhën e njëjtë të këtij viti ka qenë përafshisht 5 milion €.

Sa i përket shpenzimeve, e kemi, kisha me thënë, të njëjtën situatë, sikurse edhe në gjashtëmujor sa i përket realizimit të shpenzimeve dhe realizimit të buxhetit në shumicën e kategorive, të cilat janë shpenzime rrjedhëse, natyrisht se aty jemi në zhvillim e sipër. Me shënimin e vogël, natyrisht që kur i shihni pagat ajo jep përshtypjen që janë shpenzua me shumë se që duhet. Këtu e kemi rritjen prej 25%, por ajo ku unë edhe vetë si Kryetar i kam ngrit brengat dhe jam i shqetësuar, natyrisht është investimet kapitale sa i përket realizimit të përqindjes së investimeve. Këtu ka pas disa arsyeje prej arsyejeve që e kam cek edhe ma herët që është një viti i tranzicionit, është një vit ku i kemi ndal disa projekte, disa projekte nuk jemi pajuar, rishikimi i buxhetit nuk ka ndodh me kohë, me gjithë atë një pjesë të përgjegjësishë duhet të marrë unë përsipër natyrisht si Kryetar dhe ekipi i ekzekutivit. Si prioritet, në tre mujorin e ardhshëm, sa i përket informatave për Kuvendin komunal, e kemi që natyrisht mos të na mbesin paratë nga grantet qeveritare, për shkak se granti qeveritar është diçka që nuk shpenzohet deri në fund të vitit, atëherë natyrisht tërhiqet dhe nuk është më.

Sa i përket të hyrave vetanake, këto mjete edhe i kemi bartë edhe nga viti i kaluar. Të hyrat vetanake mund të barten edhe në vitet tjera, por ajo që është trend pozitiv, që kisha me thënë në këtë nëntëmujor, është fakti që, posaçërisht Drejtoria e Infrastukturës dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, tashmë gati i kanë përfunduar të gjitha procedurat e prokurimit për një numër të madh të projekteve, të cilat edhe tejkalojnë shumat për të marr parasysh që të gjitha këto projekte tash më do të zhvillohen. Se sa mund të përfundojnë ato para përfundimit të vitit, jemi duke i bërë analizat e fundit, por, po e them, për një pjesë të madhe të tyre besoj se do të qëndrojnë mirë. Pra, edhe një herë dua ta potencoj që si prioritet në tre muajt e ardhshëm, do të jetë shpenzimi i fondeve nga granti qeveritar. Në tabelat e ardhshme, i keni të definuar projekt pas projekti se ku qëndrojmë me investimet kapitale, sa janë shpenzuar prej projekteve të ndryshme. Dua të potencoj që gjatë muaji tetor nuk është në këtë raport, sepse është muaj i dhjetë, kemi pas shpenzime që arrijnë shumën mbi 1 milion € në këtë investime kapitale, prandaj po e them që është një trend pozitiv, me na jep optimizëm që një pjesë të madhe të grantit qeveritar deri në fund të vitit do ta shpenzojmë. Në krahasim me vitin e kaluar, qeverisja e kaluar diku rreth 1.6 milionë €, i ka kthyer, apo 1.6 milionë € kanë mbet të pashpenzuara në vitin 2013. Nuk dua që të krahasohemi me vitin e kaluar dhe të shohim si do të jetë kjo në krahasimi me vitin 2013, por po shpresojmë që kjo shuma jonë, të cilën

në fund do ta kemi të pa shpenzuar, të jetë edhe më e vogël se aq. Në përgjithësi, jemi të gatshëm t'i përgjigjemi. Kam kërkuar nga të gjithë drejtorët që të jenë këtu, që të ju përgjigjen pyetjeve, në qoftë se keni, edhe për projekte e caktuara kapitale po ashtu. E di që edhe prej Departamentit të Prokurimit kemi kërkuar që të na i dërgojnë të gjitha informata se ku janë në procedurën e tenderimit dhe sa kontrata apo sa është shuma e kontraktuar. Besoj se të gjitha ato informata i keni dhe po e them për çdo projekt të gjithë drejtorët janë të gatshëm të përgjigjen në pyetje e juaja.
Faleminderit !

Kryesuesi: Urdhëroni, z. Hamiti!

Sami Hamiti: Faleminderit, Kryesues!

Kryetari tha: Sami, do ta nxënë, por besoj që do ta relaksojë, sepse ky është një material që është material i numrave dhe shifrave, dhe shifrat janë kokëforta dhe flasin vet. Do t'i analizojmë, do t'i shohim, por paraprakisht, Kryetari tha mirë, që të bëhet dallimi në mesë substancës brenda që është dhe hartimit të këtij raporti. Në rend të ditës, një vërejtje, në rend të ditës e keni "Shqyrtimi i raporti financiar tremujor", në ballinë e keni "Raporti tremujor buxhetor", në esencë ligji përcakton që është raport i Kryetarit për inkasimin, shpenzimin, investimin dhe detyrimet, d.m.th, realisht ai raport duhet të jetë i emërtuar ndryshe, kështu që edhe kryesuesi edhe kryetari, të barazojnë këtë. Është e vërtetë, Kryetari tha që është një raport nëntëmujor, nuk ka të keqe asgjë, vetëm në pjesën e parë, në pjesën e inkasimit të të hyrave vetanake paraqitet tremujori, kurse kjo pjesa tjetër është e trajtume si nëntëmujor. Do të shkojmë ta analizojmë në pjesën nga inkasimi i të hyrave, që është një trend në vazhdimësi, d.m.th. edhe në pjesën e gjashtëmujorit tjetër për afërsisht është i njëjtë si trend i inkasimit. Atë që e tha Kryetari në pjesën e tatimit në pronë, është mirë për t'u vlerësuar, edhe në këtë pjesën tjetër nuk ka faktikisht ndonjë dallim, dhe ky trend i inkasimit bjen që nga planifikimi, sigurisht dhe në fund vitit do t'i kemi diku mangu 5 milion €, d.m.th, trendet qojnë atje. Dhe në atë 5 milion që ne se kemi rishikuar si të hyra vetanake, do të hiqen një mori projektesh nga planifikimi i viti 2014. Normalisht që do të hiqen se nuk do të ketë mjete, d.m.th. është rend që në finale ta jep diku sipas të gjitha parashikimeve që jonë bërë, në bazë të këtyre trendëve që do të jetë diku 78% maksimalisht në 80%, inkasimi i të hyrave nga ato të planifikuara. Tash në këtë pjesën e elementit të marrim, pavarësisht planifikimeve që i kemi bërë në buxhetin 2015, ku realisht kam dhënë vërejtje të mëdha, që është teje planifikuar shuma shumë e madhe e inkasimit të të hyrave, që dhe tash e them që larg mundësisë së inkasimit, por është si planifikim, pjesa tjetër në këtë pjesë të inkasimit të të hyrave me marrë, e përmendi edhe Kryetari, te lejet ndërtimore, por dhe këtu duhet të thuhet që një pjesë e madhe e tyre janë mjete të cilat kanë qenë të lejeve të dhëna më herët dhe që kanë ardhur obligimet e tyre në bazë të garancioneve bankare të paguajnë. Probleme në realizimin, apo në shpenzimin e buxhetit, që në këtë pjesë faktikisht është vërtetuar dhe thash se shifrat janë kokëforta dhe flasin vetë dhe tregojnë një gjendje shqetësuese të shpenzimit të buxhetit dhe kjo gjendje tregon sidomos në dy elemente. Kryetari e përmendi, ato rrjedhëse dhe konsumuse, që janë pagat dhe shpenzimet e komunalive, janë çështje që binë dhe nuk varen as prej ekzekutivit, por në pjesën e shpenzimit të buxhetit në këtë periudhë, në shërbime dhe mallra, që është në nivel 44%, zakonisht dihet që në pjesën e

shërbimeve dhe mallrave përgatitjet janë shumë më të hershme, në kuptimin që të kryhen ato tenderime shumë më herët, sepse nuk lidhen me kohën as nuk lidhen me pjesën e infrastrukturës, prandaj është nivel shumë i ulët i shpenzimeve. Shqetësuesja më e madhja normalisht është te investimet kapitale, dhe në investime kapitale e keni nivelin e shpenzimit të mjeteve në normën 22%. Është norma shumë më e ultë dhe më shqetësuesja në kuptimin, sepse 41 milionë € të planifikuara për investime kapitale, janë shpenzuar 9 milionë €, duke e ditur që periudha e fundit apo pjesa që po hyjmë në nëntor edhe deri më 10 nëntor, e di që dhe Drejtoria e Financave edhe pjesa tjetër mund të procedojnë me procedura të prokurimit, sepse jashtë kësaj kohë më nuk mund të tenderohet dhe një pjesë e madhe e projekteve realisht do të mbeten ose në procedurë, ose në pjesën kur përmbyllet dhe kryhet kjo punë dhe nuk mund të tenderon më për investime kapitale. Nëse i analizojmë shifrat veç e veç, Kryetari e përmend që do të jetë objektivi shfrytëzimi i grantit, që e kuptoj që realisht në këtë element është ma shqetësuesja tash në këtë, sepse të hyrat vetanake kështu ashtu i bart mjetet e tua dhe e bon, por granti është në nivelin shumë të ulët të shpenzimit, e shihni atje, d.m.th, kanë qenë të planifikuara 12 milionë €, janë mbetur në grante të pashpenzuara në përfundim të muajit të nëntë 8 milionë e 842 mijë €. Kjo realisht, me të gjitha trendët, e shihni së këtu kamë pasur suficit dhe nuk do të jetë suficit i vogël, s'po dua të paragjykoj paraprakisht sa do të jetë, por nuk do të jetë, do të jetë një pjesë suficit bajagi i madh, që realisht janë të llogaritura si pikë e pjesëve të humbura, sepse nuk humben, por ju kthehen qeverisë mbrapa, Komuna dhe këta qytetarë ato mjete më nuk i shohin. Po ashtu edhe te pjesa e të hyrave vetanake të këtij viti, shpenzimi është i ultë, është shqetësues, pjesa tjetër pse nuk janë shpenzuar mjetet e bartura, por janë shpenzuar në normën sa është atje, vetëm 3 milionë €, dhe 10 milionë janë të pashpenzuara të projekteve të bartura prej 2013 në këtë vit, dhe të gjitha këto të bien në një situatë ku është ma shqetësuesja të investimet kapitale. Realisht, shpenzimi është shumë i ultë dhe si trend nuk do të arrihet, po ashtu e keni krahasimin me vitin e kaluar dhe mund të them që raporti është shumë real, pasqyron real me të gjitha tabelat dhe mënyrën e shpenzimeve dhe s'ka asnjë vërejtje në të. Në pjesën e vitit të kaluar, 51 milionë, kanë qenë për investime kapitale dhe norma e shpenzimit të buxhetit në këtë kohë ka qenë mbi 40%, te pasqyrat e investimeve dhe detyrimi. I keni të gjitha linjat apo zërat buxhetor, dhe e shihni që nga të gjitha linjat buxhetore realisht janë të paprekura 54 linja buxhetore. Në këtë kohë nuk është shpenzuar asnjë cent, ndërsa në 24 po, shumë thjesht është, e krahasoni, krahasimet janë të thjeshta, dhe e shihni që në 53 zëra buxhetor nuk ka shpenzuar asnjë cent. Kryetari e përmendi edhe çështjen që ai përmban të gjitha elementet. Unë kamë kërkuar më herët që të jetë një raport i Zyrës së Prokurimit, që të shihet sipas planit të prokurimit se në cilën fazë kemi shkuar, por sigurisht që ka dhe anëtarë të tjerë të Kuvendit që do ta trajtojnë këtë temë në kuptimin e asaj pse nuk është dhënë një raport nga Zyra e prokurimit, edhe të shihet edhe projektet të cilat janë mbet edhe cilat janë bërë, dhe të shihet prej këtij pozicioni si linja buxhetore si të emërtume. Po janë dy linja buxhetore shumë të mëdha, janë linja buxhetore për investime në infrastrukturën lokale edhe në infrastrukturën urbane dhe thotë jonë të kontraktuar. S'janë të kontraktuar, sepse janë shuma të përgjithësime. Cilat projekte janë të kontraktuar, janë tenderuar e nuk i kemi në listë dhe nuk janë të paraqitura. Prandaj nuk është edhe shumë shqetësues kuptimi i mjeteve vetanake që barten, është shqetësues që është planifikuar një inkasim shumë më i madh vitin e kaluar e do të shohim që nuk do të arrihet, shqetësuese më e madhe është në këtë raport

edhe në gjendjen që është, sepse raporti pasqyrohet real dhe shpenzimi shumë i ulët në investime kapitale, sidomos prej grandeve. Këtë vërejtje GP i LDK-së , e ka dhënë edhe në tremujorin e parë, sepse i kemi pa trendet qysh janë, po arrijmë në finale dhe do të mbetemi me një suficit me të cilin realisht justifikime të mëdha nuk ka, prandaj është përgjegjësi, zotëri Kryetar. e juaja dhe e drejtorive dhe sidomos po e lamë tash dhe pjesës që është dashur të përgatisin projektet për tenderime këtu, as një relacion, se po shoh më tepër duhet ta bëjë një degresion, të merret me këtë raport drejtori i Financave. Drejtori i Financave në këtë raport është ok. e ka financën edhe pronën; në kuadër të pronës e ka tatimin në pronë, e ka të shkëlqyer si inkasim, pjesën tjetër të shpenzimeve çka i keni qua, i ka shpenzuar dhe ai merr një barrë më të madhe, duke qenë që sektorët tjerët duhet të marrinë përgjegjësi më të madhe për pjesën që si kanë tenderuar. Kjo jep që një raport nëntëmujor, thash, paraqet, e paraqitur në letër është shumë realisht, por tregon dobësi shumë të mëdha dhe është shumë shqetësuese, sepse nuk kemi arritur të procedojmë në investime kapitale, në mundemi mos me bo pjesë këndeje se çka kemi humb, por parashikimet e hershme tregojnë në mes të 6 milionëshit dhe 7 milionëshit, do të mbetën nga graniti i nivelit qendrorë që do të shkojnë në suficit.

Kryesuesi: Urdhëroni, z. Hoxha!

Yll Hoxha: Faleminderit, Kryesues!

Faleminderit, Kryetar!

E kemi lexuar me vëmendje raportin tremujor buxhetor dhe natyrisht se, po ashtu i ndajmë disa prej shqetësimeve që kanë të bëjnë me inkasimin e ultë të mjeteve të, cilat pasqyrohen në tabelën e parë. Dua të theksoj se jo çdo e hyrë duhet të jetë e justifikueshme. Nuk duhet të jetë e hyra e mjeteve, ku t'i matës të zhvillimit në një qytete, po e zëmë në Berlin, në qendër kot e ke, nuk mund të ndërtohet, nuk mund të marrësh të hyra prej ndërtimit, sepse është i konsumuar ndërtimi. Në kryeqytetin tonë ekzistojnë mbi 10 mijë banesa individuale, të cilat janë të pa shitura sot, do të thotë janë banesa të ndërtuara të zbrazëta, të cilat nuk shiten, nuk blihen, të kërkosh që ta përcjellim të njëjtin trend ndërtimi brenda vitit, t'i krijojmë edhe 10 mijë tjera brenda një tregu që nuk e konsumon dot atë hapësirë, pra është e padrejtë të planifikohet rritje ndërtimi, përderisa nuk ka konsum të këtyre banesave. Çështja e dytë, ka të bëjë me ligjshmërinë, do të thotë edhe Lazarati qarkullon, Lazarati ka qarkulluar mbi 3 miliardë dollarë edhe nuk ka qenë legal, pra ka sjellë të hyra domosdo, por nuk do të thotë që secila veprimtari që sjell të hyra duhet të jetë e promovuar. Çështja e dytë, e ngritur nga Samiu, ka të bëjë me shpenzimet dhe këtu i kam dy kute matëse, i para ka të bëjë me mosprojektimin, do të thotë kemi pas, është e vërtetë se viti i kaluar ka shpenzuar më mirë se sivjet, por shikoni si janë shpenzuar ato mjete, a kanë ekzistuar projekte për shpenzimin e atyre mjeteve, apo ka pasur para, pastaj hajt se po i grahi kësaj rruge, del ku del, dhe si pasojë e atyre shpenzimeve, ne sivjet kemi paguar 1.6 milion €, dënim si Kuvend komunal, si buxhet. Drejtorja e Infrasstrukturës nuk e ka trashëguar asnjë projekt për ato 6 milionë €, apo ato 5 milion €, për cilat fole, do të thotë, nuk i është lënë asnjë projekt për realizimin e projekteve lokale dhe në pjesën urbane dhe ato në pjesët rurale. Do të thotë, Hysen Durmishi është dashtë prej fillimit të nis projektimin në vijat buxhetore, të cilat i kemi trashëguar, nuk e kemi bërë ne rrugën "Ndue Përlleshi, nuk e kemi bërë ne, e keni bërë ju, është planifikuar

800 mijë € shpenzim në projekt, por nuk i keni planifikuar mbi 5 milion € shpronësim, të cilit duhet bërë po e bëmë rrugën “Ndue Përlleshi” qyshe e keni planifikuar ju, kjo Komunë duhet t’ua paguajë edhe 5 milionë € dënim pronarëve të tokave të cilat do të dëmtohen. E njëjta ndodh me rr. “Sami Grishta”. E njëjta ndodh me rrugën e Grashticës, sepse keni lanë planifikime kuturu, keni lanë, sepse jeni mësuar me qeveris më shumicë absolute, në formë të pa kontrolluar dhe keni muajt me i bërë ndryshimet qyshe keni dashtë. Ajo kohë ka ndryshuar, ne i bartim disa pasoja dhe ato pasoja do të përmirësohen. Te kuti i dytë, lidhur me shpenzimet, unë kam të bëjë pak edhe me Kryetarin, besoj që duhet ta jep një kritik dhe në këtë pjesë e ndaj vlerësimin. Nëse një projekt merr pesë-gjashtë muaj kohë për me u bërë prokurimi nga Zyra e prokurimit, do të thotë se ajo zyrë e prokurimit është duket sabotuar, ose nuk dinë me e krye detyrën e vet. Nëse kontraktimi i Institutit Gjeodezik për të matë rrëshqitjet e Arbërisë, do t’i merr mbi pesë muaj ditë kohë për tu kontraktuar, do të thotë ajo zyre ose nuk e kryen detyrën e vet, ose nuk dinë me krye detyrën mirë, ose do të saboton. Toleromi i kësaj situate është të kesh mirëkuptim për ata njerëz për të cilët qytetit ka votuar që të hiqen. Nuk ka pasur Prishtina shumë problem me Isa Mustafën, kanë pas problem edhe me eksponentët tjerë në sistem. Zoti Kryetar, presim nga Ju që ta qoni deri në fund mandatin që e keni marr, në mënyrë që t’i ndërroni të gjithë ata sabotueset në sistem, të cilët ngufasin realizimin e projekteve të cilat i keni marr përsipër. Kjo nuk do të jetë e mundur me njerëz brenda sistemi, të cilët sabotojnë secilin hap që e keni. Faleminderit!

Kryesuesi: Urdhëroni, z. Çelaj!

Lirak Çelaj: Edhe një herë, ju përshëndes të gjithëve!

Unë nuk do të hi shumë në detaje, besoj që kolegu im, që është ekonomist, do të hyjë dhe do ta zbërthejë më mirë këtë punë, me gjithë atë nuk mundem pa i përmend edhe disa shifra, për të dhënë një mesazh për performancën e qeverisjes aktuale, e cila, fatkeqësisht, nëse matet me shifra, kjo është gjë është e matshme dhe realizimi i buxhetit është një prej parametrave që mat performancën e cilitdo institucion, atëherë mund të them që kjo qeverisje nuk ka performuar mirë. Natyrisht, ne duhet të krahasohemi edhe me vitet paraprake, për të cilat ne kemi qenë vazhdimisht të pakënaqura, për atë arsyeje, po e përsëris disa herë, Isa Mustafa i humbi zgjedhjet, sepse qytetarët ishin të pakënaqur me performancën, dhe na del që Isa Mustafa me performancë ka qenë me mirë se tash. Për mua është shqetësuese, aq ma shumë kur të gjitha këto parametra i kemi alarmuar, edhe si GP më herët, që trendet e shpenzimit të vjeljeve nuk janë të kënaqshme edhe ka vazhdua, do të thotë nuk keni marrë asnjë masë. Ne ju sugjerojmë, si Grup Parlamentar, juve, Kryetar, që ndoshta kjo do të ishte shkas i mirë që ju të bëni një riformatizim të kabinetit tuaj, bazuar në performancën që e kanë dhënë këtu, edhe është mirë që të merret leksion prej secilit drejtor që nuk mundet të vij këtu vetëm si figurë, por duhet të punojë dhe t’i shpenzojë. Po përpiqem që mos t’ua hedh gjithë fajin juve, ju e keni vetëm përgjegjësinë për emërimin e njerëzve të caktuar, sepse ju nuk mund të merren me secilin departament e me secilën drejtor. Megjithatë, unë mendoj që nëse ju doni të tregoni që keni vullnet për t’i ndryshuar gjërat, hapi i parë që duhet të bëni është që t’i rishikoni njerëzit që udhëheqin drejtoritë e caktuara. Arsyetimi që për shkak të lejeve të ndërimit, se kanë qenë pa leje ka telashe, arsyetimi që dha Ylli, unë mendoj që është krejtësisht i paqëndrueshëm. Atëherë pse nuk

keni reflektuar në këtë, nuk keni kërkuar në rishqyrtim të buxhetit që të ndërrohet kjo pozitë, e keni lënë këtë pozitë. Vet fakti që është e projektuar, ajo duhet të synohet të realizohet, ose të hiqet nga projekti. Unë po e shoh që i njëjti trend, sa e maj mend unë, me shifra të inkasimit nga lejet ka mbetur në buxhetin për vitin e ardhshëm. Pra, duhet dhe këtë punë ta shihni se a ka qenë e planifikuar si duhet dhe nuk besoj që do të ndërrojë situata për tre muaj për vitin 2015, që do të ndërroj aq drastikisht. Ju i keni paraparë të gjitha këto, suficiti do të këtë. Kemi thënë prej fillimit, suficit rekord ndoshta për Komunën e Prishtinës. Nuk ka mundësi që prej 22 %, të shpenzohen edhe 80% për tre muajt e mbetur, duke pasur parasysh edhe klimën tash edhe krejt mekanizmat tjerë, granti, po shihet që do të kthehet shumica e grantit qeveris, që është mëkat, Prishtina me gjitha këto nevoja që i ka për investime, ne të kthejmë mjete, e aq ma shumë ku në këtë foltore ka pasur ankesa që niveli qendror po diskriminon Komunën e Prishtinës, sepse nuk po ja ndan shumën e duhur. Mesazhi që i qon kjo Komunë me nivelin e shpenzimeve, është se ne duhet të zvogëlonim edhe më shumë buxhetin, sepse nuk po jemi të zotë të shpenzojmë buxhetin që e kemi tash, prandaj unë mendoj që ju duhet të mendoni mirë me çfarë njerëz, qoftë edhe me Zyrën e prokurimit, që e përmendi Ylli, nuk e di kush janë ata, por duhet të vini në shënjestër dike për me përmirësuar performancën. Përndryshe, unë jam shumë i bindur që e njëjta gjë do të na përsëritet edhe vitin 2015, dhe nuk mendoj që Komuna e Prishtinës i ka punët që të na përsëriten këto gjëra me vite, sepse jemi lodhur që sa vite kemi qeverisje të dobët dhe nuk besoj që e meriton qytetari i Prishtinës.

Një çështje të tillë duhet të përmendi, që edhe taksa për shfrytëzimin e hapësirës publike është mjaft e dobët, përveç atyre për leje ndërtimi, nuk u fol shumë për këtë punë. Donacionet janë në shkallë shumë të ulët, prandaj janë disa pika për të cilat unë në pika të vrazhda i përmenda kështu. Më konkretisht, besoj që Muhameti do të flasë më detajisht, megjithatë unë e dhashë një mesazh. Edhe në fund krejt, nuk e kam të qartë pse duhet, më falni për injorancën time, pse duhet të votohet ky raport, këtu është një tabelë, janë shifrat, po çfarë përgjegjësie e marr unë si asamblist nëse e votoj, për ose kundër, sepse unë nuk ndryshoj diçka, këto janë raporte të cilat nuk i kemi gjeneruar ne. Nëse unë duhet të merrem me saktësinë e tyre, atëherë unë nuk dua të jem përgjegjës i kësaj performance. Unë po kërkoj sqarim, nëse dikush munde të jep përgjigje, unë nuk e kam të qartë.

Kryesuesi: Urdhëroni, z.Pacolli!

Islam Pacolli: Faleminderit, Kryesues!

Sigurisht që aprovimin e buxhetit AKR-ja e ka mbështetur, do të thotë buxhetin. Po, sigurisht që sot mund të themi që nuk jemi aq shumë të kënaqur më këtë, për arsyeje që disa projekte nuk janë realizua. Janë dy-tri pika që janë të rëndësishme për mua dhe grupin tonë, pa e cekur të gjithë, për arsyeje se të gjithë folën. Tani nuk e di sa janë të gjitha të sakta, megjithatë ne kemi kërkuar qysh nga fillimi që projektet kapitale të realizohen në maksimum, për arsye që grandet neve na ikin dhe për vitin e ardhshëm nuk kemi mundësi ti kemi, ka mbetur edhe pak kohë. Një sugjerim i imë është që të fuqizohet në këtë drejtim dhe të shkojnë përpara, po ashtu dua me theksuar që çdo projekt që bëhet, sidomos në infrastrukturë, mos të shkojë si vitet e kaluara, pa projekt ndërtimi të rrugëve, për arsyeje që ne tani po ndërtojmë apo kemi ndërtuar në vazhdimësi nga dy here një rrugë, kështu që ju lus edhe

Kryetarin, edhe drejtorin e infrastrukturës, që t'i funksionalizoni projektet. Projekti i cili bohet jo vetëm projekt ideor, por projekt realizues, kostoja është më e vogël, mundësia është më e madh të kontrollohet dhe mos të humb buxheti, do të thotë për arsyeje se ky buxhet është i taksapaguesve të kësaj Komune. Unë nuk dua me zgjat shumë për të dhënë shumë kritika, për arsyeje që kanë edhe të tjerët me fol, megjithatë kisha kërkuar që të kthehet vëmendja në investime kapitale që të përmirësohet jeta e qytetarit, le të bëhet më e mirë, për arsyeje që ne ende ecim nëpër lloç, pa infrastrukturë.

Kryesuesi: Urdhëroni, z. Rusinovci!

Imer Rusinovci: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit!

GP i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës për Prishtinë, e ka analizuar me kujdes këtë raport tremujor, për periudhën korri-shtator, dhe secili, individualisht, nga ne kemi nda disa brenga, disa shqetësime, në veçanti për trend jo normale konform realizimit të projekteve zhvillimore dhe, po ashtu është një breng tjetër, e cila është e pranishme tek ne, për mundësinë e krijimit të suficitit nga grandit qeveritar. Nuk kemi dalë këtu as të kritikojmë, as të paraqesim pasqyra, sepse ato janë ato që janë, por konsiderojmë që këtë vit të parë garnitura qeveritare, sigurisht se nuk i ka konsoliduar mirë radhitjen e prioriteteve në realizimin e tyre dhe unë mendoj se një nga vëmendjet e ardhshme, kjo garniturë qeveritare duhet ta ketë për vitin pasues, sepse, në të kundërtën, do të përballemi më një suficit, e në veçanti nga grantit qeveritar, dhe mendoj se këto duhet të jenë disa nga vërejtjet të cilat mund të lënë pasojë edhe në vitet tjera. Në parim, do me thanë mendoj se ka detale që mund detajzohen nga ekonomistët, se ka këtu të pranishëm, dhe në pika të shkurta kjo është nga ana jonë.

Kryesuesi: Urdhëroni, z. Mehdiu!

Feti Mehdiu: Ju faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për të gjithë!

Ne e kemi shikuar këtë pikë të rendit të ditës dhe aq sa kemi muajt ne të thellohem dhe ti analizojmë këtë gjëra, disa gjëra që u thanë këtu, ne nuk mund të qëndrojmë pas të gjithave, ne nuk qëndrojmë pas atij insistimit që të gjitha projektet kapitale duhet të vazhdohen ashtu si janë, ne aty kemi një rezervë. Ato projekte duhet të vazhdohen, pos që ajo zyra që e përmendet edhe tash të auditimit, ishte puna e asaj analizës që mi pa se si janë filluar ato projekte në ato deri tash, personalisht dhe grupi jonë nuk e ka shumë të qartë se në çfarë bazash jonë mbështetur ato, sepse ka disa defekte aty.

Në parim, këtë rend të ditës e përkrahim kështu siç është, me sugjerimet që të merren parasysh të gjitha punët si janë filluar, se vazhdimi asaj, si i dëgjojë unë këtu, se humben grantet, ma mirë lë të humben tash sesa të rritet përgjegjësia dhe të bëhet më e madhe, në qoftë se ata tash vazhdojnë ashtu siç janë, mandej hynë në një thes të gjitha këtu. Ne insistojmë për një sqarim, të jenë të qarta punët. A të vazhdohen, për neve nuk është shumë e rëndësishme, pse nuk janë realizuar ato lejet, ai vazhdimi, për shkak se unë e di që ato informata që i kemi, ato janë penguar për shkak të paqartësive të dokumentacionit. Ajo

mund të lidhet me diskutimet që u bënë paraprakisht. Unë e di pse votoj këtu për këtë pikë të rendit të ditës, unë votoj për këtë që qeverisja aktuale të vazhdojë punën, gjithmonë duke pasur mbi veti atë përgjegjësinë që ua kërkoj unë, do të kërkoj përherë po ta vazhdojnë punën me disa gjëra, që këtu u thanë shumë gjëra të mençura, nuk ndalem te ato imtësitë ekonomike atje, sepse disa gjëra edhe nuk e kemi borxh të gjitha t'i dimë, por në këtë Kuvend ju që i dini më mirë, jeni më konkret dhe përgjegjës në këto. Unë mendoj që nuk përfundon më nëntë muaj, por me një vjet. Kur të kryhet një vit, sigurisht që do t'i kemi punët më të qarta se çka kemi bërë dhe si duhet të vazhdojmë.

Kryesuesi: Urdhëroni, znj. Fazliu!

Abetare Fazliu: Përshëndetje edhe një herë për të gjithë!

Nuk po hyj shumë në detale, se shumicën veç i përmendët, mos të përsëriten, me vërejtjet që u ceken, do të ishte mirë që të shqyrtohet edhe një herë ky raport, sidomos te çështja e infrastrukturës.

Kryesuesi: Urdhëroni, z. Arifaj!

Visar Arifaj: Faleminderit, kryesues!

Partia e Fortë e ka shqyrtuar këtë raport në hollësi dhe ajo që ndoshta kishim dashtë me përmend me fillim, është që te realizimi i të hyrave vetanake punën më të mirë e kanë kryer qytetarët tanë, të cilët e kanë thyer ligjin dhe në këtë mënyrë të hyrat prej gjobave në trafik janë 97%, që na lë të kuptojmë se deri në fund të vitit do të ketë tejkaluar edhe 100% , kështu që qytetarët janë ata që kanë kontribuar shumë, duke i thye rregullat e trafikut. Besoj që, duke e pasur parasysh këtë fakt, edhe Inspekcioni duhet ta bëjë një punë më të mirë, sepse nëse ka thyerje të ligjit, atëherë duhet të këtë të hyra më shumë se 2% nga inspekcioni, përndryshe brengat Partia e Fortë i ka me partitë tjera. Sa i përket shpenzimeve të Komunës, ne e kuptojmë që është një qeverisje plotësisht e re dhe ka shumë mospajtime në mënyrën se si duhet të shpenzohen krejt këto dhe mënyrën si janë përzgjedhur këto, mirëpo, në anën tjetër, nuk mundemi më mbet tash pa realizua asnjë projekt vetëm për shkak se nuk është në përputhje me qeverinë e re. Jam i sigurt që përplot projekte qëndron arsyetimi që kanë qenë të projektuar keq, sidomos te infrastruktura rrugore. Pra, në anën tjetër, nuk besoj që mundet me u përdor arsyetimi i njëjtë për çdo projekt që veç ka qenë i planifikuar, pra ajo çka ndoshta e kërkojmë ne, besoj si të gjithë asamblistët e tjerë, është që ta kemi një shpjegim pak më të qartë pse shumë prej projekteve nuk janë realizuar, jo vetëm ato që kanë qenë të projektuara keq, mirëpo edhe disa që kanë zgjatur njësoj, sikur Ylli që e përmendi, thjesht, procedurat e prokurimit me marrë më shumë se gjysmë viti, atëherë është e papranueshme. Atëherë, ajo që është me rëndësi është këto trendët, këto që po e shohim deri sot, mos të përsëritën, ta identifikojmë ku është problemi edhe ta zgjidhim prej aty dhe të mos mundohemi që me një shpjegim ose me një akuzë, t'i përfshijmë të gjitha shpenzimet që nuk janë përfunduar, ashtu siç janë parapa, në mënyrë që mos të na teprojnë pare në fund të vitit, se përnjëmend nuk ka kuptim.

Kryesuesi: Urdhëroni, z. Selmani!

Muhamet Selmani: Faleminderit, kryesues!

Ne si grup dhe unë personalisht, jam munduar me e analizuar raportin nëntëmujor dhe tremujor, i cili është i Komunës. I kamë disa vërejtje në raport. Me këtë raport të paraqitur përveç formës, të cilat janë paraqitur disa projektet dhe informacionet e dobëta, shqetësimet e mëdha, siç thanë edhe parafolësit, janë të shpenzimet kapitale. Jam munduar me ba një përshkrim, po mundohem ta lexoj shkurt. Bazuar së pari në raportin për të hyrat vetanake, shihet se Komuna jonë ka dështuar në realizimin e të hyrave në dy kategoritë kryesore të buxhetit, që janë nga lejet e ndërtimit edhe shfrytëzimi i pronave publike. E them këtë, sepse ky tremujor ose tremujori i kaluar, ka qenë koha më e mirë kur ne kemi mundur t'i inkasojmë të hyrat nga dy kode buxhetor, janë lejet e ndërtimit, siç thash më herët, dhe shfrytëzimi i sipërfaqes publike, qysh dihet për tarracat e restorantet dhe lokaleve të ndryshme dhe të tjera. Bazuar në planin e të hyrave vetanake të viti 2014, që është 24 milionë e 318 mijë €, dhe raporti që është për këtë tremujor, që është 4 milionë e 565 mijë €, shihet që Komuna ka arritur t'i realizojë vetëm 18,8% të hyrat e planifikuara për këtë periudhë, kur ja shtojmë kësaj raportin e tremujorit të kaluar, që pothuaj ka qenë i ngjashëm, që dihet se vështirë se do ta realizojmë planin e buxhetit për vitin 2014. Do të thotë se në periudhën gjashtëmujor të vitit ne nuk mund ta realizojmë asnjë, absolutisht, planifikim mbi 20% të asaj që është e bërë. Çka do të bëhet në sezonin e dimrit, kur është tremujori i ardhshëm, duke filluar prej janarit deri në mars, kjo situatë nuk do të ishte shumë shqetësuese, sikur mos të kishim një krahasim me planin e buxheti të vitit 2015, kur dihet se buxheti ose të hyrat vetanake janë planifikuara për 10 milionë € më shumë. Tani shtrohet pyetja - Nëse nuk mund ta realizojmë planin që është i tanishëm, si mund që të besojmë se do të realizohet plani i viti 2015? Unë uroj që shqetësimi im të jetë shumë i gabuar dhe këtu t'i shohim rezultate 100% të Komunës në vitin 2015. Në këtë raport janë paraqitur edhe disa të arritura, p.sh. kemi 1 % shumë më të lartë të inkasimit të të hyrave në pronë, certifikata, dokument zyrtare, taksat për automjete motorike, shërbimet shëndetësore, shërbimet arsimore dhe të tjera, mirëpo nëse e analizojmë me kujdes këtë raport, këto pesë kategori që paraqiten si sukses, këto bëjnë vetëm 22%, të totalit të buxhetit të planifikuara për vitin 2014, apo e thënë ndryshe, nëse inkasohen 100% ato bëjnë vetëm një të pestën e buxhetit, nuk mund të themi se është një sukses. Këtu paraqitet dhe një vërejtje që e kam në planifikim. Në planifikim thotë që këtu kemi inkasuar ose planifikuar 4 milionë e 600 mijë €, prej taksave në pronë, kurse faktikisht fatura e liruara është 5 milionë e 427mijë €, nëse e krahasojmë, atëherë del që ky raport ose ky plan, ose ky kod buxhetor, realizohet vetëm 75%, e jo 89%. Po ashtu vërehet se ky është një ndryshim në planifikim për 32%, në raport me faturën dhe planin e paraqitur në skicat e viti 2012. Një tjetër shqetësim e kam edhe te aftësia ekzekutive në raport me donacionin dhe grantet e ndryshme, edhe pse është paraparë që të arrihet 870 mijë € grante, në kemi vjelur në këtë mujor vetëm me 25 mijë €. Një tjetër e dhënë që është në raportin e të hyrave nga kodet buxhetore, është e paqartë shitja e pasurive, që është 270 mijë €, dhe shpronësimi prej 812 mijë €. Në këtë rast këtu nuk kemi të hyra, sepse në këtë rast kemi zvogëlim të pasurisë në raport me parat e gatshme, por shqetësimi im nuk është këtu, shqetësimi është te mungesa e informatave për atë se çfarë pasurie është shitur, çfarë pasuri është shpronësuar në këto dy kode. Ky raport nuk ka asnjë të dhënë për këto aktivitete. Shqetësimi është se në planin buxhetor të viti 2014, këto kode janë të barabarta me zero. Mirëpo, nëse i krahasojmë të hyrat

me pagesat, atëherë dhe dinamikën e realizimeve të shpenzimeve, buxheti i realizuar e ka një fill shprese, sepse Komuna jonë edhe pse ka pasur një plan shumë të madh dhe një buxhet prej 78 milionë €, ka arritur të shpenzojë vetëm 34 milionë €, apo 44%, dhe kjo bëhet tamam më pyetjen tënde, Kryetar, të fundit, kur thuhet se të hyrat i kanë mbuluar 100% shpenzimet. Ajo që më së shumti më shqetëson, është kodet, pikërisht grantet për investime të kapitalit, kodi 10, 22, të hyrat vetanake, dhe kodi 21, të hyrat vetanake, të bartura nga viti 2013. Te grantet qeveritare ne kemi pasur në planin buxhetor 12 milionë €, të hyrat vetanake 13 milionë e 800 mijë € dhe të hyrat vetanake për 2014, janë 15 milionë e 470 mijë €. Nga ky total i përgjithshëm, që bën 48 milion €, ne kemi arritur të shpenzojmë vetëm 9 milion €. Shqetësimi im kryesor është, sikur i të gjithë të tjerëve, te granti qeveritar dhe, siç shihet dhe siç dihet, pagesat e fundit mund të ndodhin vetëm deri me 22 dhjetor të vitit. Po ashtu, siç dihen edhe nga plani i prokurimit, asnjë zotim apo plan i prokurimit nuk mund të zotojë mjete për investime apo plane për tender, apo investime kapitale, pas datës 1 nëntor të fundvitit, për arsyeje të procedurave të cilat marrin pastaj. Shqetësimi është që ne e dimë që këto para do të na tërhiqen, shqetësimi tjetër është edhe të projektet e bartura nga viti 2013, të bartura në vitin 2014, që kemi me i pas 13 milionë e 380 mijë €, kurse kemi shpenzuar vetëm 3 milionë, diku 10 milion janë mbetur pa u shpenzuar. A ka arsyeje kjo të barten në vitin 2015, e po ashtu ka një ngecje të madh në realizimin e projekteve kapitale të parapara për vitin 2014, për 15 milionë e 470 mijë të parapara në planin e buxhetit 2014. Ne kemi arritur për nëntë muaj ditë t'i shpenzojmë vetëm 2 milion e 700 mijë €. A thua mund t'i shpenzojmë edhe 12 milionë të tjera për tremujorin e mbetur?! Nëse e shohim me kujdes tabelën e projekteve kapitale, që e përmbledh të gjithë shqetësimin tim, është sepse në shpenzimet kapitale ne kemi para diku rreth 81 kode, së paku në tabelën që shkruan është ashtu, 81 kode, apo projekte për realizime kapitale. Nga këto vetëm 24 shkruan se janë të përfunduara, mirëpo në këto projekte është një pjesë e madhe e mjeteve të projekteve të përfunduara, të parapara për këto projekte në këto raste, ose kemi një realizim të pjesërishtëm, ose janë raste kur projekte e realizuara nuk janë realizuar plotësisht. Edhe nëse janë realizuar plotësisht, pse mjetet e tepruara nuk janë bartur në kode të tjera, apo të planifikuara në kodet tjera. Një tjetër është këtu, kemi dhe gjashtë projekte, janë të planifikuara për vitin e ardhshëm, si mund të planifikohen që gjashtë projekte të barten në vitin e ardhshëm pa e marrë aprovimin nga ky Kuvend. Po ashtu, dhe 10 projekte janë të pa aktivizuara fare, janë të shkruara në kode, por që janë të pa aktivizuara, 41 projekte të tjera janë të paraqitura si projekt të kontraktuara, apo në proces, mirëpo për asnjë nuk ka asnjë informatë për vlerën e kontraktuara, apo fazën e realizimit, vlerësimit në të cilën gjendet gjendet etj. Ndërsa situata më shqetësues është të projektet e bartura nga viti 2013, nga 40 projekt të bartura në vitin 2014 nga viti 2013, vetëm 9 projekte figurojnë se janë të përfunduara, kurse 31 projekt figurojnë se janë në fazën e tenderimit dhe të vlerësimit. Duke i pa të gjitha këto vërejtje, unë këtë projekt nuk e shoh që ka pas ndonjë sukses Komuna në realizimin e projektit, siç e tha dhe kryetari jonë më herët, Liraku e jo Shpendi, unë besoj që këtu ka vend për rishikim të ekzekutivit ose, së paku ky raport të paraqitet. Unë se kam pa asnjë vend ku ka ndodh, pse kanë ndodh këto të meta në realizimin e projektit. Realisht, nëse flasim për numra, qysh tha Samiu, ne shohim se nuk kemi realizim, atëherë duhet me dhanë përgjegjësin dikush ose, së paku ta adresojmë adresën e problemeve dhe bashkërisht ta zgjidhim. Unë nuk jam për kritika, as ta dënojmë dikë, po ta zgjidhim problemi që të mos

ndodh, sepse nëse e shohim këtë trend zhvillimi dhe të harxhimeve tona dhe të hyrave, atëherë në 2015-tën me siguri ka me na e pritë një më e keqe. Edhe një pyetje e kam, ndoshta një përgjigje për Shpendin edhe për drejtorët. Ne e dimë që për çdo fundvit, deri në tetor të çdo fund viti duhet t'i paraqesim taksat ose tarifatat për leje ndërtimi për vitin e ardhshëm, këtu nuk shkruan askund a është bërë kjo informatë apo nuk është bërë. Tjetra, procesi i legalizimit apo regjistrimi i pronave pa leje, që përfundon në fillim të vitit të ardhshëm, në nuk e kemi asnjë informatë se në cilën fazë ka ardhur, po ashtu vendimet e rrënimëve që kanë filluar në fillim, që kanë qenë bajagi të bujshme, nuk e dimë në cilën fazë kanë ardhur, një numër i madh i tyre është marr, por asnjë nuk ka ndodh. Kryetar, ta kam thënë edhe në fillim, në mbledhjen e marsit, unë jam kanë i gatshëm, dhe besoj që çdonjëri, për me dhënë kontributin e vet për mos me ardhur në këtë gjendje, bile kemi ardhur në këtë gjendje, shpresoj që do ta bësh një analizë edhe t'i dish problemet dhe t'i adresojmë, dhe besoj që çdonjëri prej neve është i gatshëm të ndihmojë, që vitin e ardhshëm mos me ndodh kjo. Është fatkeqësi që shumë projekte kanë me na ikur, mirëpo shpresoj në vitin e ardhshëm.

Kryesuesi: Urdhëro, Kryetar!

Shpend Ahmeti: Faleminderit!

Besoj se Muhameti mundet me i ngrit krejt këto çështje, ky është raport buxhetor. Nëse donë me të tregu sa ka rrënimë, e qesim në rend dite dhe e bimë Xhelalin dhe na kallëzon sa janë rrënimë, nëse donë me ditë sa janë inspektime, të kallëzojmë sa janë inspektime, në qoftë se doni mi ditë lajmet tjera, t'i kallëzojmë, por ky nuk është raport i rrënimëve të ndërtimeve pa leje.

Po jo, tash a e bon pyetje, në qitë pikë të rendit të ditës, apo jashtë rendit të ditës. Okej, se me habite, thash çka u bë, po de, ti po i qel edhe temat tjera kur donë mi qitë si pika te rendit të ditës, përgjigjem edhe në ato, hiç mos u mërzit. Prosesi i legalizimit është duke shkuar mirë, me ligj, deri me 5 shkurt duhet me i identifikuar krejt, vijmë raportojmë këtu, krejt informatat i ki, sa herë donë me ardhur, mundesh me ardhur me vetë secilin drejtor, por tash me paraqit thujse na nuk po të përgjigjem, e nuk jena duke t'i kallëzuar tash informatat, është pak e padrejtë, Muhamet. Po, jo, se e paraqitet qashtu, kishe po ves e s'po kallëzoni, e krejt ke me i marrë informatat, veç mos na paraqit që s'po kallëzojmë e s'u bë. Nuk desha me iu përgjigj Samiut, por unë thash pe marrë një pjesë të përgjegjësisë, po kur ja nisi me fol, po na e qel gojën edhe neve. Secilën listë po e marrim dhe po iu him projekteve një ka një, projekte që i kemi trashëguar, sepse pas 14 vjetëve, mënyrës së bërjes së punëve, në një mënyrë, dhe për atë arsye i hup edhe zgjedhjet. Tash duhet me ndal atë mënyrë të funksionimit, duhet me ndal që po hymë në cilëndo tabelë me këqyrë, ndash po hymë te rruga "Peja" dhe rruga "Enver Maloku", nuk është më projekt qysh u kanë pjerrtësia, u kanë 7 %, e keni pru 12 %. Pse e keni ulur rrugën B, 2 metra më poshtë? Është dashtë me bërë projekt të ri, duhet me u përta me familjen Rrustemi, atje, se nuk e keni bërë pronësimin dhe shpronësimin, marrëveshjen e keni bërë me i dhënë leje 15 katë, me maru atje në pjesën ku është ballkoni, që vet ju atë plan rregullativ e keni kaluar. Duhet me ndërruar atëfarë pjese, rrugën që duhet me shtrua në katër korsi, qindra probleme i keni lënë, e keni qitë Due Perllëshin 800 mijë € shpronësimin, e nuk e keni bërë. S'mundemi me filluar rrugën atje, e dini ju shumë mirë atë farë pune. Lagjen "Arbëria" na e ka ndal gjyqi pse e keni maru

shkollën në pronë private, tash na ka qitë në gjyq, normal, gjykatësi, tash na nuk mundemi me i realizuar ato. Në qoftë se doni me i realizuar kundërligjshëm, e bëjmë, por nuk mundemi me bërë se na nuk punojmë kundërligjshëm, nuk kemi me punuar. Edhe qita duhet me e ditë, që shumicën e këtyre projekteve është dashtë me i ndalë, edhe tash, ndoshta sivjet na del një pjesë që nuk është shpenzuar, po ta keni parasysh edhe me bartje, i kemi bartur disa prej atyre projekteve në 2014, por definitivisht, nuk do t'i bartim në qoftë se e dimë që shkollën në Arbëri nuk mundemi me vazhdua, për shkak se na keni lanë më probleme pronësore. Tash, unë po them edhe një herë, po është punuar shpejt, vitin e kaluar i kanë grah kah muaji gusht, si ka lënë as me shkuar në pushim, me i vazhduar projektet shpejt. E dimë, edhe para zgjedhjeve çka u bë, u qelën gropat për bërllok, për kanta të bërllokut dhe tash thotë vazhdon projektin. Natyrisht, që nuk mundem me vazhduar në qatë mënyrë që u kanë, sepse as është e planifikuar, as nuk dina qysh kemi me e mbledh atë bërllok, as s'i ka Pastrimi kamionat me e mbledh atë bërllok, por natyrisht që nuk kemi me vazhduar në atë mënyrë. Për këtë arsyeje, po ju them se ky është vit i tranzicionit. Unë u mundova me shpjeguar, jo pse nuk këna dashtë në aspektin që po i ndalim tash projektet, po s'kemi pasur as mundësi me i vazhduar, edhe po e them, granti qeveritar, po e këqyrim me shpenzuar, mos me na mbet eurot aty hiç, në mënyrë që këto projekte, të cilat i kemi dhe i shohim se janë të mira, dëshirojmë na me i vazhduar, pa marrë parasysh se a janë të Lidhjes Demokratike, sepse unë e kam thënë edhe kur e kemi paraqitur buxhetin e viti 2015, që te Planit zhvillimor komunal i kemi marr parasysh të gjitha projektet. Por, nuk mundemi me punu në mënyrë që 17 projekte, që kanë qenë atje pa projekt hiç, që kanë pas me u tenderuar, nuk vazhdojmë ashtu, nuk mundemi me vazhduar ashtu. Hajde tash ta krahasojmë shfrytëzimin e hapësirës publike deri në muajin e 9-të të viti të kaluar- 2013, 620 mijë €, sivjet 624 mijë €, më shumë se vitin e kaluar. Vjet ka qenë 8 € tarifa, sivjet është 6 € tarifa, prapë kemi mbledhur më shumë, pse i kanë shti në planifikim 1 milion e 400 mijë €, është tjetër muhabet. Por, veç me % nuk mundesh me këqyrë se kemi mbledh më shumë se që është mbledhur vitin e kaluar, e hala nuk i kemi mbledhur me Samiun rreth 200 mijë € të AMM-së, që kanë me i paguar tarifatat për billdorda të cilët i shfrytëzon. Prandaj, po e them edhe një herë, edhe Yllit, nuk është puna te ndërrimi i prokurimit, sepse prokurimi, në fund të fundit, vepron sipas direktivave tona, d.m.th. unë i them vazhdo me një projekt, apo mos e vazhdo me një projekt, po edhe ata tash janë shumë ma shumë të shqetësuar, se nuk po guxojnë plotë do sene me i shkruar qashtu kuturu qysh i kanë shkruar përpara, me i mbyll me letra dhe me thanë në rregull është kjo. Po, nuk është qëllimi me ndërruar dikë të prokurimit dhe me thënë tash kam bërë mirë se tash e kemi ndërruar një shërbyes civil të prokurimit, i kemi ndërruar veç ata që e kanë shkelur ligjin, nuk jena hi në atë farë muhabeti, që ky i takon kësaj partie, apo i takon asaj partie, edhe na do të bëjmë ndërrime jo kushdo me punua në këtë Komunë, ka me punuar, e ka përkrahjen time si Kryetar, edhe të ekzekutivit; kush nuk do me punua, kush donë me sabotua apo me shkel ligjin, më më rendësi, natyrisht se nuk mundet me punuar në këtë Komunë, pa marrë parasysh cilës parit i takon, edhe i takoftë LVV-së, kemi me heq, d.m.th kemi me kërkuar përgjegjësi prej tyre. Po e them, e thash edhe ma herët, që qëllimi kryesor është që mos me na mbetur të pa shpenzuara këto grante qeveritare. Po, e përmendi listën, po i them Muhametit, kur të duash shkojmë në prokurim dhe i këqyrim projekt pas projekti, se di që je i brengosur, ma ke ngritur këtë brengë edhe kur jemi takuar, më ke thënë këto janë problemet, pe shoh që nuk e keni filluar disa me

prokurim, po qysh thash, po i hyjmë tabelës, një nga një, po e këqyrim ku është problemi. Disa prej tyre, natyrisht, e barti përgjegjësinë, po tash mos të doket që jo i metën qysh po thotë Samia, besoj që nuk kanë me mbet, shansa nuk ka me mbet 7 milion €. Unë i kamë thënë dhe këtu le të jetë, krejt Kuvendi komunal, kamë thanë ky është viti i parë tranzitor, në fund të mandati e flasim se sa realizohet buxheti në Komunës së Prishtinës, qysh realizohet dhe sa është efekti i zhvillimit ekonomik nga realizimi i investimeve dhe projekteve tona të cilat i kemi paraqitur.

Tash, natyrisht që 100% nuk mundem me zbatuar buxhetin, të cilin e kemi kaluar në vitin 2013, sepse nuk kemi fituar mandat në atë buxhet. Ai është buxhet i Komunës së Prishtinës, do të mundohem me realizua maksimum atë çka na e lejon ligji dhe atë çka e mendojmë ne çka është e mirë për Prishtinën. Por, ligjin nuk do ta shkeli as një herë, edhe me kusht të një suficit të vogël, të cilinën e durojmë sivjet, në mënyrë që gjërat mbar e mirë të behën në Komunën tonë.

Kryesuesi: Urdhëro, z.Hamiti!

Sami Hamiti: Faleminderit kryesues!

Unë u mundova në fillim me relaksuar situatën. E thash që nuk do të nxehet dhe që shifrat janë kokëforta dhe flasin vet, edhe po e përsëris, shifrat janë kokëforta dhe flasin vet. Çështjet e projekteve të cilat tash i përmendëm z. Kryetar, është e vërtetë që nuk ndodhën vetëm këtë vit me pas probleme, prandaj keni ardhur me bërë zgjidhje, jo me bërë propagandë edhe me ia nisur me u mësuar prej fillimit. Tregoni, thuani kemi ardhur, s'kemi mundur me u ambientuar ende, kemi lyp kohën, po na duhet kohë, ose nuk i njohim këto sene, po presim me u mësuar, me i mësuar edhe tash kur të vjen qe qita. Unë thash ma mirë të kish ra mi mësua edhe t'bjen shumë ma mirë, unë po them, për shnetën tënde, ma mirë është shumë me mësua. Jo, jo, sugjerim thash, nuk është justifikim të thuhet, ndodhin, ka probleme edhe probleme pronësore edhe pjesë tjera. Kur ka filluar ndërtimi i shkollës, atje problem pronësor nuk ka pasur, këtë duhet me ditë, edhe pjesën tjetër duhet me ju dhanë zgjidhje krejt elementi, Kryetar, i ekzekutivit edhe i yti, është që të bëni zgjidhje. Unë e kuptoj që nuk mundeni me bërë 100%, por jemi kush jemi në atë punë, por ka pas mundësi edhe të rishikimit edhe të pjesës së mjeteve të cilat kanë qenë të granteve edhe më herët, të thuhet se këto nuk mbesin, e jo të na mbesin në fund.

Faleminderit!

Kryesuesi: Urdhëro, z. Hoxha!

Ylli Hoxha: Kam krejt mirëkuptim, e di procesin e shpenzimit të parasë. Telashet që i keni, që i keni trashëgimin, që e ka lënë Samiu, ajo ku dhe mendoj që duhet të këtë dikush reputacion pse është aktivist i Lidhjes Demokratike, në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar ata njerëz që ta kryejnë detyrën e vet, por deri në shkallën kur ai person nuk bon sabotim të projekteve. Nëse tre-katër drejtorë kanë telashe me Zyrën e prokurimit, me procedim të shpejtë të proceseve duhet ta shikoni se a është objektiv kjo farë vërejtje. Nëse është objektive, ju lutëm, merrni masa, nëse nuk është objektive, thuaj, të lutëm Yll, e ke gabim dhe

të vazhdojmë me tutje. Mirëpo nëse ka në këtë strukturë, unë e di që ka njerëz që ta sabotojnë projektin, të lutëm, bëhu më rigoroz dhe qeli vetes rrugë.

Kryesuesi: Urdhëroni, z. Shala!

Flamur Shala: Faleminderit shumë.

Nëse dikush sot i thotë këtij raportit se është në nivel të duhur, në kuptimin e përmbajtëse së tij, ai ia banë qefin vetës, ia bënë qefin Kryetari të Komunës, e më e keqja është nëse Kryetari i Komunës ia bënë qefin vetës, se ky raport është në rregull. Ja pse. Ky raport tremujor, përkatësisht nëntëmujor financiar i Komunës së Prishtinës, me të dhëna dhe shifra i paraqitur para nesh, kështu tregon për një gjendje të rëndë financiare dhe ekonomike të Kryeqytetit. Realizimi prej 22% të projekteve kapitale, shënon përqindje më të ulët të realizimit. Në gjashtë vitet, përkatësisht, ndoshta dhe dhjetë vitet e kaluara, gjithsesi kjo është brengosje, këtë po e dinë të gjithë. Kjo gjendje shënon një reflektim negativ të shumanshëm, këtë e shohim në disa relacione. E para, realizimi i investimeve kapitale me këtë përqindje, sikur na bënë me dije se Komuna e ka humbur lidhjen e saj me qytetarin, e sidomos me kërkesat e drejtpërdrejta të qytetarit drejtuar Komunës, të cilat janë të shprehura me projekte, e projektet janë të realizuara me 22 %. E dyta, kjo gjendje është krijuar nga shkaku se kryeqyteti, thash, ka 10 muaj një qeverisje jo stabile, mund të them edhe jo demokratike, me koncepte dhe qasje të gabuara ndaj zhvillimit të kryeqytetit. Kjo qasje krejt tjetër nga ajo që i duhet kryeqytetit dhe qytetarëve të tij, është e gabuar, këtë gjendje po e tregon edhe ky raport me shifra dhe me fakte.

E treta, nëse vazhdohet kështu, me këtë koncept qeverisës në raport me realizimin e buxhetit qoftë me të hyra, qoftë me shpenzime, krahasoni atë shifër që u përmend se mund të mbetën deri në 6 - 7 milionë €, nga granti i përgjithshëm. Kështu pra, ka rrezik të madh të keqësimit të gjendjes, do të rrezikohet stabiliteti financiar i kryeqytetit si pasojë e qeverisje me koncept të gabuar ndaj zhvillimit të kryeqytetit . Në fund, dua ta them edhe këtë. Si çdo qeverisje, edhe kjo aktualja, me ambicie, normalisht, ambicia e cila u shpreh e u tha edhe në mbledhjen e kaluar për buxhetin 2015, se do të jetë buxhet agresiv, çka mund të themi ne sot për këtë buxhet të realizuar për nëntë muaj! Mund të themi se në vend të atij buxhetit të vitit të ardhshëm, do të duhej të ishte ky realizim agresiv, sepse buxheti i viti 2014, buxhet i planifikuar mirë, buxhet i cili ka pasur edhe bartje, buxhet i cili është rishikuar sipas dëshirës, sipas mundësive, sipas konceptit të Kryetarit dhe administratës së tij. Pra, të gjitha këto elemente i ka përmbushur, ne do të dëshironim që të ishte vërtet me një realizim agresiv. Mund të themi edhe një herë, me keqardhje, se kjo qeverisje sikur me të vërtetë, nuk do të thosha po tallet, por e ka humbur lidhjen me qytetarin.

Kryesuesi: Urdhëroni, z. Gashi!

Agim Gashi: Faleminderit, Kryesues!

Sa për ilustrim, do t'i ngre dy-tri çështje, që mendoj që do të shërbejnë si shembull konkret për të demonstruar disa konstatime. Këtu, në pasqyra, del katër drejtori as një cent nuk e kanë shpenzuar për nëntë muaj, shikoni te shpenzimet, aty, Drejtoria e Urbanizmit, e

Kadastrit, e Kulturës dhe Sportit dhe e Ekonomisë dhe Zhvillimit Rural, është zero. Nuk e di si mund të justifikohet ndryshe, përpos të themi s'po mund ta gjej një shprehje pak më relative them, mos ta quajmë dështim, por mos shpenzimi i mjeteve në gjendjen zero për nëntë muaj, kjo flet vetë. Çështja tjetër, mund t'i marrim disa shembuj për me pa se njeriu nuk mund të jetë aq shumë i pabesë, apo mos t'i besojmë as vetës, sepse e marrim çështjen e mbjelljeve të fidanëve. Kanë qenë të kontraktuara nga viti i kaluar, për shkak të motit nuk është përfunduar projekti në vjeshtë dhe ka qenë dashtë të vazhdojë në pranverë, nuk është mbjell asnjë, po e njëjta sasi mbillet në vjeshtë. Ndërsa buxheti i këtij viti ende nuk është shpenzua, p.sh. dhe aty nuk është dashtë njëfarë projekti famoz, ose të kontejnerët nëntokësor, që e përmendi Kryetari, është projekt që është i gatshëm, i përpunuar mirë, i planifikuar mirë, i projektuar mirë, as një centë në këtë fushë nuk është shpenzuar dhe kontejnerët nuk funksionojnë vetë. Është paketë e projektit, ku krahas saj duhet të blihen edhe makineria, për të cilën është thënë se nuk do të blihen kamionët që kushtojnë 200 mijë ose 150 mijë €. Nuk mund të paragjykojmë në zhvillimin e qytetit, vërejtje shumë serioze, ka dhe raste të tjera këtu, e shoh në pasqyrë "renovimi i sistemit të nxehjeve", në kohë kur jena hy në sezon dimëror, këtu është procedurë tenderimi. Ju lutem, ku është plani i prokurimit dhe a është hartuar ai plan i prokurimit në bashkëpunim me drejtorinë, sipas nevojave dhe specifikave të projekteve. Në qoftë se ai është hartuar, është dashtë me u përfillur ato, dihet cilat projekte dhe sipas cilit prioritet shpallen për ta zënë afatin kohor të duhur, e mos të lëshohemi edhe në projekte e tjera, të cilat vetvetiu e kanë prodhuar vonesën, e kanë prodhuara mos mundësinë mos me u realizuar brenda vitit buxhetor, edhe problemet tjera teknike ose problemet tjera të natyrave të ndryshme qoftë projektuese, qoftë edhe tjera, se dhe tash nuk mund të kemi shumë komoditete që të thirremi se nuk kanë ekzistuar projektet. Projektet hartohen, shpallen, jepen detyrat projektuese, hartohen, punohen dhe shpallen dhe realizohen pastaj. Asnjë fjalë nuk u tha për këtë gjë, nuk ka shumë komoditet, viti kalendarik ka 12 muaj dhe kur të planifikohet mirë, del kohë edhe me dërgua detyrat projektuese, edhe me i projektuar, edhe me i zhvilluar procedurat deri në realizim të projektit. Faleminderit!

Kryesuesi: Urdhëroni, z. Durmishi!

Hysen Durmishi: Faleminderit, kryesues!

Ju përshëndes të gjithëve!

Duhet ta marr fjalën për disa sqarime, të cilat besoj se i ndihmojnë edhe debatit këtu, sepse u thanë shumë gjera këtu. Duhet ta keni një gjë të qartë, se mua më shqetëson fakti kur i dëgjoj këta asamblastët e LDK-së këtu, tu majtë ligjërata për punën e shpenzimeve edhe për mënyrën se si me realizua buxhetin. Kur kemi filluar qeverisjen, kur kam shkuar në zyre e Drejtorisë së Infrastrukturës, unë e kamë gjete drejtorin me një buxhet prej 11 milionë €, pa zero planifikim, asnjë planifikim më 27 dhjetor, dhe kjo është shqetësuese, dhe duhet ta keni parasysh se si keni qeverisur ju. Flamur, a bën kur flas unë, ti me dëgjuar një herë, mandej merre fjalën dhe fol çka të dush. 11 milion €, i keni paraqitur në buxhet pa as një planifikim dhe ju e dini, ekonomistët e dinë, se duhet me paraqitur një planë për prokurim, që u përmend prej z. Gashi, dhe çfarë plani për prokurim me paraqitur Drejtoria e Infrastrukturës, kur nuk e ka asnjë projekt. Dhe, duhet me bërë një plan vetëm formal dhe

me u mundu mandej me ju përshtatur atij plani gjatë vitit. Është dashtë me i fillua procedurat e projektimit të cilat zgjasin në prokurim, e dini se si shkon kjo punë, me kontraktuar kompaninë projektuese, e cila fillon projektimin dhe sot jem në tremujorin e fundit, kur ne kemi ardhur në situatën që e kemi krijuar, një gjendje ku i kemi 50 projekte për vitin 2015. Dhe, në vitin 2015, Drejtoria e Infrastrukturës e ka planin detal për secilin cent me 50 projekte, me emra konkretë të secilës rrugë, secilit kanalizim dhe do të investohen me projekt secili, mirëpo është dashtë me kalua 10 muaj për me mbërri në këtë gjendje, për shkak se ju ma keni lënë këtë gjendje në Drejtori. Dhe, natyrisht, nuk ka pasur mundësi me shpallur tender më herët, sepse nuk ka pasur projekte. Ato të cilat kanë qenë, i kemi shpallur dhe duhet ta kuptoni një gjë, se ka ndryshuar qeveria në Komunë të Prishtinës, disa projekte të cilat ju i keni paraparë, në buxhet ne nuk i bëjmë, nuk do t'i bëjmë, sepse nuk duam të bëjmë disa projekte të cilat i vlerësojmë që nuk janë në interes të qytetarëve të komunës së Prishtinës. Dhe, nuk ka pasur rishikim, është miratuar rishikimi këtu, në Asamblenë komunale, s'ka institucione qendrore, dhe kjo i shkakton pasojat e veta. Pra, përveç që ka qenë viti i tranzicionit, kur ndryshon një qeverisje që paraqitën probleme të mëdha, është edhe një viti tjetër i cili nuk ka institucione qendrore, dhe kjo shkakton me njëherë pasoja të drejtpërdrejta në secilën komunë, edhe në realizimin e buxhetit. Për vitin 2015, unë ju garantoj këtu, publikisht, që në Drejtorin e Infrastrukturës edhe buxheti i bartur që do të jetë, edhe buxheti i cili është i paraparë për vitin 2015, nuk do të jetë asnjë cent suficit, sepse i kam të planifikuara, ama tash e kam trashëguar një gjendje të mjerueshme, të cilën e keni lanë ju, që sot po flisni me kaq shumë komoditete këtu para asamblistëve.

Kyesuesi: Urdhëroni, z. Ahmeti!

Kreshnik Ahmeti: Fillimisht, kisha kërkuar prej juve si kryesues, që për asamblistët e caktuar, të cilët tashmë bënë ofendime dhe po e pengojnë mbarëvajtjen e seancës, së paku të bëhet vërejtje. Shpresoj se përkatësia partiake nuk ka me ndikuar me shkel rregulloren. Këtë diskutim të cilin e dëgjuam deri tash, ma shumë se sa vlerësim të performancës së Komunës, e shoh si një lloj ndeshje të dy llojeve të ideve dhe kisha dashtë me elaboru këtë pak nëpërmjet rastit të punës së Urbanizmit. Fakti që janë ulur të hyrat nga taksat për leje në Urbanizëm, nuk tregon asgjë tjetër, veç se është vendosur ligji, por problemet po shihen në perspektiva të ndryshme dhe jo të gjitha perspektivat janë të vërteta në këtë rast. E kuptoj, pas luftës në Kosovë janë vendosur raporte klienteriste edhe në gjithë sistemin e vendit tonë, duke e përfshirë edhe Komunën, edhe kjo ka bërë që subjekte të shumët të vendit tonë, çdo send me pa si mall, edhe këtë e kanë pa si mall, se vetëm në atë mënyrë kanë arritur me përvetësuar atë që iu ka takuar të gjithëve, edhe rastin në Urbanizëm, hapësirën publike. Kështu që në rastin tonë kur kemi vendos rregull në Urbanizëm, ama ata nuk shohin që kemi vendos rregull, shohin ulje të shitjes dhe të të hyrave, sepse për këtë rregull kanë qenë të interesuar, për rregullin e financave private e jo rregullin e përgjithshëm. Në anën tjetër, kemi edhe problemin e tregut. Në mandatin e kaluar tregu e ka udhëhequr Komunën, Komuna nuk ka ndikuar as pak në treg dhe kjo ka bërë që industria e ndërtimit me pasur një ofertë shumë të madhe, që e ka tejkalar mundësinë e kërkesës. Edhe në një vend ku kapitalin e kemi konceptuar një numër të vogël të njerëzve me fuqi të madhe, edhe nuk kemi rishpërndarje të pasurisë së përgjithshme, sigurisht se kjo industri e ndërtimit ka për të hyrë

në një krizë, krizë e cila tashmë është duke ndodh. E në këtë situatë tash ne i kemi me mijëra familje pa strehë, në anën tjetër, kemi shumë banesa e shtëpi të cilat nuk është në gjendje kurrkush me i blerë e janë të zbrazëta. Ky është një problem i politikave, të cilat janë udhëhequr deri tash. Pra, edhe pse diskutimin sot e bëjmë nga prizmi i financave, punë e Drejtorisë së Urbanizmit, duhet me pa në terren. Aty ku është vendos rregulli, aty ku nuk i lejohet më ndërtimi i objekteve me leje në mesë të rrugës, sepse në fund të fundit, Komuna nuk përbën vetëm shifra, përbën komunitete, të cilat operojnë në hapësirën e Komunës, dhe këto hapësira tash po mbrohen dhe po kultivohen prej ekzekutivit aktual.

Kryesuesi: Urdhëroni, z. Gashi!

Bekim Gashi: Faleminderit, kryesues!

Unë desha me u lidh me raportin nëntëmujor, ose tremujor, si po quhet në raport, nuk po e shoh që është përfshirë Zyra e prokurimit. Ne si këshilltarë të Asamblesë komunale, nuk e dimë në këtë periudhë nëntëmujore sa aktivitete të prokurimit janë zhvilluar, sa janë në procedurë, sa prej tyre janë anuluar, sa prej tyre kanë shkuar në ri tenderim, sa prej tyre kanë shkuar OSHP, sa operatorë ekonomikë, pasi që lënda ka shkuar OSHP, e kanë fituar, d.m.th. lëndën operatori ekonomik ndaj autoritetit kontraktues, edhe në ato raste a kemi pasur rast kur operatorët ekonomikë e kanë fituar lëndën në OSHP. Nëse kemi pasur raste të tilla, atëherë është dashtë të merren masa ndaj Komisionit vlerësues që kanë qenë në Zyrën e prokurimit edhe prej autoriteti kontaktues që kanë mundur me qenë edhe prej drejtorive të tjera. Një raport i tillë d.m.th. kish me plotësuar raportin tremujor buxhetor të Komunës së Prishtinës, andaj, Kryetar, ju kisha lutë që në raportin vjetor, të keni raport edhe prej Zyrës së prokurimit, se është një prej zyrave më të ndjeshme. E kemi edhe prej Komisionit Evropianë dhe Procesit të Progresit që është dhënë një vërejtje më së shumti në prokurim, andaj të jemi transparent dhe të dimë sa aktivitete janë zhvillua dhe të bëhet një krahasim sa aktivitete të prokurimit janë zhvilluar në këtë viti dhe vitin e kaluar, sa prej tyre kanë shkua në OSHP.

Kryesuesi: Urdhëro, z. Gashi!

Shefki Gashi: E pata çështjen te këshilltarët. Unë kisha pasur dëshirë dhe jam munduar, por jam keqkuptuar, okej, është në rregull krejt, jam mundua me luajt rolin tim si asamblist, si këshilltar komunal. Ti, drejtor i Infrastrukturës, ne nuk jemi staf ekzekutiv, ne nuk bëjmë planifikime, ne nuk bëjmë parashikime, nuk bëjmë projekte e ku ta di unë, ne e bëjmë politikën e Komunës, ne e ngrisim zërin e votuesve tanë, të cilëve ju kemi premtuar diçka në mënyrë ligjore, që nuk përfilleni hiq, jemi drejtpërdrejt këshilltar komunalë të Kryetarit të Komunës dhe të ekzekutivit. Këshillat nuk do të thotë që jepen vetëm nëpërmjet udhëzimeve që nuk i pranoni, pranoni bile kritikata. Prandaj, ne jemi të obliguar me krye detyrën tonë. Deri sot, unë ju kamë këqyrë pak si kundërshtar, sot po më dhimbeni, shifrat po thonë që po dhimbeni. Përvoja jem e cila për 5 vjet, me Ismet Beqirin dhe Sami Hamitin, 640 rrugë i kemi trajtuar, që nuk ka qenë buxheti për 5 vjet, sa një vjet i juaji dhe i Isa Mustafës. Edhe tash i ki 90%, i ki të shtruar rrugët. Kur e kemi trashëguara veç me dy katunde asfalt, katunde shqiptare, vetëm u kanë Mramori edhe Rimanishta asfalt, asnjë

katund tjetër. Prandaj, sot i ki 90% të kryera, i ke gjet hazër, asnjë projekt se ke vazhdua kurrkund, kanë mbet me i qitë edhe 5 m², edhe ato si ke qitë. Ky tha se nuk po shiten banesat sikur në Gjakovë, që e kanë pru punën me ik Gjakovarët dhe mi lanë shtëpitë me 30 mijë €, qashtu në Prishtinë keni me pru punën ju, se ata tash s'kanë ku shkojnë, në Gjakovë s'kanë ku shkojnë, në Pejë s'kanë ku shkojnë, kanë me ik jashtë dhe nuk ka me t'u shitë asnjë banesë, kanë me ik se nuk e duan qeverisjen komuniste, e ty z. Shpend, të kisha sugjerua, edhe e kam obligim prej votës teme me thanë që ti me paranojat e humbësve të brigadave të kuqe me atë yllin, mos i klasifiko njerëzit, mos i qit prej pune. Sabotimi ka lindur në vitin 1945, për me i pushkatuar intelektualët, prandaj çfarë sabotimi të bën punëtori që merr 200 €, çfarë sabotimi bën! Nuk kamë çka, se po më dhimbeni çfarë raporti është, se unë i kam interesat e mia se i kam 20 mijë banorë.

Kryesuesi: Urdhëro, z. Veseli!

Shemsi Veseli: I nderuari Kryetar,

Qeveri lokale,

Të nderuar kolegë,

Kolegu ime paraparak, gjegjësisht edhe shefi i Grupit Parlamentar, foli në emër të grupit tonë. Mirëpo mua më shqetësoi pak edhe diskutimi që filloi d.m.th. klima që u krijuar nuk na përket neve, e kuptoj, d.m.th., thjesht, se nga një herë jemi njerëz dhe kemi edhe situata kur sistemi nervor qendror, për shkak të lodhjes dhe pikave të shumta që kemi, mundet me dal jashtë kontrollit tonë dhe me kaluar pak edhe në gjendje më emocionale, mirëpo unë mendoj që kritikën nganjëherë, kur janë të shëndosha dhe nuk janë në pozicion e kritizërëve me radhë. Mendoj se edhe kolegët nga Vetëvendosje edhe Kryetari, duhet t'i marrin me një zemër gjerësi më të madhe, për arsyeje se kjo vetëm ja hap rrugën që të përparojë përpara dhe nuk do të thotë që vitin e ardhshëm ose tre mujorin e fundit që do të jenë që nuk do evoluoi ky raport. Por, ne jemi duke folur, duke diskutuar gjendjen faktike të situatës tash, që të kthemi në mënyrë retrospektive, mendoj që humbim kohë. Megjithatë, unë do të mundohem në këtë frymë t'i them disa gjëra, pa u munduar fare as të lëndoj as Kryetarin, as qeverinë, për gjërat që janë konkrete. Meqë jemi duke folur për raportin nëntëmujor, atëherë t'i themi gjërat troç, qysh janë, nuk duhet me na mbet hatri asnjërit. Unë mendoj që nuk po them kurrgjë të re, e di që edhe Kryetari, Shpendit, edhe të gjithë e dinë se paratë publike nuk janë as të Shpendit, nuk janë thjesht as të drejtorëve, por janë para publike të qytetarëve, dhe në këtë aspekt kemi të drejtë të diskutojmë drejt një menaxhimi me të mirë të mundshëm dhe harxhimit për interesin e tyre. Prandaj, unë mendoj që edhe në anën tjetër, menaxhimi i parasë publike nënkupton edhe dhënien llogari, d.m.th. për arsyeje se edhe mjete nëse nuk shpenzohen në kohën e duhur me ligjin e menaxhimit të financave publike, parashihen edhe konsekuenca, mirëpo sido-kudo, më lejoni që të hi në detaje. Sa i përket gjendjes buxhetore nga raporti i të hyrave, shpenzimeve totale dhe treguesve financiarë, rezulton se periudha 9-mujore e viti 2014 qëndron në gjitha aspektet gati më keq sesa periudha e 9-muajve të vitit 2013. Kjo është faktike dhe nuk duhet me na mbetur hatri absolutisht. Në qoftë se në raport me planin apo me realizimin e tij, në krahasim me vitin 2013, më lejoni që të hyrat vetanake në total janë planifikuar 24 milionë e

318 mijë e 250, unë do të flas me shifra konkret, prandaj nëse ka dikush me më demantuar, le të më demantojë me shifra, jo me fjalë konfuze, sensacionale, ndërsa janë të realizuara vetëm 14 milionë e 125 mijë e 738 €, d.m.th. që është totali 58.08% të planit d.m.th. buxhetor, apo për 10 milionë e 192 mijë e 511 € janë ma pak sesa plani, po flas gjithmonë duke u krahasuar me nëntëmujorin e vitit 2013. Në strukturë të të hyrave më së keqi qëndron pozicioni i të hyrave nga lejet e ndërtimit, pavarësisht faktit që e kuptova që ka ndërtime apo s'ka ndërtime, kjo nuk na jep me u arsyetuar në mënyrë të gjithanshme se nuk kemi mundur me inkasuar më shumë. Nuk besoj që gjithë ata operatorë që janë për leje ndërtimi, janë ata që faktikisht kanë shkelje në procedura, por unë mendoj që edhe kjo është që Drejtorisë ndoshta iu ka dashtë pak a shumë t'i gjenden defektet edhe mandej unë besoj që do të jenë më ekspeditiv sa i përket viti 2015. Sa i përket realizimit për nëntë muaj të viti 2014, krahasim me periudhën e njëjtë nëntëmujore të viti 2013, është ma i ultë për 1 milionë e 577 mijë e 372 €, d.m.th. që në vitin 2013 janë inkasuar 15 milionë e 703 mijë e 111 €, ndërsa në këtë vitin 2014 janë inkasuar vetëm 14 milionë e 125 mijë e 738 €. Nëse hyjmë te planifikimet dhe shpenzimi i buxhetit, duke shikuar nga planifikimet dhe shpenzimet e buxhetit për nëntë muaj të vitit 2014 në raport me planin dhe strukturën e tij, si dhe në raport me realizimin e nëntë muajve të kaluar 2013, qëndron më keq në të gjitha programet, përpos pagave dhe mëditjeve, që konsideroj se është shpenzim më i madh për shkak të kalkulimit të vendimit të qeverisë. Të nderuar, me lejoni që ta konkretizoj këtë konstatim timin. Pra, nëse i bëhet një analizë e thjeshtë planifikimit dhe shpenzimit të buxhetit, mund të vërejmë se shpenzimi i buxhetit, programi "mallra dhe shpenzime" në krahasim me vitin 2013, që ka qenë 59.56%, në periudhën e njëjtë të këtij vitit është 44.56%, që d.m.th. ka rënie prej 15%, dhe përkundër fakti që është bërë bartja e mjeteve vetanake nga viti i kaluar. Në programin "subvencione dhe transferë" në të njëjtën periudhë kohore të viti 2013, ishte 75.35%, ndërsa në këtë vit është 40.35%, që do të thotë se ka rënie prej 35%. Në programin "shpenzime komunale", në krahasim me periudhën e njëjtë kohore të viti 2013, ka rënie prej 0.68%, ndërsa sa i përket programit "investime kapitale" për periudhën kohore të vitit 2013, janë shpenzuar 21 milionë e 553 mijë e 0.28 €, ose 41.61% buxheti i planifikuar për investime kapitale, ndërsa në periudhën e njëjtë e këtij viti janë shpenzuar 9 milionë e 117 mijë e 0.41 €, ose 22.02% e buxhetit të planifikuar për investime kapitale, që do të thotë se ka rënie për 12 milionë e 435 e 987 €, apo 19.59% në krahasim me periudhën e viti të kaluar 2013.

Pra, shpenzimi i përqindjes kaq i ulët i buxhetit komunal për investime kapitale në periudhën kohore për 22.02%, pasqyron një situatë shqetësues për gjithë ne, në veçanti për ty z. Kryetar dhe drejtorë të qeverisë komunale, me që sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike, në fundin e çerekut të tretë parashihet 60% i buxhetit të jetë i harxhuar. Jemi duke fol për tremujorin e fundit, kur nuk është harxhuar faktikisht as 50%. Prandaj, kjo është shqetësim edhe për mu, se edhe ne jemi pjesë e kësaj politike, nga ky realitete i hidhur, realizimi shumë i ulët i investimeve kapitale mund të konkludohet Kryetar, pa fyerje, e kam me qëllimin ma të mirë, mund të konkludohet dhe ekipit qeverisës nuk i kanë kushtuar rëndësi të jetë e madh aspektit të realizimit të buxhetit, sidomos koordinimit. Këtu po diskutohet, nganjëherë është e pajustificueshme kordinimi në mesë të Zyrës së prokurimit, mekanizmit që mbikëqyrë realizimin dhe dinamikën e projekteve, ka munguar dhe nuk ka funksionuar qysh duhet. Nuk është faji i juaj, është faji i drejtorive, por në këtë

rast e banë pjesën e përgjegjësishë ti, si menaxher kryesor në këtë drejtim, d.m.th. për arsye se duhet të jemi shumë koeshient se këto konstatime më sforcojnë edhe më shumë krahasimin me analizat e strukturës të buxhetit total. Unë e kam analizuar me 2013, se kam qenë pjesë e Kuvendit dhe më ka interesuar, sinqerisht po ju them, totali i strukturës buxhetore prej 84 milionë e 698 e 530 €, bartje nga viti paraprak për 2013, jemi t'u fol, ishin harxhuar 43 milionë e 42 mijë e 933 €, ose 50.82%, janë harxhuar d.m.th. se nëse flasim tash në periudhën e njëjtë vit, janë 78 milionë e 55 mijë e 354 € të harxhuara, tash janë harxhuar vetëm 34 milionë e 682 mijë, çka do të thotë se totalin me buxhetin 2014, kanë mbetur pa u shpenzuar 43 milionë e 373 mijë e 276 €, që është e pamundur të shpenzohen në tremujorin e fundit. Prandaj, është edhe shqetësuese në kuptim e asaj se është shumë e cila thjesht na obligon, sidomos Kryetarin dhe qeverinë, që të jetë shumë dinamik, duke pasur parasysh tremujorin e fundit. Në fund, veç një pyetje e kam, sqarim, nëse drejtori për çështjen e financave, po më intereson një sqarim në procedurat e tenderimit. Shumica e projekteve dhe disa prej tyre prezantohen në tabelë që janë të kontraktuara, por të pa shpenzuara në kuptimin e asaj, a janë në pyetje vonesat në lidhje me kontratat, apo janë tash vonesa nga njësia kërkuese për hartimin e procedurave, apo kërkon ndonjë sqarim tjetër, çfarë efekti kanë tani proceset e kontraktuara, se janë shumë me rendësi, po që ende nuk janë shpenzuar, d.m.th. që asnjë cent, kur dihet se nevojat e qytetarëve janë shumë të mëdha. Faleminderit!

Kryesuesi: Urdhëro, z. Pacolli!

Islam Pacolli: Faleminderit, kryesues!

Sigurisht, po me duket që nuk është dëgjuar mirë, unë kam folur shumë pak, por kamë thanë diçka shumë konkrete, të cilën kisha pas dëshirë që le të dëgjojmë mirë kur dikush fol, sado pak që të bisedojmë, nuk ka nevojë të them ku me ditë çka, një javë aty me fol, po në pika të shkurta, të përfshijmë gjithë. Unë kërkova më herët që për çdo projekt, të bëhet projekti ideor, realizues, me kalkulime të sakta, pastaj të qitet në prokurim dhe të shkojë me realizim. Po ju them shumë qartë. I kam 200 arsyeje që mundem me ua argumentuar, po dua me thënë për arsyeje që kjo qeveri ka filluar, po unë ende nuk e di që kanë realizuar projekte, po thamë për ata që kanë ndodh më herët. Asnjë projekt nuk ka qenë me projekt të mirëfilltë edhe pikërisht, pavarësisht që janë realizuar do të thotë projekte shumë, po ju them me plot përgjegjësi, thuajse asnjë nuk ka qenë i realizuar ashtu qysh i ka hije dhe gjithë herë kanë qen projekte me paralogari, asnjë projekt nuk është legjitim, nuk është ligjor të shpallet me paralogari. Duhet të bëhet projekti realizues me specifikim të saktë, me kosto të saktë, pastaj të futet në zbatim. Po ju thamë diçka, se çdo taksë që shfrytëzohet, kjo është e qytetarëve, nuk është e Kryetarit të Komunës, ja një drejtori të caktuar, por ne kem, unë vijë, personalisht banoj në fshatin Hajvali, që është paralagje e Prishtinës. Aty janë shtruar veç rruga kryesore, nuk e di sa herë janë shtruar trotualet, ju lutëm, bëre një vizitë e këqyrni cila është funksionale. Janë shtruara rrugica nëpër lloç, jo zotëri, mos e boni partiak, Komuna le të bëhet e qytetarit, le të bëhet projekti i saktë, pastaj realizimi. Tani ka filluar një projekt, prej sotit, në Hajvali, ku me qeverisjen e kaluar, unë me insistim, me këmbëngulje të vendostë, është fut që të bëhet projektimi, asnjë projekt tjetër jo, kështu që ju kërkoj që të bëhemi kooperativ, t'i ndihmojmë njeri-tjetrit, për të mirën e qytetarit,

mos t'i qesim interesat e tona para interesave të qytetarit, para interesave të përgjithshme. Një që kisha pas dëshirë ta kërkoj prej të gjithë drejtorëve, apo prej Kryetarit, dhe tani të na e sjellin neve një specifikim të projekteve, projektiveve, cilat projekte kanë filluar që për seancën, e tjetër ne t'i kemi, që për arsye të tjetër ne t'i kemi, ky raport nuk mjafton, po duhet të jetë i specifikuar, cila punë ka filluar, cila është në projektim, cila është fut që të realizohet, ajo dhe kostot e tyre, do të thonë nëse neve na intereson për një projekt të caktuar, mundemi me marr në adresën e caktuar, d.m.th. mos te sillemi sikur sheshi që është ndërtuar. Kryesues, kam të drejtë, mos të bëjmë sikurse sheshin që është shpall tenderi me granit 12cm dhe është kthye në beton, ai i cili është bërë në sheshin në qendër të Prishtinës, nuk është granit. Unë ju garantoj me këta, me plot përgjithësi, kështu që ju lutna edhe ju tjerët ta keni parasysh, mos e filloni në këtë formë se nuk shkon përpara, d.m.th. t'i bëjmë me përgjegjësi.

Faleminderit!

Kryesuesi: Urdhëro, znj. Dumoshi!

Vlora Dumoshi: Faleminderit!

Ne diskutuam për buxhetin dhe jemi mjaft të shqetësuar, ku e kemi një pasqyrë me këtë shpenzim, sidomos në investimet kapitale. Pyetja ime është, me iu drejtuar Kryetarit apo nënkryetarit, meqë është këtu. Pse në këtë raport nuk janë paraqitur edhe subvencionet, të cilat i jep Drejtoria e Kulturës, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Arsimit, dhe që ta kemi një pasqyrë më të qartë se sa kanë qen përfitues njerëzit që kanë ardhur me kërkesa jashtë Komunës së Prishtinës? Sa i përket Drejtorisë së Kulturës, Rinis dhe Sportit, unë jam mjaft e shqetësuar dhe e kam ngrit zërin vazhdimisht, përveç se kjo Drejtori para disa muajve, me rishikim të buxhetit është sakatuar, në njëfarë mënyre, me 836.000 €, që janë tërhequr dy projekte kapitale, të cilat kanë qenë me projekt, si për Sallën universale, ashtu edhe për Pishinën e mbyllur. Pyetja ime është: Pse nuk është sot drejtoresha, Blerta, këtu, kush e zëvendëson Blerta Zeqirin, a është në punë ende, a është staf ose drejtoreshë ose ushtruese e detyrës, Blerta Zeqiri, e cila asnjë herë nuk vjen në punë? Ajo ende paguhet prej Komunës së Prishtinës. Kush është Saranda Bogujevci, deri kur e ka kontratën, a i ka kaluar asaj kontrata? Unë po dua me e lus këtë qeverisje që sa më shpejt ta zgjedh drejtorin e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, sepse kjo po shkon, thjesht, po shihet mos suksesi i Drejtorisë.

Kryesuesi: Urdhëro, z. Gashi!

Ardian Gashi: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje të gjithëve !

Po flasim për buxhetin, se pati shumë kritika edhe prej ma të ndryshmeve, përveç buxhetit. Më herët mu tha që prej z. Gashi, i cili ka qene ish-drejtor në atë Drejtori, se nuk është menaxhuar si duhet, disa prej projekteve aty, edhe i ceku disa me radhë. Po dua me i treguar që sa i përket specifikisht projektit të gropave të mbeturinave nëntokësore, ai është projekt që ka dështuar në kompaninë që e keni zgjedh ju, edhe pse deri tani nuk jam kanë i prirë që mos me anuar nga e kaluara, apo mos me e përmend të kaluarën, po e shoh që

shumë shpesh po më nxit për me përmend. Do të thotë, ajo kompani tash mund të jetë që edhe ka bankrotuar që e keni zgjedhe ju zotëri Gashi. Tjetra është, i keni pasur të hyra në përqindje prej 57.54% inkasim në hapësira publike, në planifikim keni shtuar në buxhet 12 %, nuk e di me çfarë matematike keni shkuar në këtë buxhetim sa i përket planifikimit për 2014. Po flasim, këtë nuk e përmend hiq, se po shihet që është pak më shumë, edhe pse është zvogëluar çmimi prej 25 %, që nuk u përmend asnjëherë. Sa i përket hapësirave publike, edhe u inkasua më shume se ju çka keni bërë për vitin e kaluar. Nuk u përmend as impiant në Mramor, që është vazhdimësi që nuk është ndal, nuk u përmend as kolektori në Mramor, që është projekt i juaji. Sa i përket fidanëve, po më duket ose nuk keni jetuar ne Prishtinë, ose tentoni me harruar që çka ka ndodhur gjatë pranverës, a ka pasur ngrica, a ka pasur vërshime apo çka ka ndodh do te thotë etj. Më vjen keq që mu dashtë me u shprehur në kësi mënyre, por me nxitët, si me thënë, më tërhoqët për gjuhe.

Kryesuesi: Urdhëro, z. Gashi!

Agim Gashi: Me qenë fokusi me i apostrofuat Shërbimet Publike apo një drejtori tjetër, janë marr dy-tre shembuj, sa për orientim të bisedës, sepse ka projekte që nuk është dashtë të kemi projekt zbatuese të hartuara në mënyrë specifike dhe kanë mundur të procedohen ashtu siç janë dhe nuk janë proceduar, ky ka qenë synimi. A ka bankrotuar një kompani, ne nuk jem përgjegjës, ajo e ka fituar tenderin përmes Zyrës së prokurimit, përmes procesit të konkurrencës dhe se ai projekt ka qene në gjysmë kur është ndërrua. Unë s'po dua me bart fajin te ju, as me shfajësua atë pjesën tjetër, por mbikëqyrja është dashtë të jetë permanente dhe të mos lejojë të vazhdojnë punimet në qoftë se ai nuk i kryen punët si duhet. Është një proces që dhe ju kur të shkoni dhe vinë të tjerët, kushdo që jen ata, ka me ndodh kështu. Prandaj, te jemi pak real, edhe jo çdo diskutim që e bëjnë asamblistët këtu të merret qëllim keq. Unë ju kisha lutur të jeni pak të kujdesshëm edhe ju, edhe ne, në mënyre që të gjejmë një rrugë të mundshme bashkëpunimi, sepse kjo nuk ju qon as juve kurrkund as neve.

Kryesuesi: Urdhëro, z. Berisha!

Visar Berisha: Plotësisht pajtohem edhe shumë seriozisht i kemi marr këshillat e asamblistëve dhe, si rezultat i kësaj, kemi një raport që është raport tremujor, gjashtëmujor, nëntëmujor, që përpara është prezantuar në 2 ose 3 faqe, ndërsa tash ka mbërri një përmbajtje që i ka 10 - 12 faqe, dhe përveç atyre përmbajtjeve që është e paraparë me ligj, paraqiten edhe gjëra të tjera, të cilat ndoshta kërkohen e nuk është e thënë që të jenë në këtë raport. Përveç kësaj, edhe kërkesat tjera që janë sot, edhe në mbledhjet tjera, çka do që i keni, por nuk janë të paraqitura në raport, ju i kemi përmendur edhe herëve të tjera që, ju lutem, bëni kërkesat dhe drejtoritë janë të gatshme që të ju përgjigjen me të gjitha informatat e mundshme, si me planin, një raportim më të detajuar nga prokurimi, që nuk duhet të jetë në këtë raport, por që mund ta bëjë njësia e prokurimit, ashtu edhe të tjerat. Ajo çka është kërkuar si plan i investimeve, është paraqitur këtu, ndërsa sa i përket shumave, ju pyeta më herët në lidhje me këtë raport dhe këtë tabelë, d.m.th., në kolonën e fundi shuma e kontraktuar është paraqit shuma e mjeteve që janë kontraktuar për një vijë ose për dy-tri vija buxhetore së bashku. Ndërsa te kolonat e shpenzuara, janë paraqitur në

kuadër të shumës së kontraktua sa mjete janë shpenzuar deri në këtë periudhë, d.m.th. në këtë rast më 30 shtator. Sa i përket emërtimit, e kisha lutur edhe Zyrën ligjore, edhe Zyrën e Kuvendit, që kur të punon në planin e punës së Kuvendit për vitin e ardhshëm, që ta shqyrtojë më mirë këtë Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, që thotë se ky raport e ka emrin raport tremujor buxhetor, jo raport financiar, as jo raport për të hyrat, d.m.th. është në ligj. Këtu ka mbet me siguri se kur është bërë plani në fillim, është emërua ashtu edhe na reflektohet në rendin e ditës, po është çështje shumë minore dhe mund të përmirësohet. Edhe një gjë, që besoj duhet mu përmend, pasi që vij edhe nga Drejtoria që e ka edhe Sektorin e pronës, e që menaxhon edhe me pronat komunale. U përmenden këtu edhe prej disa asamblistëve projekte që janë shtruar ndoshta me qindra rrugë në të kaluarën. Ne sot po ballafaqohemi në Sektorin e pronës më një situatë, ku kemi jo me qindra, po me mija kërkesa të qytetarëve për kompensim të pronës private, ku janë ndërtuar rrugë nëpër prona private, pa i përfillur dhe pa i kryer procedurat e shpronësimit. Ajo për mu është kurrgjë tjetër, veç se uzurpim i pronës private, d.m.th. në vitet e ardhshme në do të kemi kërkesa me të cilat gjithsesi buxheti i Komunës do të ballafaqohet, vlerësimi është diku mbi 10-15 milionë €. Kjo është d.m.th. puna që është bërë në të kaluarën, edhe jo veç sot, sivjet, vitin e ardhshëm, vitet tjera, ne nuk do të kemi buxhet me i shpronësuar tash ato, me pagua kompensimin. Një pjesë e tyre do të vinë si aktgjykime të formës së prerë, një pjesë e tyre po shpresojmë që kemi mjete buxhetore me i paguar, por ju duhet me ditë situatën në të cilën jemi edhe në të cilën është ardhur Komuna e Prishtinës, me projektet që i ka kryer në infrastrukturë, kryesisht duke hyrë në pronat private, pa i pyetur njerëzit ose duke iu thënë që do të kompensohen pa kurrfarë plani për atë kompensim.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor!

Iu kisha lutur sekretarisë të bëjë numërimin e këshilltarëve komunalë prezent në sallë. Derisa ju t'i numëroni, urdhëro, nënkryetar!

Kryesuesi: Urdhëro, z. Sejdiu!

Dardan Sejdiu: Unë kisha dashur, me lejen prej juve, së pari, faleminderit që jeni sot këtu, që po e diskutojmë raportin tremujor buxhetor. E përmendi edhe drejtori i Financave, ky është emërtimi që i jepet në Ligjin për financimin e financave publike, pra dhe përgjegjësitë që derivojnë prej atij ligji, ashtu quhet "raport tremujor buxhetor". Rrjedhimisht, besoj që nuk kemi ndonjë telash për atë. U përmend disa herë, si me thënë, një farë përzirje në mesë raporti dhe përmbajtjes së raportit. Ne sot këtu jemi, e kemi një raport tremujor buxhetor për periudhën korrik-shtator 2014, i cili përmban të gjitha elementet e nevojshme që një këshilltar i Kuvendit komunal në kryeqytetin e Republikës së Kosovës të ketë një fotografi, pasqyrë të qartë për raport, si raport tremujor, pra korrik-shtator 2014. Dhe, ky raport vetëm atë e tregon, asgjë më shumë, për atë arsyeje edhe quhet raport, besoj që këtë nuk kemi nevojë me e trajtuar ndryshe. Desha edhe dy elemente me i përmend, të hyrat, sepse dikush i përmendi nivelin e të hyrave, të hyrat në secilin zë buxhetor janë më të mira, përveç në lejet e ndërtimit, pra në secilin zë buxhetor

janë më të mira dhe kur bëjmë krahasimin e të hyrave dhe shpenzimeve, është mirë me e kuptuar që këto janë pasojë e një planifikimi dhe jo domosdo planifikimi ka qenë i mirë. Pra, nëse kemi të hyra më të mira se që është planifikuar, apo më të dobëta se që është planifikuar, kjo nuk prezanton situatë e cila ka qenë e planifikuar i mirë e realizim i dobët. Mund të jetë edhe e kundërta, planifikim i dobët e realizim shumë i mirë, në një aspekt, më shumë hapësira publike po trajtohen me çmim më të lirë, ngritje e inkasimit në terma absolut. Sa i përket lejeve të ndërtimit, kemi 14 vite një degradim total dhe ka nevojë për një intervenim, dhe ky intervenim duhet me ndodh në fillim. Pra, shumë prej nesh trajtojmë një herë gjendjen, pastaj merrem me terapinë afatgjate dhe besoj që është shumë me rendësi që kur trajtojmë raporte buxhetore, sidomos këto tremujore, t'i trajtojmë si të tilla, mos të futem në super analiza të cilat e flasin të ardhmen, sepse raportet tremujore buxhetore nuk flasin për të ardhmen, por flasin për të kaluarën. Dhe, në fund fare, më duhet edhe një here të potencoj dhe i kërkoj ndjesë Kuvendit komunal, po e kam kryesues të rëndësishme, që rolin e juaj si kryesues i Kuvendit komunal, ta ushtroni në përpikëri dhe me forcë, dhe forcë kur them, nuk po mendoj fizike, por me forcën që ta jep rregullorja e Kuvendit, ligji, në mënyrë që mos të përfundojmë me situata ku njerëzit, asamblastët, të gjithë ne në këtë sallë, nuk i dalim hakut votës që na është dhënë dhe besimit që na është dhënë. Dhe, në këtë aspekt, mendoj që në çdo fjalë e cila mund të interpretohet si ofendim, të intervenohet, sepse atëherë po e eskalojmë, dhe kërkoj mirëkuptim prej të gjithë asamblastëve në këtë aspekt, pra që mbledhjet e ardhshme të Kuvendit komunal, mos t'i shndërrojmë në diskutime rreth fizionomive, rreth burive dhe të ngjashme të njerëzve, sepse, sinqerisht, nuk ka kuptim! Faleminderit!

Kryesuesi: Këtë të cilën e thatë ju, është shumë e arsyeshme. Herëve të tjera, ju të gjithë e dini rregulloren, i kini së paku rregulloren për punën e Kuvendit, dhe vërtetë duhet ushtrohet funksioni i kryesuesit, ashtu qysh është e paraparë me rregullore, shefat e grupeve parlamentare 10 minuta, tjerët 5 minuta, replika 2 minuta. Edhe duhet të përmbahemi gjithsesi fyerjeve, të cilat po na ndodhin në Kuvend. Herëve të tjera, po betohem që një gjë të tillë nuk do ta lejoj, unë do të kërkoj edhe largimin, se kamë të drejtë, përjashtimin nga salla, se vërtet unë besoj që në këtë mbledhje është teprua.

Kryesuesi: Në sallë gjithsej janë 37 këshilltar komunalë, e qesim në votim raportin tremujor buxhetor për periudhën korrik –shtator 2014.

Kush është për?

Për -16,

Kundër – 18,

Abstenim – 3.

Do të thotë, në bazë të evidencës që tash e kemi, nuk përkrahet raporti tremujor buxhetor.

Kryesuesi: Kalojmë në pikën e pestë.

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim Policisë së Kosovës.

Kryesuesi: Po e shoh që nuk paraqitet askush për diskutim, e qes në votim.

Kush është për?

Për janë të gjithë.

Kundër nuk ka.

Abstenim nuk ka.

Konstatohet se aprovohet Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim Policisë së Kosovës.

Kryesuesi:

Kalojmë në pikën e gjashtë.

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit në fshatin Hajvali.

Kryesuesi: Urdhëro, z. Gashi!

Bekim Gashi: Faleminderit, kryesues!

Unë po ndihem i nderuar që në emër të Grupit Parlamentar, të paraqes qëndrimin për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e stadiumit në Hajvali. Grupi Parlamentar i LDK-së, e mbështet ndarjen e lokacionit për ndërtimin e stadiumit në Hajvali, një kërkesë e imja e vazhdueshme, d.m.th. prej fillimit, prej janarit, D.m.th. unë e falënderoj në emrin tim personal, edhe në emër të klubit futbollistik "Hajvalia", Kryetarin e Komunës dhe nënkryetarin për angazhimin e tyre dhe për ndarjen e lokacioneve. Sigurisht, edhe shumë shpejt presimi fillimin e punimeve në ndërtimin e stadiumit në Hajvali. Faleminderit, Kryetar!

Kryesuesi: E qes në votim.

Kush është për?

Për janë të gjithë.

Kundër, nuk ka.

Abstenim nuk ka.

Konstatohet se Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit në fshatin Hajvali, aprovohet.

Kryesuesi: Kalojmë në pikën e shtatë.

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e përmendores së Ismajl Qemajlit.

Kryesuesi: Arsyetimin e dhamë në fillim, e keni edhe materialin.

A ka nevojë me diskutuar?

Urdhëro, z.Çelaj!

Lirak Çelaj: Të nderuar, kisha dashtë që të mos keqinterpretohet qëndrim ynë, jemi, natyrisht, shumë që të ngritet përmendorja e Ismail Qemajlit, është një personalitet për të cilin nuk kemi nevojë me fol, dhe mos të shesim patriotizëm tash me tregu kush dhe qysh është, por kemi vërejtje me lokacionin. Nuk mendoj që figura e Ismail Qemajlit duhet, po them, në thonjëza, “të fshihet në një skutë”, por duhet që të jetë në një vend më te frekuentuar, jo edhe në shesh, se është ngarkuar sheshi, por mendojmë që lokacioni për ngritjen e përmendores së Ismail Qemajlit, duhet te jetë një shesh më i madh, ku do të ketë peshën e duhur të këtij personaliteti. Mos të krijojmë përmendore shkel e shko, veç sa për ta bërë një tik, se e bëme një përmendore, që të bëhet një komision, ta shohim edhe në si duket ajo përmendore, t’i ikim pak ndoshta edhe monumenteve soc-realiste. Po më vjen keq që duhet ta apostrofoj përmendore e Bill Klintonit, por është bërë sinonim i përmendoreve të këqija. Edhe ato në shesh që janë vënë, janë futur anash, thuajse kemi turp prej tyre, qoftë Zahir Pajaziti, qoftë Nënë Tereza, të gjitha janë futur anash, nuk janë vënë në mese. Unë mendoj që Ismail Qemajli meriton një vend, një pozitë, ne mund te debatojmë për pozitën, nuk jemi me bërë shpejt e shpejt, me mbërri një datë 28 nëntor. Më mirë është me pritur edhe një vit, por me u vënë si duhet, sesa me bërë shpejt e shpejt.

Kryesuesi: Urdhëro, Kryetar!

Shpend Ahmeti: Nuk bëhet më 28 nëntor, përmendorja është gati, është e dizajnuar, por ju tregoj mandej skulptorin, po me vjen keq, nuk po me kujtohet emri, është grupi i intelektualëve të Vlorës që e kanë bërë shtatoren, po kërkojnë lokacion. Për mua dhe për neve si ekzekutiv, besoj edhe për Kuvendin komunal të Prishtinës, është e nevojshme vendimi politik që ne po pajtohemi me vendos shtatoren e Ismail Qemajlit në Prishtinë. Si lokacion, e kemi vendos aty, për shkak të pamundësisë me pas vende tjera në shesh, në qoftë se doni sot, mundemi me marr vendimin politik me vendos dhe, pastaj lokacioni ta diskutojmë, sepse kjo duket në mars pritët të vendoset. Po ashtu, edhe po ta vendosshim ne këtu, prapë duhet me marr pëlqimin prej Universitetit të Prishtinës, por, po e them, kërkoj pajtimin nga Kuvendi komunal, është kërkuar edhe nga Shoqata e Intelektualëve, pasi të premten e kanë marrë vendimin në Vlorë për Hasan Prishtinën, që të njëjtën ta bëjmë edhe ne për Ismail Qemajlin.

Kryesuesi: Ju e keni kopjen e vendimit, aty ku është lokacion, do ta heqim, edhe më vonë përcaktohet vendi.

Kryesuesi: Kush është për?

Janë të gjithë.

Kundër ?

Nuk ka.
Abstenim?
Nuk ka.

Konstatohet se Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e përmendores së Ismail Qemajlit u mor në Kuvend dhe do të caktohet me një vendim, ose Drejtoria e Urbanizmit do ta caktojë dhe na njoftohet ku është vendi.

Kryesuesi: Kalojmë në pikën e tetë.

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e përmendores së Osman Dumoshit.

Kryesuesi: Urdhëro, Kryetar!

Shpend Ahmeti: Për shtatoren e Osman Dumoshit, dua veç një fjalë me ju treguar. Me ju treguar të drejtën, qëndrimi i këtij ekzekutivi është që shtatoret individuale të mos i përkrahim shumë, për shkak se mandej as nuk kemi me pas vend, por kjo shtatore është tash më në diskutim që 7 vite, edhe ka pas diskutime të ndryshme. Prej vendit ku janë mbajtur demonstratat e viti 68, shko ma natan, shko ma natan, derisa ka ardhur ky vendim, që janë pajtuar edhe Shoqata e të Burgosurve, që të vendoset te Mensa e Studentëve. Unë edhe Shoqatës së të Burgosurve iu kam thënë që mos me ardhur më me kërkesa për shtatore individuale. Më mirë është me emërtime të rrugëve, me emërtime të institucioneve, sesa me shtatore. E në qoftë se bash duhet të punojmë, do të ishte mirë me pas një përmendore, apo si me e quaj, që i shënon edhe demonstratat e 68-ës edhe të 81-ës, por ai është diskutim shumë më i gjatë politik, por e kam bërë me këtë kërkesë që të përkrahët kjo, e pastaj, në të ardhmen, mos të sjellim shumë vendime të tilla individuale. Edhe kjo shtatore është gati, veç ka me u vendosur.

Kryesuesi: Kush është për?

Janë të gjithë.

Kundër?

Nuk ka.

Abstenim?

Nuk ka.

Kryesuesi: Konstatohet se me shumicë votash aprovohet.

Kryesuesi: Kalojmë në pikën e nëntë.

Propozimvendimi për ndërtimin e lokaleve afariste me partneritet publiko-privat.

Kryesuesi: Urdhëro, Kryetar!

Shpend Ahmeti: Pas ndërtimit të rrethrotullimit në Kalabri, i kemi dy nënkalime, të cilat janë të gjëra 8 m. Ato edhe nuk kanë ndriçim, edhe po shndërrohen në wc publike. Përvojat të cilat i kemi nga nënkalimet, janë ato të cilat kanë aktivitete afariste, atëherë edhe po mirëmbahen nga vetë dyqanet. E kemi shembullin e një nënkalimi që është në Pejton, po ashtu e kemi shembullin e nënkalimi në Kodën e Trimave, të cilin duhet me pastrua për çdo herë për shkak se aty nuk kalon askush. Propozimi është që në të dyja nënkalimet të ofrohet partneriteti publiko-privat, në ata 8 m, që të ndërtohen dyqane në 4 m, dhe kalimi të jetë 4m. Këtë ta bëjmë me procedurë të konkurrencës, siç e parasheh ligji. Mirëpo pasi që të ketë dyqane aty, dyqanet do të jenë përgjegjëse për mirëmbajtjen e nënkalimit edhe me ndriçim, edhe me pastërti. Pra propozimi është që këto të dyja të shkojnë në partneritet publiko-privat, sipas procedurave të parapara me ligj dhe nën udhëheqjen e komisionit.

Kryesuesi: Urdhëro, z. Pacolli!

Islam Pacolli: Sigurisht është e rëndësishme projektimi qysh bohet dhe publiko-privat, do të thotë forma e tenderimit, por Kryetari e ceku edhe pikërisht aty desha me u lidhë që një anë 4m lokale, ndërsa pjesa tjetër për kalim, ndoshta për arsyeje se kamë pa mjaft nënkalime, është e mirë më qenë në dy anët lokale dhe mesi me kanë nënkalim, nëse ka më shumë se 8 m, pajtohem, në rregull.

Kryesuesi: Dikush tjetër?

S'ka.

Kush është për?

Janë të gjithë.

Kundër?

Nuk ka.

Abstenim?

Nuk ka.

Konstatohet se Propozimvendimi për ndërtimin e lokaleve afariste me partneritet publiko-privat, aprovohet nga ky Kuvend.

Kryesuesi: Kalojmë në pikën e dhjetë.

Propozimvendimi për subvencionimin e mjeteve financiare për studimin e natyrës në Parkun e Gërmisë.

Kryesuesi: Urdhëro, z. Berisha!

Visar Berisha: Faleminderit, kryesues!

D.m.th. projekti i Gërmisë, në kuadër të projektit të Komisionit Evropian, në mes tjerash, shumica jeni të njoftuar me këtë projekt, në mesë tjerash ka paraparë edhe studimin e natyrës në kuadër të këtij projekti, në mënyrë që të shpallet Gërmia si kategori peizazh i mbrojtur, që e kërkon edhe Ligji për mbrojtjen e natyrës, gjithashtu edhe Unioni

Ndërkombëtar, për zona të mbrojtura, duhet të përmbushen disa kushte, që njëri prej tyre është edhe studimi i natyrës, por edhe studimi gjeografik. Studimi i natyrës ka qenë i paraparë në kuadër të këtij projekti, ndërsa studimi gjeografik nuk ka qenë i paraparë. Prandaj, subvencionimi për mjete shtesë bëhet që të përkrahet pjesa tjetër e studimit, që është studimi gjeografik, por gjithashtu që edhe të analizohet një pjesë, rreth 600 hektarë, që është jashtë kufijve, jashtë Parkut të Gërmisë, që ka qenë sugjerim edhe kërkesë e Institutit të Mbrojtjes së Natyrës, që edhe këtu të bëhet studime, të përfshihet pastaj edhe kjo në kuadër të parkut. D.m.th. ky është arsye për kërkesën për subvencionim për 15 mijë € shtesë, edhe studimi do të kryhet pastaj prej ekspertëve të Universitetit të Prishtinës.

Faleminderit!

Kryesuesi: Urdhëro, z. Shala!

Flamur Shala: Me ja nisë e me trajtuar dikush Parkun e Gërmisë, me të vërtetë e qëlluar edhe sipas projektit.

Kryesuesi: A ka dikush që donë me diskutuar?

Kush është për?

Janë të gjithë.

Kundër?

Nuk ka.

Abstenime?

Nuk ka.

Atëherë, konstatoj se Propozimvendimi për subvencionimin e mjeteve financiare për studimin e natyrës në Parkun e Gërmisë, aprovohet.

Kryesuesi: Kalojmë në pikën e njëmbëdhjetë.

Propozimrregullorja për hapjen e kutive të ankesave.

Kryesuesi: Urdhëro, znj. Pupovci.

Hatixhe Popovci: Diskutim jashtë mikrofonit.

Kryesuesi: Urdhëro, z. Nushi!

Muhedin Nushi: Përshëndetje të gjithëve!

Zonja Hatixhe, rregulloren nuk e di cilën e keni, a e keni variantin e fundit apo jo, mos e keni variantin e parë, i cili ka qenë në pyetje, sepse varianti i fundit është se kutitë e ankesave hapen çdo të premte të fundit të muajit, kjo nënkupton çdo muaj, ditën e premte të fundit të muajit hapen, kështu që jo çdo 6 muaj, duket se ju e keni variantin e parë.
Faleminderit!

Kryesuesi: Urdhëro, z. Pireva!

Sylejman Pireva: Edhe unë nuk e pash në rregullore. Mos është më mirë të shënohet destinimi i këtyre kutive edhe me shkrim, çoftë në mur apo kudo, që i bie që të dihet, të identifikohet se ku është kutia për ankesa.

Kryesuesi: Kush është për?

Janë të gjithë.

Kundër?

Nuk ka.

Abstenime?

Nuk ka.

Konstatohet se aprovohet Rregullorja për hapjen e kutive të ankesave.

Kryesuesi: Pika e dymbëdhjetë

Pika e dymbëdhjetë

Informatë për zgjidhjen e rastit të pronave në lagjen "Dodona".

Kryesuesi: Meqenëse janë duke pritur pronarët, ju lutem bëjani një vend aty, të ulen në fund. Të pranishmit, të cilët tash erdhën, vetëm do të dëgjojnë variantet të cilat janë dhënë në informatë. Këtë informatë sigurisht do ta paraqet drejtori për Financa dhe Pronë, pa të drejtë diskutimi të mysafirëve.
Urdhëro, Drejtor!

Visar Berisha: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar të pranishëm,

Në lidhje me zgjidhjen e rastit të pronave në lagjen "Dodona", mos të hyj shumë në historikun e gjatë të këtij rasti që tash po bëhen 3 apo 4 vite që është ky problem. Duke u ballafaquar me këtë problem, në mbledhjen e shkurtit të këtij Kuvendi, iu patë lënë ekzekutivit të merret me këtë problem dhe të vijë me një, ose disa propozime. Në qershor të këtij viti, është krijuar një grup punues, që ka qenë i përbërë prej përfaqësuesve të Drejtorisë për Financa dhe Pronë, përfaqësues të pronarëve, përfaqësues të investitorit, një arkitekt i pavarur dhe gjithashtu përfaqësues të Drejtorisë së Urbanizmit. I kemi mbajtur gjithsej tri takime formale dhe kemi pasur konsultime të gjata në këto tri takime, ku janë paraqitur, janë shoshitur disa ide, janë paraqitur më shumë se 5 ose 6 propozime,

janë diskutuar edhe me përfaqësues të pronarëve dhe, si rezultat, në fund, pas tri takimeve, kemi arritur në tri propozime konkrete, të cilat pastaj i kemi paraqitur si grup punues para ekzekutivit dhe gjithashtu i kemi paraqitur këto propozime dhe këto ide para Komitetit për Urbanizëm dhe Planifikim dhe kemi marr parasysh edhe sugjerimet e këtij komiteti. Janë diskutuar disa opsione. Më duhet të them paraprakisht që, e kemi kuptuar, d.m.th. problemin dhe lidhjen emocionale të pronarëve me ato prona dhe me ato shtëpi, lokale, të cilat faktikisht janë rrënuar pa ndonjë vendim të Komunës së Prishtinës dhe nuk ka pasur pastaj as ndonjë dokument, i cili ka dhënë një rrugë të qartë ligjore për vazhdimin e atij procesi, vetëm gojarisht është premtuar ndërtim sipas planit rregullues që atëherë ka paraparë ndërtimin e një ndërtese deri në tetë kate, e tani e kemi një situatë ku me kalimin e Planit zhvillimor urban, në shtator të vitit të kaluar, aty maksimumi që lejohet për ndërtim është P+4, plus respektimi i distancave nga institucionet kulturore të trashëgimisë kulturore që janë përreth. Kemi ardhur deri në tri propozime konkrete, të cilat i kemi diskutuar edhe me përfaqësues të pronarëve. Propozimi i parë, që për ekzekutivin ndoshta ka qenë një prej propozimeve më serioze dhe më të mira, sipas nesh, ka qenë që të bëhet këmbimi i pronës komunale ku momentalisht gjendet AKP-ja, këtu prapa ndërtesës së Komunës, me pronat private që aktualisht gjendet përballë Kuvendit të Kosovës. Me këtë rast, të gjithë pronarët do të dilnin në këtë lokacionin ku momentalisht gjendet AKP-ja dhe aty do të mundësohej ndërtimi i një qendre zeytare me etazhitet P+1 dhe do të mundësohej pra ndërtimi i një qendre zeytare, me një arkitekturë që përshtatet me zonën historike dhe me pjesën e vjetër të qytetit, me lokale afariste në përdhes, me banim, ose afarizëm në katin e parë dhe me funksionimin e një tregu të hapur në mes të asaj prone, si një shesh i vogël në kombinim me treg, që ka qenë edhe projekti konkret i paraqitur prej Drejtorisë së Urbanizmit. Në këtë rast, lokacioni ku është momentalisht, përballë Kuvendit, do të bëhej pronë komunale dhe, pastaj me atë pronë do të menaxhonte Komuna dhe do të vendoste se çka do të bënte në atë hapësirë. Sheshe, park, ndonjë ndërtesë me interes publik, çka do që është në interesin publik dhe të Komunës. Ky propozim nuk është përkrahur nga pronarët, prandaj ky propozim ka rënë në ujë, pasi që për këmbimin e pronës komunale, nevojitet edhe pëlqimi i pronarëve privatë. Prandaj, ky propozim sado që ne e kemi konsideruar si të mirë dhe të favorshëm për të gjitha palët, për interesin publik dhe për pronarët, ka rënë në ujë, nuk është përkrahur.

Propozimi i dytë, edhe pse ka disa parakushte që duhet të plotësohen, ka të bëjë me realizimin e një partneriteti publiko-privat, ku Komuna me pronën e vetë, bashkon parcelën me parcelat e pronarëve privatë dhe ndërton bashkarish, me një partneritet publiko-privat, një ndërtesë, e cila gjithashtu është në përputhje me planin zhvillimor urban, duke i respektuar distancat që i përmenda më herët, e cila është maksimumi P+4, por normalisht e dizajnuar dhe me pëlqim të Drejtorisë së Urbanizmit. Përsëri, pra, një qendër tipike zeytare, jo shumë e lartë, me një arkitekturë që do t'i përshtatej pjesës së vjetër të qytetit dhe do të krijonte një lidhje të asaj pjese edhe me sheshin, aktualisht që është sheshi Ibrahim Rugova, dhe me këtë pjesën tjetër të qytetit. Normalisht, këtu do të duhej që të merrej pëlqimi edhe i nivelit qendror për një partneritet të tillë potencial publiko-privat, sepse ky ligj e parasheh që të jetë d.m.th. në interes publik, pra të parashihet ndërtim i infrastrukturës publike ose ofrim i shërbimeve publike me këtë rast,

që besoj që do të mund të arsyetohej, por prapë se prapë është një kusht që duhet të plotësohet në nivelin qendror.

Propozimi i tretë, ka qenë që kjo pjesë të shpallet zonë e interesit të veçantë nga ky Kuvend komunal, me ç' rast do të duhej të bëheshin edhe ndryshimet në planin rregullues të lagjes "Dodona", ku ky Kuvend komunal do t'i parashihte, do t'i miratonte ato ndryshime që ajo zonë të bëhej zonë e interesit të veçantë dhe të parashihet aty qoftë park, apo çka do që është në interesin publik ose të qytetarit dhe të Komunës në përgjithësi. Rrjedhimisht, sipas kësaj të bëhej shpronësimi i pronave private, d.m.th. kompensimi me mjete monetare.

Pyetja e parë që del në këtë rast, është se sa do të kushtonte ky shpronësim. Nuk mund ta dimë, çfarëdo vlerësimi që e bëjmë tash, janë në pyetje disa milionë euro, mirëpo vlerësimin nuk mund ta bëjmë, pasi që për këtë është kompetente Ministria e Financave, e cila i merr parasysht të gjitha rrethanat, duke e përfshi edhe vlerën e tregut për ta bërë vlerësimin e kësaj prone. Nuk e dimë sa mund të kushtoj kjo, mirëpo një vlerësim është diku disa milionë euro. Çka do që themi, një shifër mund të jetë gabim dhe mund të paragjykojmë vlerësimin e Ministrinë së Financave.

Në përfundim kemi ardhur që, ndoshta si zgjidhje më e mirë dhe më e pranueshme do të ishte propozimi i dytë, që ka të bëjë me tentimin e një partneriteti potencial publiko-privat, me të gjitha ato kushte që duhet të plotësohen. Besoj, që do ja vlente që të shkojmë në këtë drejtim dhe të shohim se a do të mund të realizohet diçka, ku edhe Komuna do të kishte realizimin e interesit të vet dhe pronarët privatë do të realizonin interesin e tyre për tu bërë me pronat e veta, për të qëndruar aty dhe për të realizuar interesin e tyre për ndërtim.

Faleminderit!

Kryesuesi : Faleminderit, drejtor !

Dëgjuam arsyetimin e drejtorit, atëherë kisha lutur përfaqësuesit e GP-së të japin deklarimin e tyre. Pra, tash po hyjmë në fazën e diskutimit.

Urdhëro, Mustafë!

Mustafë Krasniqi: Faleminderit, kryesues!

Në mungesë të Samiut, fjalën po e marr unë, për më tepër si anëtarë i Komitetit të Planifikimit, ku kam qenë pjesëmarrës në atë takim, ku e përmendi drejtori, që është prezantuar para nesh si problematikë e rastit në fjalë, që e tha. E vërtetë është që në mbledhjen e parë të këtij trupi që jemi këtu, e kemi diskutuar dhe ka dalë Kryetari para nesh, është marr me këtë rast, për të bërë zgjidhje për pronarët atje. Atëherë jam deklaruar, të njëjtën gjë po e bëj edhe tash, edhe pse ju kemi dhënë mundësi, ne gjithë këshilltarët jemi pajtuar dhe kemi sugjeruar që Kryetari, me gjithë ekzekutivin, të formojë një grup, le të merret le të zhvillojë takime dhe biseda me pronarë dhe të gjejë një zgjidhje të përshtatshme, një zgjidhje të pranueshme, apo të kapshme, që është për Komunën, por edhe për të gjithë ata pronarë. Sugjerimi im që ka qenë edhe në Komitet të Planifikimit, që në seancën e parë, dhe prapë qëndroj prapa saj, ne kemi menduar që kemi bërë një zgjidhje të mirë, kur e kemi marr një vendim me qenë para një akti të tillë. Një far forme, qëndrojmë prapa atij mendimi që ne e kemi dhënë, deri në rastet kur nuk gjendet ndonjë

zgjidhje më e mirë, e kjo zgjidhje më e mirë është e pranueshme edhe për Komunën, edhe për pronarët. Unë me vëmendje i dëgjova këto tri propozime që ju i thatë, edhe variantin e dytë, që ju sugjeroni të jetë e pranueshme për vetë pronarët atje. Unë tash po e marr atë të drejtë, në emër të grupit, që nëse si zgjidhje e propozuar për ju është varianti i dytë për me ardh atje, dakord edhe ne pajtohemi me këtë, dhe të ecim tutje. Po është e arsyeshme, se as ne nuk mund të dimë a është e pëlqyeshme dhe e pranueshme pa nënshkrime të vetë pronarëve. Edhe një herë po e them, nëse ka dakordime të tilla rreth variantit që ju jeni dakord dhe keni propozuar, absolutisht edhe ne si grup do ta përkrahim, se jemi të interesuar që t'ju zgjidhet një herë e përgjithmonë çështja e problemeve që i kanë pronarët atje.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, Mustafë!

Urdhëro, Ylli!

Ylli Hoxha: Faleminderit, kryesues!

Së pari, dua të falënderoj ekzekutivin që, për një kohë të gjatë, është marrë me një çështje delikate, e cila na është reflektuar në hyrje të Komunës gati çdo ditë me protestë të banorëve. Ka qenë një proces i mundimshëm, por besoj që ja ka vlejtur, sepse alternativa e tij ka qenë një shkëmbim i pafavorshëm i pronës komunale, në të cilën, besoj që kemi bërë mirë që ja kemi ndaluar në seancat e para të këtij Kuvendi, dhe tash më duhet gjithsesi të shpreh mirënjohje për procesin. I kam analizuar tri zgjidhjet që i keni propozuar. Natyrisht, ndaj edhe simpatitë tuaja për zgjidhjet e ..., por natyrisht edhe bregat e juaja për problemet që mund të ngrit secili prej opsioneve. Për mua personalisht, ka qenë e rëndësishme mbrojtja e pronës komunale, dhe konsideroj që tash e tutje i bien më shumë ekzekutivit, e më pak ne që të japim preferenca, apo ta diktojmë rrjedhën e këtij procesi. Sidoqoftë, konsideroj që mbrojtja e interesit publik, po ashtu duhet të jetë një prej kriterëve të rëndësishme brenda këtij debati. Uroj që sa më shpejt të zgjidhet ky proces dhe të përfundojë sa më mirë për gjithë ne.

Kryesuesi: Faleminderit!

Prej PDK-së, dikush?

Urdhëro, Laura!

Laura Zherka: Faleminderit, kryesues!

Është e vërtetë që si pikë e rendit të ditës një prej takimeve të Komitetit për Urbanizëm ka qenë edhe zgjidhja e problemit të këtyre pronarëve, dhe ka qenë edhe një nga propozimet e mia që, në një seancë të Asamblesë, të qiten opsionet, d.m.th. të ofrohen opsionet lidhur me zgjidhjen e problemit të pronarëve. Duke e ditë se të dy palët, edhe Komuna, edhe ekzekutivi ishte në këtë formë i pafajshëm, edhe për pronarët po ashtu të pafajshëm, në mënyrë që ta arrijmë një konsensus. I kemi këto propozime të cilat na i kanë ofruar ekzekutivi. Unë mendoj se duhet t'i shqyrtojmë, në mënyrë që ta ruajmë edhe pronën publike, edhe kërkesat e qytetarëve, sepse këta pronarë të tokave janë joshë me një vendim. A ekziston ai vendim prej qeverisë së kaluar, edhe këta po ashtu janë të

pafajshëm. Në qoftë se për të tri opsionet pronarët nuk janë të pajtueshëm, këta edhe atë ditë kemi propozuar që të shkojnë të ankohen në Gjykatën Themelore.

Kryesuesi: Urdhëro, Islam!

Islam Pacolli: Faleminderit, kryesues!

Sigurisht që nga fillimi ka qenë kjo temë, natyrisht që për ne si AKR ka qenë shqetësuese, për arsye që forma e fillimit të startimit të ardhjes deri këtu të këtij procesi, ne mendojmë që nuk ka qenë në formën më të mirë, për arsye që Asambleja e kaluar kur e ka aprovuar, pse nuk është lëshuar vendimi menjëherë, pse ka pas arsye që kjo të shtyhet? Ne sigurisht që për diçka që ka filluar jo ligjshëm, ju e dini që edhe më herët e kemi cek këtë qëndrim, ne nuk e përkrahim një diçka që ka filluar jo ligjshëm, ta bëjmë të ligjshme. Mendimi im dhe i grupit është që propozimi më i mirë kishte me qenë që të arrijmë ta bëjmë një pjesë të gjelbërimit, eventualisht ne nëse kthehemi me ruajt të atëherëshmen, atëherë nuk është P+4, më falni, P+1 eventualisht P+2, pra, nuk jemi në përputhshmëri në atë që ne po duam me u thirr. Nëse duam diçka të ligjshme, atëherë ta formojmë, ta funksionalizojmë të ligjshme ose mos e kërkoni votën tonë, për arsye që ne jemi përgjegjës para qytetarëve. Ju e dini shumë mirë që këtu ka filluar funksionimi, siç thuhet, alokimi i mjeteve i diçka të cilën ti nuk e posedon. D.m.th. është mashtruese për qytetarin, por edhe qytetarët në rast se kanë dashtë me u mashtruar me vetëdijesim, atëherë t'i mbajnë pasojat. Para se ju të kërkoni diçka, dikush donë me pas një pasuri, kërkohen disa dokumente dhe këtu unë e kam cek, ju e dini shumë mirë qëndrimin edhe më herët, që kjo ka filluar jo ligjshëm. Mendimi im për me e bë legjitime, duhet me e heq këtë prej Propozimin ju e keni parë edhe më herët që, për pjesën e parkut gjelbërues, në veçanti unë kam kërkuar që të jetë gjelbërim sa më shumë, këtu në qendër të qytetit pse mos ta kem një gjelbërim. Atëherë, për mendimin tonë, dhe përkrahja jonë kish me qenë e fuqishme nëse shkojmë me pjesë gjelbëruese, por në rast se nuk funksionon kjo, nëse donë me qenë publiko-privat, atëherë jo P+4, po P+1, eventualisht P+2 nëse duam me thyer pak rregullin, për arsye që nuk ka pasur ndërtim të lartë aty.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, Islam!

Urdhëro, Imer!

Imer Rusinovci: Normalisht, GP i jonë, si AAK, e kemi analizuar si problem dhe, edhe dje, edhe sot në mëngjes, si grup jemi takuar dhe i kemi shtjelluar të tri variantet, të cilat paraprakisht janë paraqitur edhe në Komitet për Politikë dhe Financa. Normalisht, që janë analizuar me vëmendje dhe kujdes, duke filluar prej këmbimit të pronës, prej variantit të dytë - partneritetit publiko-privat, dhe të tretës, shpronësimit për hir të interesit të veçantë. Dua të potencojë një fakt pak më karakteristik. Ne si subjekt politik, se do ta kem një shkallë demokratike të votës, nuk kam kërkuar t'ia imponoj askujt votën nga anëtarët e grupit tim. Janë të kapshme që të tri variantet këtu, të shohim pra se cila është më e mira.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Urdhëro, z. Mehdiu!

Feti Mehdiu: Faleminderit, z. kryesues!

Unë e shfrytëzoj këtë rast të përshëndes pronarët, që janë të pranishëm këtu, dhe të shpreh keqardhje për pasojat që i kanë pas deri tash ata. Nuk dëshiroj që ta zgjas këtë muhabet shumë gjatë. Komisioni që ka punuar këtu, e përkrah, e përgëzoj për punën që e ka bërë, propozimet që na ka ofruar i pranojë. Pronarët, veçanërisht i falënderoj që na kanë heq qafe pikën e parë, kjo tash është në atë frymën që ne kemi qenë kundër qysh në fillim, por tash na kanë mbetur dy pika. Prej atyre dy pikave që kanë mbet këtu, unë dëgjova që edhe drejtori e ka një lloj sugjerimi, që pika e dytë është më e përshtatshme. Ne mendojmë, tek pika dy, ka humb dy mundësi ky vend, njëherë ka mbet shumë i vogël për të imituar atë pjesën e vjetër, që mendojmë me cilësuar si pjesë e vjetër, por në atë sipërfaqe që ka mbet aty është e pamundur. Ajo do të hahej si arsyetim, po të ishte e hapur në mes të Vellushës që është atje, rrugës që dilte te shkolla "Elena Gjika", do të mundej të bëhej një lagje e ngjashme me ndonjë në Prizren, ose në Sarajevë, ose Shkup. Për ne e ka humbur atë funksion, nuk mundet. E dyta, propozimi që është për P+4, unë e përkrahi këtë mendim, se P+4 nuk ka në atë urbanizmin, tash mos ma shihni mua për kusur, unë flas atë çka di unë dhe çka e marr me mend. Ju urbanistët mund të shkoni të shihni një lagje që mendojmë ta bëjmë ne këtu, a janë ashtu a jo, unë nuk i kam parë, P+4 nuk kam pa, pra edhe kjo është humb. Mendimi ynë do të jetë kështu, pronarët të diskutojnë me drejtorin dhe të shohin se cilin po e pranojnë ata, për shkak se është shumë delikate kjo. Ne tash hymë të japim mendim për diçka që nuk është e jona, po përipiqemi që ata të cilët na kanë pru neve këtu, të mendojmë sa më shumë për Prishtinën, për qytetarët e Prishtinës. Mendojmë, pika e tretë për ne është më e përshtatshme dhe më shumë që i plotëson nevojat e këtij qyteti. Pika e tretë është, aty ndërtime të mos lejohen, mirëpo pronarët të shpërblehen, këtu mirë figuron, sipas Ministrisë së Financave. Unë tash kam edhe një mendim tjetër, a bënë me shpreh këtë mendimin tjetër? Këtu duhet të shkojë puna pak kur prek në ndjenjat e atyre pronarëve, le të thyhet ai indeksi që e ka Ministria e Financave, për shkak se kanë hy i ka shti dikush, kush ka me i shti, ne, Komuna i ka futë në një far loje, që tash e kanë vështirë me dal. Shpërblimi le të jetë pak më i lartë sesa ai indeksi që e kanë Ministria e Financave. Unë ju falënderoj, ky ishte mendimi ynë lidhur me këtë.

I falënderoj pronarët për praninë këtu dhe për durimin që kanë bë deri tash!

Abetare Fazliu: Meqenëse, zgjidhja më e mundshme është propozimi nr.2, ajo është çka e ka zgjedh edhe grupi punues, d.m.th. edhe ne si LB e përkrahim.

Kryesuesi: Faleminderit!

Urdhëro, Visar!

Visar Arifaj: Faleminderit!

Fillimisht, desha me shpreh edhe unë keqardhje për qytetarët që ju ka ra me duruar deri sot këtë zvarritje të kësaj çështje. Sa i përket propozimeve që i kemi pranuar, po e

Faqe 72 nga 100

pranojmë që pika e parë ka qenë ajo që neve na është dukur ndoshta më e favorshme për Komunën. Në anën tjetër, duke e pas parasysh, duke u pajtua edhe me subjektet politike që folëm më herët në lidhje me etazhitetin P+4, po tingëllon si diçka shumë e madhe, shumë e lartë për atë hapësirë, dhe si diçka që mundet me e ngufatur, sado që po përmendet që respektohen distancat nga objektet e trashëgimisë kulturore. Megjithatë, nuk mundem me e përkrah një zgjidhje për të cilën nuk mundemi me pa saktësisht a është e pranueshme për atë pjesë aq të rëndësishme të qytetit të Prishtinës. Pra, nuk jemi duke fol për disa prona në periferi, por është bash qendra ku vendimin të cilin e marrim ne si Komunë, ka me pas pasoja për gjeneratat që vinë. Kështu që për ne, propozimi nr. 2 ende nuk është zgjidhje e mirë sa me e përkrahur. Faleminderit!

Kryesuesi: Ne i dëgjuam të gjithë shefat e GP-ve, unë para se me fillua me diskutimin, ja japim fjalën edhe Listës Srpska, nëse jo, atëherë Kryetari e merr fjalën.

Shpend Ahmeti: Veç për me shtu, se e ceku Visari, por është me rëndësi me u potencuar, këto dyqane, prona, janë rrënuar pa asnjë vendim. Nuk ka, ne nuk e kemi gjet vendimin në letër, pra pronarët nuk kanë vendim. Kjo ka rrjedh kështu: Janë ftuar pronarët në zyre të Komunës, u është prezantuar një projekt që është duk bukur, si një banesë e madhe 8-katëshe me dyqane, janë joshë apo jo, nuk e di. Disa prej tyre kanë pranua me ju rrënuar, disa i kanë thënë deri në 12 të natës lësho atë se është marr vendimi me u rrënuar këto dhe janë rrënuar. Tash ne jemi Komunë, pa marrë parasysh çka ka bë Komuna, ne duhet me i bartë pasojat si Komunë, duhet me potencuar edhe këtë. Unë nuk po flas ata çka kanë bë e tash ne diçka tjetër, por po flas si Komunë ne e kemi një përgjegjësi për gabimet që janë bë. Është një rrugë tjetër, me shkua në gjyq, me na qitë në gjyq fitojnë, zgjatet kjo, vlerësohet dëmi që është bërë që e kemi rrënuar, por mundet me na urdhëruar gjyqi dhe me kthye në gjendje të mëparshme. Pra, ka disa opsione çka mundet me bërë gjyqi, por ajo merr pak më shumë kohë. Mendoj që një proces gjyqësor sot në Kosovë i ka minimum 2- 3 vite, posaçërisht në raste të tilla pronësore. Tash a janë josh ose jo, a duhet me i bart pasojat vetë pronarët nuk mundem Islam me hy në mendjen e tyre, po e kanë pa secili prej tyre nga një dyqan të vogël, nga një shtëpi, disa prej tyre kanë marr më shumë, disa më pak. Unë e kam takuar secilin prej tyre individualisht, secilën familje. Këto familje, secila prej tyre, individualisht, e ka një marrëveshje me Lesnën. Lesna ua ka paguar qiranë, por marrëveshje ne si Komunë as me Lesnën, as me pronarët nuk kemi. Nëse shkohet me opsionin e dytë, veç për këtë po dua me shpjegua partneriteti publiko- privat çka nënkupton. Nënkupton që tash ne si pronarë të tokës që i kemi 10 ari aty si Komunë, së bashku me këta pronarë që i kanë bashkë 10 ari, është edhe një pronarë që nuk ka qenë në marrëveshje me Lesnën, Basriu, apo si e ka emrin, në qysh te xhamia, ne duhet me u ulë me këta dhe me nda secili interesin sa e kemi në atë ndërtim dhe, pastaj atë ndërtim duhet me e qitë në konkurrencë një kompani ndërtimi e cila kishte me e ndërtuar. D.m.th. ne jemi si një palë aty, bëhemi të gjithë bashkë kur hyjmë në bashkëndërtim. Ku dallon kjo prej vendimit të mëparshëm? Në vendimin e mëparshëm ka qenë që toka e Komunës me dhënë aty ku është Voçari, e Voçari me marrë këtu, ata me mund me ndërtua, e toka e Komunës me na mbet në gjelbërim, distanca prej xhamisë deri te ndërtimi. Ne po e bëjmë ndryshe, ne po e ruajmë

pronën e Komunës, ajo mbetet pronë e Komunës, ajo 10 ari. Në emër të asaj prone të Komunës ne marrim përqindje në ndërtim dhe atë mund ta shfrytëzojmë qoftë për dhënie me qira, raste sociale, edhe pse në qendër të qytetit nuk mund ta parashohim si të tillë, por mund të rrisim vlerën e pronës komunale. Pra, duhet ta kuptojmë edhe këtë proces. Pastaj, ne do ta kishim në dorë ta kuptojmë se si do të duhej të dukej ai objekt. Po e them prapë, kjo është ideja e këtij ekzekutivi, në mënyrë që ta ruajmë edhe dukjen e asaj pjese të qytetit nëse shkohet me këtë variant. Ideja e këtij diskutimi është që kjo nuk është çështje të cilën e vendos Kuvendi. Kuvendi vendos plane rregullative, vendos sa mundet me u ndërtua aty, mirëpo çështje që kanë të bëjnë me a hyjmë apo jo, ne si ekzekutiv vetëm nëse ka partneritet publiko-privat dhe flasim për ndonjë koncesion që ne e sjellim këtu në Kuvend, mandej duhet me aprovua Qeveria, na pret një proces i gjatë. Në fund, ndoshta edhe nuk merremi vesh me pronarët dhe duhet me shpronësuar prapë se prapë, sepse ne në gjendje të mëparshme nuk e kemi të drejtën me e kthyer. Dy pronarë i kemi që kanë mbet as këndeje, as andej, sepse tash Lesna ua ka ndalë gjysmën e qirave kur e ka pa që nuk po ec ky projekt. Iu është premtuar leja, e mandej nuk është bë, por nuk mundemi pafundësisht ta bartim tu e zvarrit. Ideja është që të marrim një vendim, dhe ideja e këtij diskutimi është që të marrim këshilla nga ju se çka mendoni ju se cila është ideja më e mirë. Visari e përmendi shpronësimin. Shpronësimin ne nuk mundemi me përmend vlerë, nuk mundemi me thënë kaq do të na kushtojë, por është e qartë që do të ishte një shpronësim i kushtueshëm. Ka edhe kërkesa prej organizatave të ndryshme ndërkombëtare që duan ta ruajnë pjesën e vjetër të qytetit, që thonë nuk kishte me qenë mirë me ndërtuar aty, thonë ndoshta edhe ju kishim ndihmuar pak, por shpronësimi i Ministrisë së Financave zakonisht, po e përmendi, edhe profes po i përgjigjem, goxha vlerësimet e “gjymerta” i kanë, nëse mundem me u shpreh qashtu. Nëse ju si individ shkoni me e ble atë tokë, po ju garantoj që ju nuk i kishit dhënë ato pare çka ta vlerëson Ministria e Financave si vlerë. E vlerëson tokën, objektin, profitin e humbur që e ke pas dyqanin dhe që nuk ke me fitua për shkak se tu ka marr ajo pronë. Pra, do të ishte një shpronësim i kushtueshëm, por duhet ta diskutojmë a ja vlen që të bëjmë një gjë të tillë. Pra, pronarët në një moment kanë ardhur dhe më kanë thënë, veç ktheje qysh ka qenë se nuk po duam as banesa as asgjë, sepse disa prej tyre kanë pas prona më të mëdha, disa kanë pas dyqane, me të cilat kanë jetuar. Tash as nuk kanë veprimtari afariste, qiranë ua paguajnë, shumica prej tyre punojnë punë.. Dhe, po ju tregoj sinqerisht, me secilën familje që të bisedoni ose ka vdekur dikush prej familjes nga stresi, ose ka pas sulm në zemër, ose në kokë. Këtë po ua them unë, se e di, kam fol me secilin prej tyre. Prandaj, është mirë që të vendosim, cilado mënyrë pronarët po kërkojnë përgjigje. Një nuk e pranojnë, natyrisht për ndërtim janë të gjithë, shpronësimin po ashtu nuk e kanë në qejf. Ua them edhe këtë, por duhet me i marr përgjegjësit edhe ne për gabimet që i ka bë Komuna, pa marrë parasysh kush. Unë jam Kryetar i Komunës së Prishtinës dhe Komuna e Prishtinës i ka bë këto në emër të Komunës.

Faleminderit!

Kryesuesi: Urdhëro, Muhamet!

Muhamet Selmani: Faleminderit, kryesues!

Kryetar, ne në një mbledhje, nuk më kujtohet se cila ka qenë, e kemi diskutuar këtë problem. Është shumë i ndjeshëm, e dimë të gjithë, dhe kemi votuar bashkërisht, e kemi marr një vendim bashkë, që ajo pronë të bëhet gjelbërim. Kemi diskutuar edhe për një shesh, që të bëhet një shesh i gjelbër. Diskutimi ka qenë ky, por nuk më kujtohet cila mbledhje ka qenë, më falni, sugjerim!

Është vend i ndjeshëm se është në mesin e të gjitha objekteve të kultit, qeveritare, plus asaj lidhet me sheshin "Ibrahim Rugova" dhe, siç e dimë, projekti i zgjerimit të sheshit të Prishtinës fillon te Kisha dhe përfundon te Xhamia e Madhe. Është një plan, sa do të realizohet, d.m.th. që në një të ardhme të afërt ne prapë do të hyjmë në shpronësime, jo vetëm të asaj toke, por do të hymë në shpronësime me disa objekte që janë përreth matanë rrugës dhe këndej rrugës. Tash, çka dua të them me këtë, është që ne duhet të merremi me këtë problem në qytet që e ka lënë dikush tjetër. Ju besoj juve pronarë dhe besoj që dikush ju ka ftua juve në Komunë, por kush?! A ka emër që i ka ftuar dikush? Të lutem, kjo është pyetja ime. Kush i ka ftuar ata njerëz? Kryetar, të lutem, kush i ka ftuar dhe kush i ka rrënuar ato objekte? A i ka rrënuar Komuna, apo një privat? Nëse Komuna e ka marrë një vendim, i ka rrënuar ato objekte, në emër të kujt i ka rrënuar ai person ato objekte. D.m.th. nuk është faji yt që janë rrënuar ato objekte, absolut, sepse ti nesër do të hysh në shpronësim të një toke prapë, diku që kushton me miliona, por do ta shpronësosh. Ne kemi hy në shpronësim të rrugës që kushton 8 milion euro, për me ndërtua një rrugë që kushton 800 mijë euro. Nuk është problemi nëse ne e humbim gjyqin, por problemi është qysh me ua zgjedh hallexhinjve hallin që ju ka rrënuar objekti. Propozimi yni është për këmbim të tokave dhe nuk pajtohem, dhe propozimi ynë për me ndërtua një shesh ka ma ardhur prapë. Ndoshta pas 10 vitesh kemi me marr vendim me ndërtua shesh dhe prapë ke me pagua për me rrënuar, këtë e ke shumë të qartë se do të vije ajo punë. Ne planifikojmë me ndërtuar edhe një shesh këtu në mes të Komunës, që është sheshi "Adem Jashari", prapë planifikohet me ndërtua nënkalime aty. A ka me pas rrënime dhe shpronësime? Me siguri që do të ketë. E cila është më e lehtë tash. Tash ne duhet ta gjejmë një pikë më të lehtë që të realizojmë projektin. Nuk po them që këta me i dëmtuar, absolut, këta janë të pafajshëm. Së pari, faji i tyre i vetëm është që i kanë besuar dikujt, kur është më mirë me i besua letrës. Këta janë ftuar në Komunë, dikush ua ka dhënë një urdhër, ua ka dhënë një premtim, ai njeri nuk është në letër, nuk e kanë, dhe këta sillen dhe na protestojnë përpara. Kanë të drejtë, sepse i ka gënjyer dikush, por ai që i ka gënjyer, ai le të merret me ta, dhe ai le të ballafaqohet me ligjin, jo ne. Në qoftë se ai person i ka përdorur mjetet e Komunës me ua rrënuar objektin e tyre, prapë është barra e dytë e tyre.

Kaq kisha. Unë jam për me bërë zgjidhje.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Urdhëro, Islam!

Islam Pacolli: Faleminderit, kryesues!

Ndoshta nuk bëhem i tepërt, por me të vërtetë, kur po flasim për ligjin, atëherë duhet të

kemi kujdes dhe me vepruar në bazë të ligjit. Unë i kam disa pyetje, po ashtu edhe mendime të mia. Diçka e ceka edhe më herët që nuk është e ligjshme, kush kërkon që ne ta legjitimojmë. Iu kisha lutur edhe Kryetarit, gjërat që nuk janë të ligjshme, nuk ka nevojë të na sjell këtu, për arsye që në rast se nuk është nxjerr një vendim për ndërrimin e asaj prone dhe ju prapë po i sillni këtu, po doni me legjitimuar një vepër penale që e ka bërë dikush. Kushdo që të jenë që e ka dhënë urdhrin, pavarësisht që është në Kuvendin Komunal, nëse e ka një vendim të nxjerrën për rrënimin e tyre, atëherë ai i cili e ka nënshkruar atë vendim, le të jep llogari për atë vepër penale. Ju, z. Kryetar, ju e cekët që Komuna nuk ka marrëveshje me ata banorë, ka dikush tjetër. Ju lutem, ai person i cili ka marrëveshje, ai duhet me u përgjigj, kështu që ju kisha lut mos ta sjellim problemin prej rrugës ta sjellin në shtëpinë tonë. Nëse është dikush, një person, individ, apo 3 individë, nuk po di unë, shembull po e marr se nuk po e di a ka vendim apo jo, dhe ka dhënë urdhër që të rrënohen ato pa bazë legjitime, pra është vepër penale dhe ka kush të merret me të, e jo ne të humbim kohë këtu. Ne jemi që të ndryshohet aty, në rast se më e keqja, po e them kushtimisht, nëse varet diçka prej nesh, ne do ta aprovojmë, eventualisht P+2, nëse vjen më e keqja P+1 si ka qenë, po them nëse vjen deri te më e keqja. Ne jemi për me qenë një gjelbërim, për arsye që kjo ka filluar jo ligjshëm, donë me u legjitimuar përmes neve. Jo, nuk jemi dakord. E dyta, nëse Kuvendi komunal e ka pronën në zemër të asaj parcele, pse duhet me qenë i barabartë me të tjerët që janë anash? Ju lutem, unë jam kundër kësaj që është e paligjshme! Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, Islam!

Pa marrë parasysh faji i kujt është, këta duan dhe duhet çështjen me ua zgjidh njerëzve, pa marrë parasysh! Samiu e ka fjalën!

Sami Hamiti: Faleminderit, kryesues!

Megjithatë, po më duhet me thënë, edhe pse Dardani nuk është këtu, që po thotë memorien institucionale me përdor. Paligjshëm aty vendim nuk është marr, sepse ajo i përket një plani rregullativ që është "Dodona" dhe është plan i aprovuar në Kuvend komunal dhe ata janë pronarë privatë, pronarë që janë mbledh dhe iu kanë nënshtrua një plani. Dilema ka qenë, sepse pronat kanë qenë të kombinuara dhe ka pas pronë komunale. Ata janë pronarë legjitim, të cilët i nënshtrohen një plani rregullativ që është aprovuar në këtë Kuvend dhe asgjë të jashtëligjshme nuk ka. Mos e lëviz kokën atje hiq, sepse ai që ka shpronësuar, ky që e ka Voçarin këtu, që e ka ble dhe e ka privatizuar, është njësoj si pjesa që është privatizuar "Iliria", edhe ai e ka të njëjtën të drejtë, absolutisht, mos me thënë tash andej-këndej. Ajo pjesë nuk është pjesë e mbrojtur, pjesa ku janë këta, është monument i mbrojtur, xhamia, absolutisht atje do të vijmë edhe deri tek rrënimi. Xhamia është monument i mbrojtur, që e dimë që me Ligjin për mbrojtjen e kalkulon që duhet të jetë 50 m këtej dhe është marr ai pëlqim prej Ministrisë së Kulturës. Me u ndërtuar, jo me u rrënuar, të lutem, dëgjomë. Unë po flas diçka, se po e përmendni pa dije çështjen që është shkel ligji. Nuk është shkel ligji, sepse janë vendime të Kuvendit dhe vendime të institucioneve. Ministria e ka dhënë formën si mundet të ndërtohet kur të

merret leja. Problemi ka qenë me pronën komunale, si duhet t'i qasemi pronës komunale për ndërtim. Problemi i tërheqjes prej xhamisë në 50 m me.... dhe kemi ardhur në një vendim që e kemi sjell në Kuvend, në këtë përbërje, dhe është votuar me 48 vota, që pjesa e Komunës të mbetet gjelbërim. Në ndërkohë, kur ka ardhur deri te pozicioni i këmbimit të pronave me Ministrinë, është ardhur si ide dhe ne e kemi me përkrah si ide, në kuptimin që të bëhet një zgjidhje. Po zgjidhjen nuk e bëjmë ne me tregu këta një kat, e dy kat, sepse ai është ligj, edhe plani urban zhvillimor atje ka lënë një koeficient. Ato objekte nuk kanë qenë të mbrojtura, nën mbrojtjen që është monument i mbrojtur. Elementi që e përmendi Kryetari, rrënimi i objekteve, është bërë pa vendim, por ai rrënim është bërë për objektet të cilat kanë qenë komunale. Ju e dini se Inspeksioni i vjetër ka qenë aty dhe pjesa tjetër e rrënimeve është bërë pasi që është arrit një marrëveshje me pronarë dhe është konsideruar që bëhet, por këta njerëz kanë pronë komunale, pronë të veten aty. Por, ajo nuk është gjendja që Kryetari po e ngrit, por çështjen e ndërtimit me rrit vlerën e pronës komunale që edhe me Ligjin e vetëqeverisjes lokale, thotë të rritet. Partneriteti publiko-privat, shikojeni mirë, analizojeni me ekzekutivin, tjetrën që si variant çdo marrëveshje që arrini me pronarin në kuptimin e bashkëndërtimit me bashkëpronarët në pjesën e vetë, sepse ne nuk ua tregojmë etazhitetin, por ua tregon ligji. Atë marrëveshje që e arrini, jemi pro asaj që të arrihet një marrëveshje edhe në pronë komunale me partneritetin publiko- privat. Komuna nuk mundet të shpallë për pronën private, por e shpall për zonën e vet.

Tash jemi ardhur në një element, që ekzekutivi pretendon që mund të ndërtohet me një partneritet publiko-privat, me pronarët në bazë të ligjit. Ne e përkrahim.

Kryesuesi: Faleminderit!

Urdhëro, Qëndron!

Qëndron Kastrati: I nderuar, kryesues,

Të nderuar përfaqësues të ekzekutivit,

Të nderuar këshilltarë të Kuvendit komunal dhe

Të nderuar mysafirë!

Unë, si përfaqësues i Grupit të LVV-së në Komitetin e Planifikimit, po dua me shpalos sugjerimin ose mendimin qysh si grup, unanimisht jemi marr në lidhje me këtë çështje. Për ne është shumë e rëndësishme se prej çfarë këndi po mendohet. Këtu mundemi me menduar, në këtë rast, prej dy këndvështrimeve, a po mendojmë vetëm prej këndvështrimit të pronarëve, që janë një numër i konsiderueshëm i vogël, apo po e mendojmë prej këndvështrimit të interesit të përgjithshëm të qytetarëve. Ne si GP, kjo zonë për me mund me u bë zonë e gjelbër dhe park i gjelbër, ku e shfrytëzojnë të gjithë qytetarët, është mundësi që besojë ndoshta edhe 20 vite, apo 50 vitet e ardhshme nuk do të mund të vjen. Po, dua të ndërlidhem te këto çështjet se metodat, apo mënyrën, ose një prej premtimeve kryesore të kandidatit për Kryetar, që tash më është Kryetar, ka qenë rritja e hapësirave gjelbëruese, sidomos qysh është e nevojshme në qendrën e Prishtinës. Po dua gjithashtu të shpjegoj mendimin tim personal, tek çështja e përgjegjësisë së Komunës. Përderisa nuk ka marrëveshje formale të Komunës me banorë privatë, Komuna nuk ka përgjegjësi për kohën e humbur që ata nuk kanë pasur mundësi të

zhvillojnë biznesin. Ajo është përgjegjësi e atyre dhe duhet me ua zbatuar ato palë kontraktuese që e kanë arritur këtë marrëveshje.

Për fund, edhe një herë po e theksoj që qëndrim i LVV-së në raport me gjendjen, terrenin dhe interesin e përgjithshëm, jo vetëm interesin e qytetarëve aty privat, është që ajo zonë të shpronësohet, të bëhet hapësirë gjelbëruese.

Shefki Gashi:

Edhe unë komisionin e falënderoj për punën që ka bërë, se sigurisht ka pasur punë, mundime, ka pas telashe, se është një problem i cili ka marr disa përmasa. Njerëzit na kanë qëndrua mbi kokë 2-3 vite, po edhe këta i kanë problemet e veta. Unë besoj që atë variantin e dytë e përkrahën shumë prej njerëzve këtu në diskutim, le të kaloj ai varianti i dytë. Për atë që tha Qëndrimi, për kompensime sa kanë humb, është e vërtetë që nuk ka marr askush obligime për ato punë, kështu që këta le të procedojnë. Detajet tjera të urbanizmit me një projekt të përshtatshëm të mirë, të pashëm aty. E tash ju kush e mbani në mend, mos me i pas hekë këto objekte prej aty, ato kanë qenë qerpiç, të llomit, kiamet ndërtesash, prandaj tash mundet me u ndërtua një objekt i mirë aty që e shfrytëzojnë edhe këta, edhe Komuna, me qenë më solidare, a merr diçka Komuna a nuk merr, e merr atë pjesën gjelbëruese e qet përpara këtu, edhe ne jemi në interes, në favor të rritet gjelbërimi, edhe këta janë në favor si qytetarë të ndërtojnë një P+4 a sa është e mundshme aty me u ndërtuar.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Urdhëro, Ylli!

Ylli Hoxha: Para, është vendimi për rrënim, klikimi i Komunës në proces, nuk është gjë që duhet me u neglizhua në këtë debat. Fakti që pronarëve privatë iu paskan rrënuar objektet pa vendim, por me përfshirje të Institucionit komunal, është një gjë që duhet të përqendrohemi pak. Pra, si ka qenë e mundur që ekzekutivi i kaluar thotë po i hyjmë kësaj zone dhe po i rrënojmë, a vendim nuk kemi. Nuk kemi hapa procedural, kemi hap arbitrar në emër të institucionit të Komunës, i cili tash na bien në situatë me pasojat të cilat i kemi, dhe pasojat që po merremi me sa muaj. Pronarët janë para derës së Komunës, sepse dhe Komuna ka qenë e përfshirë në rrënim, por pa vendim. D.m.th. një relacion i çuditshëm i afarizmit, ndikimit të afarizmit në institucionin komunalë dhe buldozerit të përdorur nga Komuna. D.m.th. mendoj që kjo është situatë pa ligjësi, të cilën duhet me adresuar drejtpërdrejt në prokurori, me u marr pak me këtë punë, sepse nuk bënë kështu, nuk mund të vijmë në situatë të marrim përgjegjësi, të themi ngadalë se dikush e paska bë një krim e ne të paguajmë krimin 4 vite më pas. Krimi duhet të dënohet pikë së pari, në mënyrë që të mos përsëritet më tutje. Te çështja e dytë, unë mendoj që reflektimi në këtë debat realisht është i ndamë. Ka një aspiratë për zgjidhjen e parë, që t'i bindim që me marrëveshje qytetarët të barten në këtë pjesën e Komunës, ajo aspiratë nuk shkon me kundërshtimin e tyre, është mirë të provohet edhe një herë t'i bindim ata që të kalojnë në këtë pjesë. Çështja e dytë është, se çka do të ndërtohet në atë pikë, mendoj se duhet të jemi shumë më konkret. Nëse në diçka jam kundër, jam kundër realizimit të planit, projektit siç ka qenë i një godine të madhe pranë Kuvendit të Kosovës, sepse as nuk

përket me predispozitat arkitektonike, as me rregullat, as me asgjë tjetër. Po të kishte qenë plani rregullativ i mirë, profesional, nuk do të duhej ndërhyrja e Ministrisë së Kulturës, me thënë ngadalë se 50 m prej xhamisë nuk bëhet ndërtimi. Pse atëherë plani rregullativ nuk ka qenë konform ligjit, se ligji në bazë të një standardi është shkruar, nuk është shkruar ligji veç pse ju ka tek dikujt me bë. Nëse ka një objekt të trashëgimisë kulturore, ka qenë joprofesionale që në plan rregullativ të lejohet P+8 ai që e ka hartuar planin rregullativ . Kjo tregon që ne kemi përgjegjësi si Komunë, të flasim edhe një herë se çka mund të ndërtohet aty, nëse ndërtohet. Prandaj, zgjidhjen të cilën e bëni, mendoj se duhet ta keni konkrete dhe ta merrni parasysht edhe mundësinë e ndërrimit të planit në atë pjesë, në mënyrë që edhe ndërrimi, ndërtimi eventual i mundshëm, apo mos ndërtimi, të jetë vendim i cili aprovohet nga ky Kuvend komunal. Një pjesë e madhe e kuvendarëve janë të shqetësuar për mundësinë që aty të bëhet në bazë të planit rregullativ të kaluar, që të na bëhet një godinë ngufatëse, e cila e ka ngufatur qytetin anë e mbanë. Faleminderit!

Kryesuesi: Urdhëro, z. Ramabaja!

Sadri Ramabaja: Faleminderit, z. kryesues!

Unë prisja këtë reagim kështu, se në fakt, këtu kemi kujtesë institucionale. Kujtesa institucionale na dëshmon që unë jam ai, i cili kam votuar kundër atëherë, edhe prof. Mehdiu ka votuar kundër, edhe znj. Kimet ka votuar kundër, edhe një pjesë e mirë e PDK-së, nuk e di të gjithë a jo.

Çështja është që politika ka qenë e lidhur me biznesin dhe ai projekt i ardhur këtu me shkëlqim fanfarë tetëkatësh (P+8), me qelq, jo vetëm pronarëve, por edhe një pjesë këtu ua pati marrë mendjen, se po bëkan një qendër të madhe të biznesit me na e pas lakmi Ballkani! Ç' është e vërteta, këtu kemi të bëjmë me antihero, veprimin antihero, sepse në qendër të qytetit bëhet një akt krimi dhe miratohej prej këtij kuvendi. Tash jemi në situatën kur kemi mundësi, për fat të mirë, sepse qytetarët na kanë zgjedhur neve këtu, ta korrigjojnë këtë veprimin antihero dhe të sjellim dëshminë se kohët kanë nevojë për heronj të rinj. Shikoni, Linkoln amerikan nuk ka luftuar vetëm me pushkë, por edhe me vendime. Ne pak përpara morëm vendim për themelimin e shtatores të njërit prej krijuesve të shtetit shqiptar dhe patëm problem me lokacionin, sepse nuk është menduar absolut për një kryeqendër, qoftë edhe provinciale, siç mund të jetë nesër Republika e dytë e Kosovës në kuadër të një Federate shqiptare. A ka mundësi që kjo të rregullohet? Po, sepse, e tha edhe Qëndroni dhe disa diskutues të tjerë, që 20 - 30 vitet e ardhshme nuk i jepet një mundësi kaç reale që të ndahen të kënaqur, natyrisht edhe pronarët, por edhe qyteti. Unë e di që një pjesë këtu kanë luajtur vazhdimisht me emocionet e qytetarëve, pronarëve etj., por atë çka e tha prof. Mehdiu, edhe pronarët do të ishin jashtëzakonisht të kënaqur që të shpërblehen konform zemërgjerësisë së Ministrisë, por edhe ne këtu nuk do të ishim më koprrac, përkundrazi, që ata në fakt ta vërejnë mirë se kanë qenë të mashtruar. Nuk po e bëjmë këtë destinim për një park në qendër të qytetit për inat të tyre, por për të mirën e tyre dhe fëmijëve të tyre. Unë jam për variantin e tretë, madje do të ishte mirë që të analizohet jashtëzakonisht me seriozitet, sepse kemi një rast që nuk na përsëritet shpesh.

Faleminderit!

Flamur Shala: Unë kërkoj falje që është vonë tash, por po duhet ndonjëherë kështu “Ad hock”, po të bie ta marrësh fjalën, sepse dëgjon ndonjëherë fjalë që janë në s’ përputhje njëra me tjetrën prej të njëjtit folës, sipas mendimit tim. Pa dyshim që ne e përkrahim, atë që e tha në emër të grupit z. Mustaf Krasniqi, se duhet të merret parasysh ajo me të cilën pajtohen qytetarët dhe mbi bazën e planit rregullues. Këto dy elemente janë të rëndësishme për ne. E dyta, këtu po thuhet se e paska marr dikush një vendim të mundshëm që nuk po mund të gjendet për t’u rrënuar ato. A keni hulumtuar ku është ai vendim; nëse nuk është ai vendim, kush i paska rrënuar? Është koha t’i thoni me emër dhe mbiemër. Ne jemi 18 anëtarë të LDK-së në Asamble dhe unë nuk e di as kush i ka rrënuar, as kush e ka marr atë vendim të pashkruar për rrënim! Ju lutem! Nëse ju doni t’i qoni gjërat deri në fund, thoni kush e ka rrënuar, dhe ta kryejmë më e të mos merremi me atë punë, sepse është interes. E dyta, nuk besoj kurrë që ai rrënim është bërë pa pëlqimin e qytetarëve që janë aty, sepse ata e kanë parë interesin e tyre. Po përmendet ndërtesa 8 katëshe, pa apostrofuat se kush po e përmend, nëse e lejon plani rregullues mbi bazat e normave të ligjeve, le të bëhet edhe 8, edhe 4, edhe 2, aq sa e lejon plani. Por, këtu lë të dyshohet, “iu ngjit për fyti” këtij projekti që në fillim, mos po dyshojmë tash edhe ne se diçka po ndodh me atë projekt?! Po dyshojmë! E sa i përket citateve çka thotë Linkholni, vërtetë ai thotë shumë, të shohim se njerëzit i kanë vështirësitë e njëjta, ai thotë: “ Po jepu veç pak pushtet, dhe e sheh se kush janë ata! “

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Unë po shoh se në bazë të diskutimeve, kështu kemi pas para 7-8 muajsh. Ekzekutivi e ka sjellë këtë informatë në tri variante. E jona është që njërin prej këtyre varianteve parimisht të përcaktohem, ose t’ia lëmë ekzekutivit ta mendon mirë për cilën variant përcaktohet dhe të na sjell në mbledhjen e ardhshme. Por, në mbledhjen e ardhshme, e jo pa kufi me na shkua 5-6 muaj.

Ky është diskutim i imi, kështu që jemi Komunë, ne duhet me u gjet zgjidhje qytetarëve. Urdhëro, Kryetar!

Shpend Ahmeti: Vendimi është marr prej drejtorit të Inspektionit, z. Muhamet Gashi, së paku ashtu kemi dëgjuar ne, por pasi nuk ka vendim të shkruar, nuk e di kush e ka marr, por bagerat e Inspektoriatit e kanë rrëzuar. Qe, Samiu ku po e konfirmon, tash ndalu se e bëre pyetjen. Ai vendim, z. Flamur, nuk ekziston. Nuk e kanë as pronarët, nuk është as në Komunë. Po mirë, atëherë, kush i ka rrëzua ato, apo është veç synimi me ngritë dyshime. E ka rrëzua Komuna, z. Flamur, Komuna e Prishtinës. Pse? Se ua ka prezantuar në zyrë Isa Mustafa, ngjit me zyrën e Kryetarit, është një vend ku ka projektor. Familjarët tregojnë që kanë ardhur aty, u ardhur Kryetari, Isa Mustafa, dhe ju ka thënë ky është projekti 8 katësh, kjo është, atë ta konfirmon secili prej tyre me i pyet personalisht. D.m.th. ju ka prezantuar një projekt dhe u bë rrënimi pa ua dhënë lejen e rrënimit, pa marr vendim për rrënim. Nëse doni, e qojmë edhe në prokurori, e shohim kush e ka rrëzua, nuk është ndonjë problem ai, shumë lehtë mundemi me e qu në prokurori dhe e shohim kush e ka

rrënuar. Në momentin kur e dërgojmë në prokurori, u kry ky muhabet. Ne hyjmë në shpronësim, çka mundemi me shpronësua, por ta keni parasysh me atë tokë që e kanë këta pronarë dhe vendet ku e kanë me plan rregullativ, këta s'kunden me ndërdua as 1000 m². Në rregull, unë jam për. Unë veç ju kërkova këshillë që të shohim si t'ia bëjmë, nëse edhe ju jeni ashtu, ne hyjmë në shpronësim. I kemi dy familje, të cilët kanë qenë me marrëveshje të shfrytëzimit të Komunës, nuk kanë qenë pronarë, edhe atyre ju është rrënuar, kanë qenë para përfitimit të së drejtës që të jenë pronarë. Me ata nuk e di çka ndodh, se ata në shpronësim nuk hyjnë, sepse nuk figurojnë në prona askund, pra i dëmtojmë edhe dy familje të tjera. Por, ky është proces, unë me gjithë dëshirë shkoj në këtë proces, kjo është më e lehta për ne, do të jetë e dhimbshme për pronarët, por do t'i shkojmë kësaj deri në fund dhe e gjejmë saktësisht kush është përgjegjës, pse ka ndodhur kjo, me ligj e bëjmë, nuk ju bëjmë zgjidhje. Ne shkojmë me opsionin tonë me bë park, ne duhet me i shpronësua aty 20 ari, Visar, nëse nuk jam gabim, 20 ari të cilat na vlerëson Ministria e Financave me vendim të shpronësimit, e shpallim zonë të interesit publik dhe, pastaj i paguajmë të gjithë për kundërvlerën që e kanë. Unë e thash, Ministria e Financave është shumë fer në shpronësim. Në të njëjtën kohë, palët nëse mendojnë që kanë qenë të dëmtuara, munden me na paditur si Komunë dhe e bartim përgjegjësinë institucionalisht si Komunë, por le t'i ndjekim edhe penalisht, apo kriminalisht edhe individët të cilët kanë qenë të përfshirë në këtë vendim.

Kryesuesi: Faleminderit!

Urdhëro, z. Muhamet!

Muhamet Selmani: Këtu po flitet se ekziston një plan urban, i cili e ka të paraparë një formë të caktuar për atë parcelë, nëse nuk gaboj. A ekziston ai plan, apo nuk ekziston? Në rregull, nëse ekziston plani, ose duhet ta sjellim një vendim në këtë Kuvend që ta ndryshojmë atë plan dhe të bllokojmë çdo ndërtim aty, ose duhet të bëjmë një zgjidhje t'i lejojmë njerëzit. Në rregull, Kryetar, atëherë ne duhet të ndryshojmë atë plan. Faleminderit!

Liburn Aliu: Me Planin rregullues "Dodona", është koeficient jashtëzakonisht i lartë. Me plan zhvillimor urban që u miratua vitin e kaluar, është koeficient më i ulët, është ndërtim i mesëm. Por, si në rastin e parë, si të dytin, për parcela veç e veç nuk mund të japim leje, duhet të bëhet një zgjidhje urbane, duhet pronarët e tokave të merren vesh mes veti për me pas mundësi me u bë një zgjidhje urbane. Këtu pronare po ashtu është edhe Komuna. Nuk mund të bëhet ajo marrëveshje pa Komunën, në këtë rast, prandaj në këtë situatë jemi në pozitën ku si Komunë vendosim çka po bëjmë. Është shumë thjesht, nëse vendoset që Komuna hynë në marrëveshje me pronarët dhe vendoset të ndërtohet aty, për mua nuk është problem ajo punë, procedohet mandej. Ideja është që këtu të merret vendim, a po merret vesh Komuna me pronarët dhe po ndërtohet diçka, a po i shpronëson pronat e tjera së bashku me pronën e Komunës dhe po i bëjmë park, shesh. Ismail Qemailin mundemi aty me e vendos, pasi e përmendët, po e ndërliidhi ashtu. Të gjitha këto janë çështje që këtu mund t'i vendosim, pa u involvuar Kuvendi është e

pamundur. Nuk ka mundur Drejtoria me e krye vet, është e pamundur pa u involvuar Kuvendi, pa hy prona e Komunës në marrëveshje, nuk ka përfundim.

Kryesuesi: Faleminderit!
Urdhëro, Qëndron!

Qëndron Kastrati: Atëherë, unë ju kisha drejtuar Drejtorit të Pronës ose cilitdo. Po mendojë që hapi i parë që kishim mundur me bë, është me u interesuar për vlerën financiare sa përafërsisht na bien me kompensuar atë vlerë dhe me ardhur në mbledhjen e ardhshme, me gjykuar në bazë të vlerës financiare. Sa kishte kushtuar shpronësimi edhe i pronave, edhe i objekteve që kanë qenë me leje, me marr vendimin a kish mundur Komuna me përballuar barrën me bë hapësirë gjelbëruese.

Kryesuesi: Faleminderit!
Urdhëro, z. Islam!

Islam Pacolli: Ndoshta nuk kam folur sot shumë.
Unë mendoj që edhe unë pajtohem të bëhet një rivlerësim i asaj dhe ekzekutivi në këtë rast, Kryetari i Komunës, të na jep një propozim se a do me u kthye gjelbërim, apo do ndërtimin publiko-privat.
Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!
Urdhëro, z. Sylejman!

Sylejman Pireva: Unë, e dini, nuk i zgjati shumë diskutimet dhe nuk dua të jem i mërzitshëm asnjëherë. I respektoj jashtëzakonisht shumë pronarët, të cilët i kemi këtu, dhe i përshëndes! Konsideroj dhe ma merr mendja që herët apo vonë, koha do më jep të drejtë, shpronësimi sot mund të jetë i shtrenjtë, pas 10 - 20 viteve mund të jetë i lirë. Zgjidhja e këtyre pronarëve sot mund të duket jo joshëse, por në të ardhmen, për fëmijët e tyre, do të jetë shumë më mirë sesa në këtë ngufatje, ku mendohet me aq ari të bëhet ndonjë zgjidhje. Kaq.

Kryesuesi: Faleminderit!
Mendoj që kjo çështje t'i kthehet edhe një herë ekzekutivit, përkatësisht, më së shumti drejtorit të Urbanizmit, në pajtim me qytetarët të cilëve u është rrënuar ndërtesa. Për mbledhjen e ardhshme, përcaktohen saktë për njërën prej varianteve, pastaj e voton, apo jo Kuvendi, është çështje tjetër. Kryesisht ekzekutivi, duke marr parasysh Planin rregullues dhe ne të votojmë.
Faleminderit edhe prej qytetarëve, të cilët i kemi këtu prezent dhe kanë dëgjuar. D.m.th. kjo çështje i ka mbetur edhe një herë ekzekutivit ta sqaron mirë dhe ta sjellë në mbledhjen e ardhshme, t'i prezantojë këtij Kuvendi dhe t'i miratojmë ose jo.
Faleminderit shumë lidhur me këtë pikë. Mendoj që ky është një konkluzion lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Pika e trembëdhjetë e rendit të ditës:

Informatë për fillimin e procesit edukativo-arsimor 2014 - 2015

Kryesuesi: E kemi Informatën për fillimin e procesit të mësimi edukativo-arsimor 2014-2015.

Një informatë me shkrim e keni, sigurisht edhe drejtoresha, në pika të shkurta, do ta arsyeton këtë.

Urdhëro, drejtoreshë!

Arbërie Nagavci: Faleminderit, kryesues!

Meqenëse e keni një pjesë të materialit me shkrim, unë do të mundohem që ky prezantim i imi të mos jetë shumë i gjatë. Ashtu sikurse jeni të njoftuar, Drejtorja e Arsimit, gjatë këtij tremujori, ka zhvilluar aktivitetet sipas planit të paraparë, duke u mbështetur në pesë objektiva bazike. Meqenëse për suksesin kemi diskutuar në mbledhjen e kaluar dhe kemi thënë se ai sukses është një rezultat ekzistues, pra raporti ynë është bazuar në të dhëna që i kanë prezantuar shkollat. Unë sot do të vazhdoj dhe i keni një mënyrë të përmbledhur, të dhëna statistikore në raport, nuk do t'i përsërisë sot edhe njëherë. Nëse keni ndonjë pyetje ose çështje që dëshironi ta diskutoni në lidhje me suksesin e arritur në përfundim të vitit të kaluar shkollor, mund të përgjigjem pastaj në pyetje. Do t'ju flas shkurt edhe për fillimet e aktivitetet që i kemi realizuar në fillim të këtij viti shkollor 2014-2015. Fillimisht, po prezantoj planifikimin për regjistrimin e nxënësve në klasë të parë dhe të dhjetë, ku ishin planifikuar të regjistrohen 3581 nxënës në klasën e parë dhe ky planifikim është realizuar tërësisht. Nëse e shohim mesataren e nxënësve në klasat e para, kemi 25 nxënës. E di se kemi pasur diskutime në lidhje me numrin e nxënësve në klasa dhe e kam shpjeguar edhe herën e kaluar se kjo ka të bëjë, në këtë fazë ku jemi, me pjesët që ndoshta janë të mbipopulluara me qytetarë dhe banorë që frekuentojnë afër atyre shkollave. Por, për më tepër, kemi planifikuar edhe vizita në shkolla dhe do të shohim sa është respektuar vendimi për regjistrim në klasë të para. Ndërsa, sa i përket regjistrimit në klasë të dhjeta, plani i regjistrimit është realizuar plotësisht në nëntë shkolla të kryeqytetit, ndërsa në tri shkolla, në "Shtjefën Gjeqov", "7 Shtatori" dhe "Abdyll Frashëri", regjistrimi është në përfundim e sipër, pasi që ka pas ende vende të lira. Sa i përket konkurseve që i kemi pasur të hapura, në konkursin e parë, konkursin e rregullt, kemi pas të hapura 49 pozita për vende të lira për mësimdhënës të niveleve të ndryshme dhe ky konkurs ka përfunduar plotësisht, me përjashtim të një pozite, ku nuk ka pasur kandidat të interesuar, për shkak se fjala është për një fshat më të largët, konkretisht në Marec, aty është përsëritur konkursi. Në panelet intervistuese kësaj here, për radhë të parë, është angazhuar edhe nga një ekspert profesionist kompetent, si pjesë e panelit, dhe përfaqësues i Drejtorisë së Arsimit. Të gjitha konkuset kanë qenë me një transparencë të plotë. Po ashtu kemi pasur edhe konkursin për 22 pozita për drejtorë dhe zëv. drejtorë në shkollat filllore dhe të mesme të komunës së Prishtinës. Dhe, në përfundim të këtij konkursi, kemi arritur të zgjedhim vetëm 2 drejtorë dhe 4 zëv. drejtorë, ndërsa pozitat tjera janë anuluar sipas vendimit të komisionit, për shkak se nuk ka pasur kandidatë që i kanë plotësuar kushtet. Në disa raste, edhe pse janë mbajtur intervistat, performanca nuk ka qenë e kënaqshme. Me rekomandimin e komisionit, këto konkurse janë anuluar dhe

do të rishpallen gjatë këtij muaji. Po ashtu, jemi tani në fazën e konkursit plotësues, ku kanë qenë të hapura 33 pozita, është bërë shpallja publike e të gjitha të dhënave të kandidatëve që kanë aplikuar, sot përfundon afati i ankesave dhe prej të hënës, do të jenë intervistat me gojë për personat të cilët janë zgjedhur në bazë të pikëve që kanë arritur sipas kriterëve. Edhe këtu e përsëris, për herë të parë ka qenë një respektim 100% i ligjit, dhe e them jo vetëm në komunën e Prishtinës, por në gjithë Republikën e Kosovës. Intervistat për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëv. drejtorëve janë bërë me përfshirjen e komunitetit dhe janë respektuar tërësisht kriteret e parapara. Sa i përket përmirësimit të infrastrukturës shkollore, për këtë fillim të vitit shkollor kemi intervenuar në 22 institucione arsimore, të të gjitha niveleve, dhe të gjitha punimet brenda objekteve shkollore janë realizuar sipas dinamikës dhe planifikimeve të parapara. Pra, procesi edukativo-arsimor në të gjitha shkollat e Komunës së Prishtinës ka filluar më 1 shtator, sipas kalendarit të vitit shkollor. Sfidë më të madhe për Drejtorinë tonë ka paraqitur vendimi i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për heqjen e klasëve të 13-ta, me ç' rast kemi rrezikuar që diku rreth 70 mësimdhënës të na mbesin pa punë. Pas një përpjekje bukur të madhe që e kemi bërë, edhe nga ana e vetë shkollave, por edhe nga ana e Drejtorisë, është arritur që të sistemohen pjesa më e madhe e tyre, aktualisht janë 3 mësimdhënës, të cilët nuk kanë arritur akoma të sistemohen në vende të punës. Karakteristikë për këtë vit është hapja e tri shkollave të reja dhe po ashtu, sikurse e dini, ka filluar edhe shpërndarja e shujtës për secilin nxënës të nivelit të parë të arsimit, një projekt që përfshin 17.216 nxënës, në 43 shkollat fillore të Prishtinës. Sa i përket sistemimit të mësimdhënësve, që kanë mbetur si tepricë teknologjike, ashtu siç i quante Ministria, Drejtoria e Arsimit ka filluar realizimin e vizitave speciale nga zyrtarët e Arsimit në të gjitha shkollat e Komunës së Prishtinës dhe verifikimit të dokumentacioneve dhe ndarjes së orëve. Kjo ka qenë për shkak se kemi pasur edhe mjaft ankesa dhe shkresa, dhe kemi dashur të dimë saktë para se të nënshkruajmë kontratat për të gjithë mësimdhënësit. Në bazë të vizitave të para, ju njoftoj që deri më tash kanë përfunduar vizitat në 12 shkollat e mesme të larta. Pas saj do të fillojmë edhe në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta. Këto vizita, më datë 24.09, i kemi filluar në të gjitha shkollat, vizitat kanë qenë, e them, qëllimi i parë ka qenë për të verifikuar në lidhje me mbetjen e tepricës teknologjike që është përcjellë pas vendimit të Ministrisë për heqjen e klasave të 13-ta dhe pas një dyshimi të bazuar të një mësimdhënësi, i cili që sa vite në Komunën e Prishtinës punon me diplomë të falsifikuar, pra ne kemi pasur dyshime të bazuara. Universiteti i Prishtinës nuk ka verifikuar se diploma e tij është e saktë dhe në momentin që ne kemi kërkuar me afat minimal, brenda tri dite me sjell diplomën e saktë, i njëjti nuk është paraqitur më në vendin e punës. Po flasim për mësimdhënës të gjuhës angleze, i cili për më shumë se 6 vite ka punuar në shkollat tona të mesme të larta. Pas kësaj, kemi filluar vizitën në të gjitha shkollat, kemi të dhënat e sakta për të gjithë, janë identifikuar të gjithë, por sot nuk do të përmendi emra. Pra, ajo që ne kemi vërejtur është se pjesa më e madhe e mësimdhënësve janë me përgatitje të lartë superiore, janë profesorë me tituj master dhe disa nga ta janë edhe me përgatitje profesionale bachelor të lëndës përkatëse. Por, ajo që është shqetësuese, është se në të gjitha institucionet e nivelit të tretë, gjegjësisht të shkollimit të mesëm të lartë, kemi edhe mësimdhënës të cilët kanë përfunduar studimet në Fakultetin e Edukimit, disa prej tyre kanë përfunduar studimin edhe në

kolegjet private. Mësimdhënësit të cilët kanë përfunduar studimet në Fakultetin e Edukimit, në kolegjet private, të cilët janë ligjërues në shkollat e mesme, edhe pse janë të evidentuar me emra në secilën shkollë, unë nuk do t'i prezantoj sot, ajo çfarë do të bëjmë është se secilës shkollë do t'u përgatisim një raport të detajuar për të gjitha shkollat, një raport përmbledhës të Drejtorisë së Arsimit, por po ashtu do të dërgojmë në secilën shkollë me rekomandime. Për informatën e juaj, unë do të ndaj sot me ju atë që e përmendëm, d.m.th. ka mësimdhënës që nuk i kanë përgatitjet profesionale të duhura për të ligjëruar në shkollën e mesme të lartë, sipas Ligjit të arsimit të lartë, Ligjit parauniversitar dhe të Udhëzimit administrativ. Janë gjithsej 29 mësimdhënës me përgatitje profesionale bachelor të lëndëve përkatëse, ku sipas ligjeve të Republikës së Kosovës dhe Udhëzimit administrativ për normativin mbi kuadrot profesionale, nr. 9/2014, të gjithë mësimdhënësit të cilët kanë ushtruar veprimtarinë edukativo- arsimore më shumë se 3 vite me kualifikim që nuk parashihet me këtë udhëzim, obligohen që të vazhdojnë avancimin profesional pa shkëputje nga puna. Pra, janë 29 mësimdhënës, të cilët nuk konsiderohen si adekuat, por të cilët kanë të drejtë të vazhdojnë shkollimin pa shkëputje nga puna. Por, po ashtu, janë duke ligjëruar gjithsej 19 mësimdhënës, të cilët kanë përfunduar fakultetin e Edukimit e që, sipas ligjit në fuqi, konsiderohen po ashtu të pakualifikuar. Ajo që është edhe më shqetësuese, është se janë duke punuar 19 mësimdhënës, të cilët kanë përfunduar studimet në kolegjet private, sipas Ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, neni 16, për grada dhe diploma, pika 5, potencohet se vetëm bartësit publik të arsimit të lartë mund të ofrojnë programe studimi që qojnë në kualifikimin e një mësimdhënësi për të punuar në një shkollë. Kemi evidentuar edhe rastet të cilat kanë më pak se 3 vite përvojë pune, sepse në të gjitha rastet që kanë më pak se 3 vite përvojë pune, do të duhej që nga drejtorët e shkollës të njëjtit të ishin lajmëruar dhe të njëjtëve t'u ishte shpallur vendi i lirë i punës. Kemi gjithsej 9 mësimdhënës, të cilët kanë më pak se 3 vite përvojë pune dhe të cilët nuk janë lajmëruar nga drejtorë të shkollave. Këta mësimdhënës punojnë 3 prej tyre në shkollën "28 Nëntori", 4 në shkollën "Hoxhë Kadri Prishtina", 1 në shkollën "Abdyl Frashëri" dhe 1 në gjimnazin "Sami Frashëri". Këta mësimdhënës, ndoshta është në interesin e juaj për të theksuar se, 5 prej tyre, ajo që është edhe më shqetësuese, është se për këta 9 mësimdhënës nuk kemi gjetur evidencë se janë pranuar me konkurs të rregullt, 5 prej tyre janë pranuar me rekomandim, d.m.th. një formë të cilën ligji nuk e njeh, nuk ka pasur konkurs publik, janë pranuar me rekomandim, thjesht, janë udhëzuar që të shkojnë nëpër shkollat përkatëse 5 prej tyre, ndërsa 4 prej tyre nuk ka kurrfarë dokumentacioni se si ata kanë filluar punën. Shkollat nuk kanë ofruar ndonjë dokumentacion të tillë. Në Drejtorinë e Arsimit nuk kemi gjetur kurrfarë të dhënash nga zyrtarët tanë, nuk ka d.m.th. ndonjë dokumentacion dhe askush nuk i është përgjigjur pyetjes se si, në çfarë forme kanë ardhur, sepse nuk kemi të dhëna. Ajo që ne planifikojmë të bëjmë në këtë drejtim, është që të kërkojmë nga vetë mësimdhënësit edhe një herë me shkrim, pas këtij raporti që do të dërgojmë në shkolla, për mënyrën e punësimit të tyre, dhe do të vazhdojmë me vizitat edhe në shkollat e mesme të ulëta dhe në shkollat fillore. Po ashtu, unë do të doja, para se të përfundoj këtë prezantim, t'ju ofroj juve mundësinë që të më pyesin për gjithçka që mund të jetë në interes për ju, t'ju pyes edhe për një rregullore për arsimin, meqenëse këtu kemi njohës dhe unë ju kam përcjell me vëmendje, e di se jeni të interesuar për

mbarëvajtjen e procesit arsimor, kemi edhe ish-drejtorët këtu, një rregullore të punës, e cila do të duhej të rregullonte procesin edukativo - arsimor, e kanë në shumicën e komunave. Në Komunën e Prishtinës, në kryeqytetin e Republikës së Kosovës, unë kam kërkuar një rregullore, e cila do të duhej të ishte aprovuar në Asambleenë komunale dhe e cila do të rregullonte punën e mësimdhënësve, të drejtorëve dhe gjithë procesit edukativo - arsimor. Shefi i Arsimit më ka thënë që nuk ka njohuri për një rregullore të tillë. E kam kërkuar në mbledhjen zyrtare, në mënyrë zyrtare tek të gjithë punëtorët e Drejtorisë së Arsimit, askush nuk më ka njoftuar se ekziston një gjë e tillë. E kam kërkuar në të gjitha mbledhjet me drejtorë, në formë zyrtare, dhe nuk kam hasur në rregullore të tillë dhe po ashtu e kam kërkuar edhe zyrtarisht nga zyrtarja këtu e Kuvendit, që të më gjejë çfarëdo rregullore që ka rregulluar punën. Kështu që ju kisha lutur që, nëse keni diçka të tillë, do të na ndihmonte në punën tonë, sepse edhe Drejtorët në shkolla, edhe mësimdhënësit, po edhe zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit, shpesh herë në këtë periudhë sa unë kam qenë, nuk e dinin shumë se ku duhet të thirreshin dhe në bazë të kujt duhet të adresojnë zgjidhjen e problemeve dhe sfidave me të cilat janë ballafaquar.

Faleminderit për vëmendjen tuaj! Nëse keni çfarëdo pyetje, jam e gatshme të përgjigjem.

Kryesuesi :

Faleminderit!

Urdhëro, Ylli!

Ylli Hoxha: Në mbledhjen e kaluar kemi diskutuar që cilësia e Arsimit të diskutohet në mënyrë të veçantë. Nga Këshilli i Drejtorëve na është dhënë informacioni se do ta diskutojmë në seancën e ardhshme, prandaj do t'i lusja asamblistët që të kufizohen prej debatit për cilësinë, sepse do ta kemi në mbledhjen e ardhshme. Mund të diskutojmë për përmbajtjen e raportit, si na është dhënë, vetëm ky intervenim.

Faleminderit!

Agim Gashi: Faleminderit!

Ta quaj, kushtimisht, pjesa e dytë e referimit të drejtoreshës, nuk përputhet me materialin që e kemi, sepse në materialin që ne kemi marr, nuk janë përfshirë këto të dhëna, së paku unë që e kam një material kështu është, ndërsa këto informata shtesë, mendoj se e plotësojnë atë pjesën e parë që ne e kemi pas në formë të shkruar. Po nisem prej fundit. Lidhur me një rregullore, që drejtoresha po e quan rregullore, po që po e gjithë përfshin sferën e arsimit. Në fushën e arsimit veprojnë shumë rregullore, sipas specifikave, sipas llojeve të institucioneve dhe natyrës që ato e trajtojnë. Bazuar në udhëzimet administrative, përkatësisht ligjeve përkatëse që e rregullojnë fushën e arsimit, ka shumë rregullore. Tash nuk mundemi t'i numërojmë këtu, por ato rregullore Drejtoria duhet t'i nxjerrë dhe ta dijë se me cilat rregullore operojnë shkollat tona në komunën e Prishtinës. Ka edhe të tjera, të cilat ende nuk janë shtruar para Kuvendit, sepse nuk ka qenë e mundur, në kohë të caktuara nuk ka qenë e mundur që ato të nxirren ose përgatiten, ose nuk janë përgatitur. Megjithatë, njëra nga domosdoshmëritë që e përcjellin Komunën, është edhe ushtrimi i përgjegjësisë dhe avancimi i arsimit cilësor parauniversitar. Në këtë aspekt, Komuna e Prishtinës ka miratuar Planin zhvillimor të arsimit 2013 – 2017, si

dokument bazë dhe orientues zhvillimor. Në kontest të kësaj, ne presim që prej viti në vit të vazhdojnë ndryshimet pozitive dhe të krijohen kushte sa më të volitshme për fëmijë dhe nxënës të komunës së Prishtinës, konform kompetencave dhe përgjegjësi që ka Komuna. Po ashtu, ne sot kemi në duart tona informatën e përgatitur nga Drejtoria e Arsimit, për fillimin e vitit 2014-2015. Tash edhe drejtoresha e tha se kjo informatë përfshin nja 5 informata bazë, por tash do të bëj përpjekje që t'i kompletojë ato çka unë mendoj, dhe grupi im parlamentar mendon se nuk janë dhënë të plotë. Pjesa e parë, flet për statistikën e regjistrimit të nxënësve. Unë ju kisha lutur që në material, aty thotë: “U planifikua regjistrimi i 3581 nxënësve në klasën e parë”, kjo nuk mund të planifikohet, sepse asnjë statistikë nuk na ofron neve se sa nxënës e mbushin moshën, për me mund me planifikuar, por do të thoshim, këtu po bëjmë pak tolerancë kësaj radhe, do të thoshim: “U regjistruan...” dhe ajo që u regjistrua, nënkupton edhe planifikimin. Çështje teknike, por që unë mendoj se është me rëndësi. E dyta, informata na ofron statistikë jo të plotë të regjistrimit të nxënësve të nivelit të ndryshëm, nuk ka të dhëna për institucione parashkollore, se sa fëmijë janë regjistruar në institucionet tona parashkollore në këtë vit. Pastaj, në moshën 5-vjeçare, që është një kategori tjetër, që po ashtu i nënshton procesit të regjistrimit nëpër institucionet parashkollore, sepse ata një pjesë që janë nëpër institucione parashkollore mbesin aty, ndërsa të tjerët kanë të drejtë të regjistrohen nëpër institucionet e shkollave fillore. Do të ishte mirë, në të ardhmen, e kam thënë më duket edhe në pjesën e analizës së suksesit, se një kategori e fëmijëve që kërkon një vëmendje të veçantë, me një përkushtim të veçantë, është kategoria me pengesa në zhvillim, që integrohet me paralelet e rregullta dhe, vetëm sa për informacion, se a po zhvillohet ai aktivitet në shkollat tona dhe se Komuna a ka arritur t'i përmbushë obligimet ligjore që i ka ndaj atyre fëmijëve dhe mësuesve që punojnë në ato paralele. Për arsye se Komuna në ato paralele është e obliguar të angazhojë asistentet, se është e pamundur një mësues të punojë në mënyrë cilësore kur ka në mesin e nxënësve fëmijë me pengesa në zhvillim, varësisht nga shkalla e pengesës në zhvillim. Pastaj, është një dukuri tjetër, që në shkollat e Prishtinës është prezente kaheerë, për shkak të ndryshimit të shtrirjes së popullsisë, sidomos në zonat rurale, ku kemi paralele të kombinuara, dhe do të ishte mirë që në informatë ta kemi se sa paralele janë formuar me pak nxënës, ose me principin e paraleleve të kombinuara, sepse po ashtu këtu bie një barrë mbi Drejtorinë, mbi Komunën edhe në aspektin financiar, edhe në aspektet e tjera, sepse ka raste kur për shkak të largësisë, Komuna është e obliguar të sigurojë transportin, apo të sigurojë mësuesin adekuat, sepse secili mësues nuk mund, nuk është i përgatitur të punojë me paralele të kombinuara. Pra, këto në një mënyrë do ta kompletin informatën, do ta bënin sa më të plotë. Nuk ka informatë të plotë për regjistrim të nxënësve nga Komuna e Prishtinës në Gjymnazin Matematikor. Ajo është një paralele, mendoj që përfshin nxënës edhe nga komunat tjera. Ne duhet ta dimë sa nxënës të Prishtinës janë aty, sa të komunave të tjera, sa është zgjidhur statusi i tyre, a do të bëjnë jetën e konviktit apo ende nuk është zgjidh, a është pajisur shkolla si një gjymnaz, sa vite u bënë, 30 e kusur vite, iu kthye prapë qytetit, që është një shkollë me karakteristika të veçanta, kërkon mjete të veçanta të punës, sistem dhe kritere të veçanta të punës. Së fundi, përsëri nuk ka informata për regjistrimin e nxënësve në institucionet edukativo-arsimore private, po e harrojmë këtë kategori. Pse Komuna nuk është drejtpërdrejtë monitoruese e këtyre

institucioneve? Në një mënyrë, ka përgjegjësi ligjore, morale, për shkak se analizon gjendjen e shkollimit të të gjitha moshave në territorin e vet dhe pa e ditë atë statistikë, nuk mund të konstatojmë se ne nuk i kemi 300 nxënës, 200 nxënës të cilët nuk e vijnë shkollën, sepse në qoftë se do ta kishim statistikën nga Enti Statistikor, do të na dilte se shkollat publike përfshijnë kaç % të nxënësve, ndërsa pjesa tjetër nuk dihet ku janë. Po të ishte ajo statistikë, do të konstatohej shtrirja gjeografia shkollore, llojet e shkollave a janë publike apo private, tipet e shkollave etj. Pra, këto janë gjëra që do të ndihmonin edhe në planifikimin e politikave arsimore të Komunës për të ardhmen. Sa i përket çështjeve tjera, sidomos konkurseve, kisha preferuar që të mos bëhet shumë zhurmë për konkurse, për arsye se është punë e përditshme e administratës komunale. Mua më vjen mirë në qoftë se evitohen problemet, pengesat, por një gjë duhet ta keni parasysh se prej viti në vit, gjendjet ndryshojnë, nuk është sikur sot, sikur para 10 vitesh, sikur para 5 vitesh, sikur para 15 vitesh. As nuk është gjendja në konkurrencë, as në cilësi, as në sasi. Mua më vjen mirë që sot është shtuar numri i konkurrencës edhe në aspektin cilësor dhe ka mundësi të zgjidhen. Problemet tjera që janë për arsye teknike, i zgjidh Drejtoria, në bashkëpunim me institucionet e veta, por duhet të kihet parasysh se aty i bie një barrë funksionale Drejtorisë, për shkak të lëvizjes së madhe dhe nevojave që institucionet paraqesin, Drejtoria ka me qenë e obliguar ndoshta çdo muaj me shpall konkurs dhe nuk guxon Drejtoria të kryejë vonesa në zgjidhjen e konkurseve, se çka ndodh me konkursin e rregullt, nuk kisha dëshiruar më të ndodh ajo gjë, sepse në shkolla paraqiten problemet dhe vije deri tek humbjet e orëve mësimore. Çështje teknike, por janë shumë me rëndësi. Sa i përket përgatitjeve të objekteve shkollore, që është plotësisht kompetencë e Drejtorisë, duhet të kihet parasysh planifikimi, përkatësisht përshkrimi i punëve teknike me intervenim të renovimit të objekteve, duhet të bëhet në fund të këtij viti për vitin e ardhshëm, në mënyrë që në aspektin e prokurimit, të arrihet që me kohë të dërgohen paramasat, projektet të shpallen me kohë dhe të zihet hapi, që gjatë sezonit veror të kryhen mundësisht ato renovime dhe ndërhyrje tjera teknike, për shkak se sot të punohet në renovimin e objektit është problem edhe për Drejtorinë, edhe për institucionin e shkollës, edhe për cilësinë e mësimin. Po ashtu, e njëjta politikë duhet të zbatohet edhe në furnizime. Edhe në furnizime duhet të kihet parasysh, pavarësisht për çfarë furnizime bëhet fjalë. Ne e dimë se është bërë furnizimi me tekste shkollore. Edhe pse është kompetencë e autoritetit qendror, Komuna i ka kryer obligimet e veta, por duhet të bëhet furnizimi me mjete mësimore, me inventar plotësues, sepse është shkalla e amortizimit vjetor në përqindje të inventarit dhe duhet të kryhen me kohë, por do të kihet parasysh në politikat e prokurimit, në mënyrë që të zihet hapi e mos të hidhet faji jo këndeje, jo andej. Është një punë shumë e komplikuar edhe në aspektin e madhësisë, shumë e madhe. Unë po e përfundoj, por ne e dimë që Komunën kanë me e përcjell sfida në fushën e arsimit dhe duhet të ndihmojmë të gjithë në këtë aspekt. Posaçërisht, Drejtorisë i mungojnë kapacitetet kadrovike, na kanë munguar edhe përpara, por edhe sot i mungojnë, prandaj duhet ta përkrahni Drejtorinë që të shtojë numrin e të punësuarve profesionalë, sipas nevojave dhe fushave të ndryshme, në mënyrë që të stabilizohet kjo gjë.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, Agim!

Fjalën e ka, Hatixhe Pupovci.

Hatixhe Pupovci: Pasi veç e keni mbajtur mend që e kërkova fjalën, edhe pse u tërhoqa njëherë, po e marr prapë. Për mua është e papranueshme, gjegjësisht mendoj që patjetër Drejtoria e Arsimit duhet të ndërmerren hapa për largimin e personave, të cilët janë pa diploma të punësuar dhe për personat të ndërmerren masat ndaj atyre që i kanë pranuar ata persona, në çfarë do forma qofshin ato, me angazhime ose në forma të tjera. Meqenëse unë mendoj që sfera e arsimit është më e rëndësishmja, për mendimin tim, këtu nuk kish dashtë me pas kompromis me askënd, fare, kështu që patjetër duhet të fillohet me largimin e njerëzve, të cilët nuk janë në komitet, për arsye se ata na reflektohen me dobësi në sistemin arsimor në Komunë.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Urdhëro, Kimete Zeqa!

Kimete Zeqa: Faleminderit, Kryesues!

E përgëzoj drejtoreshën! Të dhëna të mjaftueshme dhe sfida mjaft të mëdha, por mua po më pengon, edhe pse nuk i përkas Arsimit, por Shëndetësisë, mua më dhemb më së shumti pse si tepricë teknologjike, edhe pse ndoshta Ministria e Arsimit këtë e ka paraparë, por pse me qenë vetëm femra të pa sistemuara, Nazmije Kadriu, Bedrije Gashi, Hikmete Blakqori. A vetëm femra kanë qenë të punësuar në këto shkolla?!

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Urdhëro, Qëndron!

Qëndron Kastrati: Faleminderit, drejtoreshë!

Unë, shumë shkurt, nuk po e zgjati, vetëm po më intereson një problem që e kanë shfaq, që e kam dëgjuar prej qytetarëve të fshatrave të Gollakut dhe fshatrave të tjera në lidhje me klasat e kombinuara. Kam dëgjuar që ka klasë, ku klasa e parë dhe klasa e tretë bashkarish e mbajnë mësimin. Dhe, shqetësimi tjetër, në raport me ato zona, është për çështjen ku ka klasë me nga 3, 4, 5 nxënës, mbahet proces mësimor. A kish pas mundësi të metodave të kombinimit të shkollave nëpër fshatra, ku nuk po më duket problem i madh me rregulluar çështjen e transportit.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Urdhëro, Flamur!

Pas Flamurit, Kreshniku.

Flamur Shala: Faleminderit!

E përshëndes drejtoreshën për këtë paraqitje të saj.

Në këtë informatë edhe pse janë dhënë disa të dhëna të favorshme, normalisht, si informacion për ne, nuk e shoh të jetë thënë diçka për arsimin parashkollor dhe, pa e zgjatur, sidomos për ato institucione parashkollore me bazë nga komuniteti, se si po

Faqe 89 nga 100

shkon puna në to, meqenëse është viti i parë i një qasje të Komunës, përkatësisht i Drejtorisë lidhur me ato institucione. Normalisht, ne kemi mendimin tonë lidhur me to, sepse kemi thënë disa herë, nuk ka bazë të mirëfilltë ligjore për të procesuar me këto institucione, së paku mungon diçka nga ligjet që nuk lejon të shkohet deri në fund me këto institucione, të favorshme shumë, normalisht. Tjetër, si një këshilltar pjesë e Kuvendit të Komunës, që jam marr edhe vetë me arsim, nuk kisha dashtë që shumëçka të kuptohet në arsim të jetë në formë fushate. Nuk është mirë në arsim të reflektojë asnjëri, qoftë drejtoresha, drejtori, kushdo qoftë, që të ketë fushatë, sepse janë ligjet që rregullojnë fushën e arsimit, edhe nëse nuk janë të gjitha të kompletuara me udhëzime administrative etj, janë, megjithatë dhe janë të mjaftueshme për të ecur normalisht në arsim pa fushatë. Tjetra, sa i takon konkursit dhe realizimit të konkursit për mësimdhënës, drejtorë dhe zëvendësdrejtorë, nuk mendoj që është ligjore t'i bëhen këtu, përveç panelit atje, komisionit, me të drejtë të asaj votës që i themi ne për një për zgjedhje të një kandidati për drejtor, sidomos, ose për zëvendësdrejtor, udhëheqës arsimor, që t'i bënë këtu edhe 50, 100 njerëz, dhe ka raste kur njerëzit thonë se drejtuesja e Arsimit ose drejtoresha, nuk e di a është e vërtetë kjo, i pyet ata të gjithë a jeni ju për këtë, apo për cilin jeni. D.m.th. nuk është mirë që të bastardohet ky proces në këso forme, dhe nuk është mirë që nga 22 drejtorë të zgjidhen vetëm 2, eventualisht 4 me zv. drejtorë gjithsej 6, e 16 të anulohen. Nuk është mirë për ne si shoqëri, sepse nuk do të mund të krijojmë ne drejtorë dhe të ndërtojmë kapacitete udhëheqëse as për një muaj, as për dy, as për tre. Pra, mua më duket se është e kotë që ai konkurs është anuluar, sepse nuk do të kemi kuadro si këto që i kemi, sado që është e mirë nisma, edhe pse ka qenë edhe më përpara që të trajnohen njerëzit e interesuar për udhëheqje arsimore. D.m.th. t'i kryejnë ato programe që ua ofron sistemi, ua ofron Ministria, një punë asistence sigurisht e bënë edhe Komuna e Prishtinës. Nuk po dua ta zgjasë krejt këtë, por po dua të them që të mos reflektoni në fushatë, të mos kuptohet që ju si eksponentë politikë, po ju drejtohem juve drejtoreshë, se nuk kam pas rastin të komunikojë kështu, të mos reflektohet, bile më së paku tek ju duhet të reflektohet ajo si një eksponente politike që ke ardhur nga një qendër, diku atje si kandidate, tash të përpiqesh të zëvendësosh gjithë atë pjesë edhe si drejtoreshë. Unë kisha dashtë që profesionalizmin tuaj vërtetë ta funksionalizoni dhe ta materializoni përmes një komunikimi që i takon një udhëheqësit arsimor. Tjetër, që është me interes po ashtu, është ajo se ka edhe ngatërime të Udhëzimit administrativ. E the që Kryetari i Komunës i cakton dy anëtarë të komisionit, njërin nuk e përcakton, atë të shoqërisë civile, ai e thotë që e ka të drejtën t'i emërojë ata anëtarë të komisionit dhe si të emëruar, pastaj në dokumentet përcjellëse të dy na dalin si përfaqësues të Komunës. E dini, në atë dokumentin përcjellës thotë përfaqësuesi i Komunës, përfaqësuesi i Komunës, përfaqësuesi i Ministrisë, kjo le të nënkuptohet që, pa kufizime, Kryetari ka të drejtë ta emërojë, por mirë ka qenë që ai të jetë i Komunës, udhëheqës arsimor, i cili e ka zhvilluar edhe një komunikim dhe ka një përvojë në atë drejtim. Nuk kisha dashtë që njerëzit mbi 70 vite t'i futni në komisione, sepse ata janë të pensionuar, pavarësisht se janë njerëz shumë të kualifikuar dhe kanë një përvojë, por me të vërtetë ata kanë mundësi të jenë subjektiv, bile të anojnë nga subjekti i Kryetarit, i cili edhe e ka emëruar. Kështu tregojnë relacionet e atyre që janë intervistuar. Sido që të jetë, Arsimi në Komunën e Prishtinës ka fituar një bazë dhe unë kisha dashtë, krejt në fund, ta them këtë, e ke Planin zhvillimor të

arsimit, atë plan e ka hartuar një grup i caktuar nga Drejtoria e Arsimit, asistencën teknike e ka udhëhequr ekipi i KEDS-it, mund të them, Dukagjin Popovci, profesor-doktor, dhe ai plan zhvillimor ka një kosto jashtëzakonisht modeste, sepse e ka pasur parasysh ai si bartës i asistencës teknike dhe ne si hartues, ku kemi punuar 3 ditë. Është plan jashtëzakonisht i mirë. Nëse arrin ta funksionalizosh, ta përdorësh këtë, të propozosh para këtij Kuvendi me projektet e mundshme që i ka ai plan zhvillimor, unë besoj që për 2, 3, 4 vjet, arsimit në Prishtinë do të jetë goxha mirë i kornizuar, edhe pse një bazë të mirë e ka, qoftë me zhvillimin e udhëheqjes arsimore, qoftë me zhvillimin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, dhe po ashtu edhe të lartë, qoftë me infrastrukturë shkollore, qoftë edhe me zhvillim profesional të arsimtarëve. Këtu tek zhvillimi profesional i arsimtarëve i përmende shumë elemente, edhe një duhet ta keni parasysh. I dini shkallët e licencave të rregullta një nga një, nëse keni kujdes këtu, nuk do të vije puna, përndryshe ata që janë të parregullt, na i thoni edhe me emra, mos hezitoni, sepse është kohë që duhet t'i themi me emra gjërat.
Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, Flamur!
Urdhëro, Kreshnik!

Kreshnik Ahmeti: Faleminderit, kryesues!

Vetëm për çështjen e fushatës dhe mediatizimit, ajo është e kuptueshme. Në vendet e zhvilluara, p.sh. ka shumë pak lajm kur punohet në rregull dhe mirë, për arsye se rregulli është normalitet, por në vendet në zhvillim, e sidomos si te ne, ku korrupsioni ka mbizotëruar qe 15 vite, atëherë sigurisht se rregulli dhe puna e drejtë përbën lajm dhe mediatizohet, e prej dikujt konceptohet si fushatë. Unë kisha vetëm një çështje për drejtoreshën, por po ashtu edhe për drejtorin e Administratës. Çka po ndodh me shkolla?! Po besoj, ju e dini edhe më mirë se unë, mesatarja në përgjithësi mund të del mirë me standarde sa është e përcaktuar për numër të nxënësve në klasa, por shumë prindër i qojnë fëmijët e tyre prej një lagje në lagjen tjetër, sepse e mendojnë se ajo shkollë është më e mirë, dhe kjo po bëhet nëpërmjet një lloj korruptimi, duhet me i thënë, të bashkësive lokale, të cilët lëshojnë certifikatë që ky filan banori është i asaj lagje, ku në fakt nuk është. Ndoshta duhet me pas një kujdes më të shtuar, një bashkëpunim së bashku me z. Muhedin, që me ndaluar këtë proces.
Faleminderit!

Flamur Shala: Si kontribut profesional, fushatës mediatike për të mirë ne do ti bëjmë hyzmet gjithë, sepse është në favorin e zhvillimit. Nëse e përmenda unë fushatën, e pata fjalën tek 100 vetë që i bëhen një bashkëngjitje, një paneli për intervistim të drejtorëve, apo zv.drejtorëve të shkollave. Unë besoj që aty nuk ka zhvillim normal të konkursit, prandaj më shumë i përngjan një fushate sesa një zhvillimi normal.

Ylli Hoxha: Këtu, Flamur, kur të mblidhemi nja 100 njerëz në sallë në proces të intervistimit, në këtë botën demokratike quhet proces transparent. D.m.th. mundësia që publiku me pa një proces të përzgjedhjes.

Çka ka pas Prishtina, ka qenë proces jo transparent!

Futja e publikut, është i gjithë publiku, nuk shkojnë aty militantë, nuk bëhet tubimi i këtij, i atij subjekti, mundesh me shkua edhe ti me përcjell procesin. Dhe, është një avancim i jashtëzakonshëm, i cili duhet ta kaplojë çdo post publik, mundësisht edhe jashtë Prishtinës, edhe përtej Prishtinës. Nuk është mirë me ofenduar në baza jo je prej këtu, jo prej aty. Prishtina është një... , i disa njerëzve që kanë ardhur prej gjithkrah, pra, përveç Shefkisë, të gjithë ne kemi ardhur prej dika! Dhe, e dyta, mosha nuk duhet të jetë kriteri diskriminues, pse është dikush 70 vjeçar, mund të jetë profesionist, ekspert. Pra, mos e ofendoni njeriun që është 70 vjet, se mund të jetë njeri shumë i mirë. Atëherë, ke kujdes, mos e ofendo drejtoreshën pse është nga Gjakova, se nuk ka faj për atë punë. Mos e ofendo njeriun që ka moshë dhe mos e keqkupto procesin. Transparenca është e domosdoshme në procese demokratike.

Faleminderit!

Kryesuesi:

Ju lutem, për mos me pas diskutime, le të zbatohet ligji, vetëm ligji le ta parasheh, d.m.th. një audiencë prej 50, 100 le të bëhet, vetëm ligji le ta parasheh, le të zbatohet ligji. Nëse është me ligj, drejtoreshë, ashtu vepro. Unë nuk e di që është me ligj, sinqerisht po të them. Por, është Ligji për arsimin, vetëm vepro sipas ligjit!

Urdhëro, Sylejman Pireva!

Sylejman Pireva: E përcolla me shumë vëmendje prezantimin e drejtoreshës, madje duke përcjellë erdha në përfundimin e një mbrese që vërtetë njerëzit në këtë qeveri nuk janë për t'u vajtuar, por janë për t'u përshëndetur për punën që e bëjnë, duke respektuar ligjin, duke respektuar transparencën, duke respektuar çdo gjë të mirë të fushës apo lëmit ku kryejnë punët e tyre.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Flamur, pate diçka?

Flamur Shala: Oj motër, nëse do me marr fjalën, ta jep kryesuesi, merre lirisht. Të lutem! Unë, veç po them kështu, ne në emër të terminologjisë që e përdorim shpesh herë, nuk guxojmë të dalim jashtë kufijve ligjor dhe është lehtë ta përdorim fjalën transparencë, më lehtë nuk ka! Ta zbatojmë atë është vështirë, e sidomos në këtë rast, kur dalin drejtorët atje para një paneli ligjor dhe nja 100 vetë, dikujt i rrahin shuplakë, e dikujt i thonë kuku po mirë e po keq dhe, në fund, i thotë dikush, hajt, cilin e kishe bë ti! D.m.th. jemi konkret. Sa për terminologji dhe sa për transparencën si dukuri dhe si element i demokracisë, ne mund të flasim bazuar në disa libra tjerë, jo në bazë të Ligjit për arsimin. Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Urdhëro, prof. Fetiu!

Feti Mehdiu: Faleminderit!

Unë, së pari do të them këtë, ne me arsim nuk sillemi mirë tek e kemi lënë ta diskutojmë pas 8 orësh pune këtu. Tjetra, drejtoreshës mund t'i ndihmojmë me një sugjerim kësaj: A është shqetësuese ajo gjendja, kur sot akoma ke arsimtarë të pakualifikuar, me kualifikime gjysmë etj, por edhe nuk ke rregullore se si punojnë drejtorët dhe zv.drejtorët?! Do të ishte mirë që me iu drejtuar edhe një herë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, të japë një sqarim dhe të na bje edhe neve këtu. Çka kanë bërë me inspektorët, që tash inspektorë shkolla nuk ka. E kemi diskutuar disa herë këtu, e do të ishte mirë që tash drejtoresha me insistuar me na nxjerr atë, ta shohim ku është Ministria, si i mbikëqyrë shkollat, qofshin çerdhet, shkollat fillore e me i shkua deri në fund. Pajtohem me disa sugjerime që u dhanë këtu, edhe shkollat private janë tonat, edhe ata janë fëmijët tanë, por sot unë nuk desha me fol hiq nga ai hidhërimi që pse me lënë këtë pikë në fund. Megjithatë, këto dy fjalë i pata. Drejtoresha të mund t'i sigurojë përmes Ministrisë, ta kërkojë që t'i jap ku është procesi i mbikëqyrjes së shkollave, inspektorët ku janë. Rregullorja, u tha që i kanë do plane këtu, ka plane, por një rregullore duhet të ketë shkolla se si do të sillet, norma të drejta, ne të gjithë kemi të drejta, po kur vjen puna tek përgjegjësia, ne ikim. Themi unë kam të drejtë, por përgjegjësi nuk kam! Ju faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Sa për informim, ekziston Ligji për arsimin dhe përcillet me udhëzime administrative. Urdhëro, Remzi!

Remzi Pacolli: Përshëndetje për të gjithë!

Desha vetëm një pyetje drejtoreshës, çështja e çerdheve me komunitetin. Deri ku ka shkuar procedura, a ka filluar ende me punuar ndonjëra, se kanë qenë disa termine që kanë me filluar në shtator, e tash është tetori, nëntori?

Sofije Bunjaku: Falënderoj për informacionin që na dhatë deri më tani, por isha në interesim, se e di që gjithë mësimdhënësit kemi problem me këtë, tek gjithëpërfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta nëpër klasa, që është një vendim jashtëzakonisht i mirë, se secili mësimdhënës d.m.th. e dimë çfarë do të thotë kjo dhe rëndësia e saj, por sa kishte pas mundësi që të kemi ne asistentë, pasi që prej nesh, në fund të fundit, kërkohet cilësia në arsim. Pra, nuk po di sa mundet me qenë një mësimdhënie cilësore, kur kemi një numër aq të madh të nxënësve dhe kemi raste të tilla brenda klase.

Sa kishte me qenë mundësi, d.m.th. a keni mundësi ju si Komunë të kemi asistentë nëpër klasa?

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Urdhëro, drejtoreshë!

Ju lutem, sa më shkurt!

Arbërie Nagavci: Faleminderit, kryesues!

Edhe unë mendova që është më mirë me fol shkurt, por po e shoh që ka nevojë raporti me qenë shumë më i detajuar dhe me jap informata shumë më të shumta. Faleminderit të gjithëve për kontributin tuaj dhe për gatishmërinë për bashkëpunim. Jam shumë e vetëdijshme se veç bashkë mundemi me pas sukses, por me një bashkëpunim konstruktiv, dhe ju lus që për çdo pyetje që keni, lirisht më njoftoni për çdo informatë, si këtu që u paraqitën, sepse ju sjellim të dhëna të plota për çdo çështje që mund të jetë me interes për ju, qoftë për statistika, qoftë për të tjera dhe jam e gatshme me diskutuar. Ndoshta u dashtë me lënë ashtu siç u përmend më herët, sepse është e dyta herë që po është diskutimi shumë vonë. Unë mbajta shënime, po mundohem të shkoj radhazi. Të dhënat e pjesës së dytë që i prezantova, për shkak të vizitave nuk janë përfshirë, sepse sapo kemi përfunduar këto vizita dhe ashtu siç e përmenda në fund, për të gjitha vizitat edhe në shkollat fillore, do të bëjmë një raport të detajuar dhe të cilin përveç që do ta qojmë në shkolla, do ta bimë edhe tek ju dhe pastaj edhe me emra e mbiemra. Mirëpo, natyrisht se do të marrim edhe nga një deklaratë paraprakisht edhe prej mësimdhënësve. Sa i përket çështjes së rregullores, unë, sinqerisht, kërkova mendimin dhe mendova që ndoshta ju jeni në njohuri. Jam shumë e vetëdijshme se ekzistojnë udhëzimet administrative dhe ligjet, i di me numra të gjithë, por në shumicën e komunave, e them me kompetencë të plotë, në Prizren p.sh., në Gjakovë dhe në shumicën e komunave të tjera, janë rregulloret e brendshme që janë aprovuar nga Kuvendi komunal. Ne kemi filluar të punojmë në këtë drejtim dhe do ta sjellim para jush një rregullore të tillë, por unë e them se nuk e kam gjet. Drejtor, unë nuk di si të veproj ndryshe. Në mbledhjen me të gjithë drejtorët, me 63 drejtorët, i kam pyet a ka ndonjë rregullore komunale, kam thënë se ish dashtë aprovuar në vitin 2004, asnjëri prej drejtorëve nuk më ka njoftuar. Kam pyet zyrtarisht të gjithë zyrtarët, përfshirë shefin e Arsimit dhe të gjithë të tjerët, asnjëri nuk ka njohuri. Kam kërkuar zyrtarisht nga zyrtarja, Nexha është këtu, i kam dërguar e-mail në formë zyrtare dhe i kam thënë a ka aprovuar Kuvendi komunal i Prishtinës ndonjë rregullore ku janë të përfshira të gjitha. I kanë shumica e komunave, nuk e kam gjetur, nuk e di a ka apo jo. Personalisht, e kam kërkuar në formë zyrtare, nuk e kam gjet, nëse ka një të tillë, të lutem na e sjell dhe ndoshta na ndihmon. Kjo është sa i përket kësaj. Unë e di se ka udhëzime. Të lutem, unë ju dëgjova juve të gjithëve. E gjitha çka kam gjet për shkollë të mesme, ma ka sjell një drejtor, me kompetencë të plotë tha kemi, thash të lutem ma sjell drejtor se na ndihmon. Kur e sjelli, kishte qenë vetëm masa disiplinore dhe vërejtjet ndaj nxënësve, kishte qenë vetëm rregullore se si duhet t'i ndëshkojmë nxënësit në shkollë. Të paktën, këtë unë e kam gjet, nuk po them që nuk ka, por se ka ofruar askush për mua deri tani. Do ta sjellim tek Kuvendi, do të kemi edhe përfaqësues, do t'iu lusim me marr pjesë në Komitetin për Arsim. Mendoj se është një diçka që kish me na ndihmuar në punë. Sa i përket planit zhvillimor, që e përmendët, ne e kemi pas parasysh, kemi hartuar një plan të veprimit. Jemi në përfundim të planit të veprimit dhe do ta kemi publik për vitin 2015, dhe kur kemi hartuar atë plan të veprimit me objektiva dhe synimet, qëllimet që ne i kemi për vitin 2015, kemi marr për bazë edhe objektivat që kanë qenë të përcaktuara në planin zhvillimor. E kam pa kush ka qenë grupi punues, d.m.th. e kam lexuar me vëmendje dhe i kemi pas për bazë për më tutje, sepse jemi shumë të interesuar që gjërat e mira që kanë ndodh, t'i vazhdojmë edhe më tutje. Sa i

përket statistikave, ekziston një planifikim, sepse në secilën komunë është numri i nxënësve të lindur dhe Komuna ua dërgon edhe shkollave, në mënyrë që nëse ndonjë nga prindërit nuk i paraqet krejt fëmijët, atëherë nga i njëjti duhet të kërkohen nga shkolla të kontaktohen prindërit. Nuk është shumë lehtësuese, sepse nuk i ka edhe adresat, por ekziston një i tillë. Pajtohem me atë që e tha Qëndroni ose Ylli, në lidhje me ato vërtetimet që i sjellin nga bashkësitë lokale, dhe ajo është një tjetër synim të cilën kemi të punojmë këtë vit shkollor. Sa i përket raportit, pajtohem, ndoshta është i mangët, kemi pasur ndoshta vështirësi, u përmenden edhe kapacitetet këtu, ju e përmendët edhe vetë se ka mungesë të kuadrove. Sa për informatë të atyre që nuk e dinë, në Drejtorinë e Arsimit janë vetëm tre zyrtarë të arsimit, është një numër shumë i madh i ekonomistëve dhe i të tjerëve, më shumë kemi ekonomistë në Drejtorinë e Arsimit sesa zyrtarë të Arsimit dhe, për fat të keq, tash ata zyrtarë i falënderoj që kanë punuar, dy zyrtarë të lartë të Arsimit, nuk kam një ndihmë shumë të madhe prej shefit të Arsimit dhe është një pengesë shumë e madhe për punën time. I përmendët edhe këtë gjithëpërfshirjen dhe mësimdhënësit mbështetës. Jemi në një proces, ku jo një numër shumë i madh të nxënësve i kemi të përfshirë në klasë të parë, ashtu si e kemi paraparë, por, për fat të keq, nuk ka mësimdhënës të mjaftueshme mbështetëse, apo asistente. E kemi në plan që për vitin e ardhshëm shkollorë, sepse ju e dini, drejtor, e ngritët edhe ju këtë çështje, i dini kufizimet buxhetore sa i përket numrit të lejuar të mësimdhënësve që bazohet në bazë të numrit të nxënësve dhe metrave katrorë. Kemi menduar që duhet të veprojmë në këtë drejtim, duke bashkëpunuar edhe me Fakultetin e Edukimit dhe të shohim se çka mund të bëjmë në këtë drejtim. Kemi takuar përfaqësuesit e prindërve të fëmijëve të verbër, të fëmijëve me sindromin Daun dhe jemi tu shikuar se cila është zgjidhja më e mirë që mund ta bëjmë për të krijuar një mësimdhënie sa më cilësore për këta fëmijë. Paralele të kombinuara, po, për fat të keq, kemi akoma, Qëndron, se u ngrit edhe prej z. Gashit dhe Qëndronit. Unë kam biseduar edhe me drejtorë të shkollave, janë disa paralele të kombinuara, nuk është çështja se ne nuk kemi mundësi të ofrojmë transportin, ne kemi ofruar një gjë të tillë, kemi gjithsej 31 linja të transportit që ne i ofrojmë dhe, në disa raste, edhe kur ka më pak se 4 kilometër, për shkak se kemi vlerësuar se rrezikshmëria për fëmijët është e madhe dhe ju kemi ofruar këtë transport, por këtu ka qenë sipas atyre që drejtorët i kanë thënë. Më shumë ka qenë çështje e komunitetit që nuk kanë dëshirë që të mbyllet ajo shkollë. Për ne janë me interes fëmijët, ata duhet t'i integrojmë në klasë të rregullta dhe kemi planifikuar që duhet të bëjmë vizita aty me komunitetin, që të vendosim se cila është zgjidhja më e mirë. Pra, edhe për ne ka kosto më të vogël dhe është më mirë për fëmijë sikur t'iu sigurojmë transportin. Sa i përket pyetjes për Gjimnazin Matematikor, janë gjithsej 23 nxënës, një pjesë e tyre janë nga Prishtina. Ministria ka premtuar që të gjithë nxënësve do t'u sigurojë udhëtimin, një shujtë dhe fjetjen. Nuk është i tipit konviktor, sepse nuk ka hapësira. Të martën e kemi edhe një takim të bordit drejtues të Gjimnazit Matematikor, në mënyrë që t'u definohen përfundimisht këto çështje. Kuadri janë, 4 mësimdhënës nga Universiteti dhe të tjerët janë mësimdhënës nga shkollat e Prishtinës. Sa i përket planifikimit, që e ngritët shqetësimin z.Gashi, për vitin e ardhshëm, ne tashmë e kemi përfunduar planin e prokurimit për vitin e ardhshëm, kemi planifikuar të gjitha projektet dhe besoj se jemi bukur mirë të përgatitur. E dimë që nevojitet punë, por është një proces që jemi në përfundim, e kemi përfunduar

planifikimin për vitin e ardhshëm. Znj. Kimet Zeqa e pat një pyetje shumë me vend, pse janë vetëm femra teprica teknologjike, ka qenë e përcaktuar në bazë të kriterëve, d. m. Th. fillimisht është marr për bazë kualifikimi dhe në kushte të barabarta ka qenë kriter që të largohet ai që ka ardhur i fundit në punë në këtë shkollë, mirëpo edhe për këto 3 mësimdhënëse jemi duke bërë përpjekjet maksimale, nuk është akoma definitive që nuk kemi me arrit me i sistemuar, por po provojmë që t'i sistemojmë edhe këto. z. Shala e ngritët çështjen e arsimit parashkollor. Unë mund t'ju sjell të dhënat për numrin e përgjithshëm, pajtohem se kanë munguar, mirëpo thjesht... unë i kam të dhënat këtu, nëse i doni të dhënat statistikore se sa nxënës janë regjistruar. Sa u përket këtyre çerdheve me bazë në komunitet, nuk e kanë filluar akoma punën, janë zhvilluar bisedat me komunitetin, janë përcaktuar bordet udhëheqëse të çerdheve, të cilat pastaj do të vazhdojnë. Është duke u zhvilluar kjo procedurë në katër çerdhe. Sa i përket përzgjedhjes së drejtorëve dhe zv. drejtorëve, e përmendët këtë në formë fushate. Nuk kanë qenë në formë fushate, është respektim i ligjit për zgjedhjen e drejtorëve. Është e vërtetë se janë zgjedhur 6 drejtorë dhe 4 zv. drejtorë, 2 prej zv. drejtorëve kanë qenë të njëjtit që kanë qenë edhe në mandatin e kaluar, d.m.th nuk ka qenë tendencë e jona të ndërmarrim diçka dhe Kryetari i Komunës e ka respektuar 100% vlerësimin e komisionit. Sa i përket përfshirjes së komunitetit, kjo është e rregulluar dhe është përmendur decidivisht, se kriteri kryesor për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv. drejtorëve të shkollës është vlerësimi i planit zhvillimor të shkollës, mbrojtja e të cilit duhet të bëhet në mënyrë publike. Kjo është e rregulluar me Ligjin mbi komunën me Udhëzimin administrativ 8/2014, që e përcakton zgjedhjen e drejtorëve, që i ka 4 lloje të formularëve që duhet të plotësohen. E përsëris edhe një herë, e përmendët që mbrojtja e planit zhvillimor të shkollës, që është kriteri kryesor për përzgjedhjen e një drejtori, apo zv. drejtori të institucioneve edukative, duhet të jetë publike. Për informatën e juaj, shembulli i Prishtinës është duke u marr si model. Shumë shpejt, ne jemi duke punuar së bashku me USAID-in në hartimin e një doracaku, dhe ky model i Prishtinës do të jetë edhe si bazë, do të organizohen trajnime për drejtoritë komunale të Arsimit në gjithë Republikën e Kosovës, ku do të trajnohen zyrtarët komunalë se si duhet të zgjidhen drejtorët dhe zv. drejtorët. Besoj se shumë shpejt ky model do të përdoret edhe në komunat tjera. Pajtohem me atë që e thatë në lidhje me trajnimin për udhëheqjen arsimore, është një kriter i Ministrisë i cili e përcakton, dhe ky ka qenë një ndër shkaqet se pse në disa raste është anuluar konkursi. Ky udhëzim administrativ për zgjedhjen e drejtorëve, e parasheh decitivisht se duhet të kenë të përfunduar një trajnim për udhëheqjen arsimore. Për fat të keq, këtë trajnim për udhëheqjen arsimore deri tani kryesisht e kanë përfunduar drejtorët që kanë qenë në pozitë ose ata personat që i kanë dërguar drejtorët. Unë kam.... vet këto kurse i kam mbajtur edhe këtu dhe e di që nuk iu ka dhënë mundësia të gjithë atyre që kanë pas dëshirë të vijojnë këto kurse. Ka qenë ndoshta edhe kriter i Ministrisë, por me njëfarë forme janë favorizuar vetëm drejtorët aktual. Për të dhënë mundësi të barabarta për të gjithë, ne, si Komunë e Prishtinës, kemi filluar, d.m.th. Drejtoria jonë personalisht ka filluar të bashkëbisedojë për arsimin themelor që përkrahet nga USAID-i. Ata kanë shprehur gatishmërinë dhe jemi në fazën finale të përfundimit, që të organizojmë trajnime profesionale për udhëheqjen arsimore për së paku dy grupe të mësimdhënësve të komunës së Prishtinës, të cilët i plotësojnë kushtet për të kryer këtë trajnim dhe për të

aplikuar pastaj për t'u zgjedhur drejtorë, në mënyrë që të krijojmë kuadro të njaftueshme, që të aplikon në rast se kanë në interesin e tyre. Po ashtu në lidhje me zhvillimin profesional të mësimitdhënësve, pajtohemi, e di që janë bërë njaft punë të mira në këtë drejtim, kam pasur mësimitdhënës të shumtë të komunës së Prishtinës me të cilët kam bashkëpunuar. Është pra një nga planifikimet dhe qëllimet tona për vitin 2015. Ne do të jemi shumë të fokusuar në zhvillimin profesional të mësimitdhënësve me bazë në shkollë, ku ata do të shkëmbejnë përvojat e tyre, sidomos në situatën shumë sfiduese që do të jemi në lidhje me implementimin e kornizës së re kurrikulare, që ka me qenë një sfidë në vete për të gjithë dhe për të cilët për kundër deklarimeve të vazhdueshme të Ministrisë, që jemi shumë mirë, unë nuk jam edhe aq shumë optimiste. Kemi planifikuar po ashtu disa aktivitete konkrete, p.sh. po planifikojmë për vitin e ardhshëm, që në shërbim të cilësisë të organizojmë mësimitdhënien me qëndrim tërëditor në së paku 5 shkolla pilot, dhe janë disa aktivitete të tjera me të cilat do të njiheni shumë shpejt, sepse e kemi bërë një plan të detajuar të aktiviteteve për vitin 2015. Ndiuni, ju lutem, të lirshëm, që të më rekomandoni, apo të më sugjeroni. Jam e interesuar të bashkëpunoj, po e përsëris, në aspektin profesional, por tërësisht me qëllim të profesionalizimit dhe të korrektësisë, pa marrë parasysh, me të gjithë a jeni të Prishtinës, a të Gjakovës. Sa për ata, Yll, që e përmendët që jam e Gjakovës, ndihna shumë mirë që jam e Gjakovës dhe ndihna shumë mirë që jam duke punuar në Komunën e Prishtinës.
Faleminderit!

Kryesuesi : Faleminderit!

Tash je në Prishtinës, sigurisht , pasi ke ardhur në Prishtinë.

Ju lutem, sa më shkurt, po e shihni kohën!

Urdhëro, Flamur!

Flamur Shala: E thotë Udhëzimi administrativ ashtu si e tha Drejtoresha, edhe pse ajo pjesë ndoshta edhe nuk më ka rënë në sy, por, megjithatë, kjo nuk nënkupton që mbrojtja publike e planit zhvillimor të shkollës nga ana e një konkurenti, një kandidati, të mbrohet para një auditoriumi me preferenca politike aty, prej lagjeve të caktuara apo prej komunitetit të caktuar, dhe kjo po ndodh në Komunën e Prishtinës.

Faleminderit!

Kryesuesi : Ju lutem, mos ndërhyjni!

Është çështja e informatës për Arsimin, mundet me u përgjigj drejtoresha.

Arbërie Nagavci: Faleminderit z. Shala, se harrova me përmend këtë detaj që e theksuat, shumë të rëndësishëm, faleminderit që ma sollët ndërmend. Parashihet që mbrojtja e planit publik, d.m.th. ne kemi marr vendim që të mbahet në shkolla në të cilat kanë konkurruar kandidatët. Pra, nëse bëhet fjalë për emërimin e drejtorit në shkollën "Hilmi Rakovica", intervista është mbajtur në shkollën "Hilmi Rakovica", nëse bëhet fjalë për zgjedhjen e drejtorit në shkollën "Dardania", intervista është mbajtur në shkollën "Dardania". Ne kemi pas në ueb-faqen e Komunës orarin e intervistave, kemi njoftuar zyrtarisht drejtorët e shkollave dhe kemi nxjerr një vendim në shkollë. Të ftuar për të

marr pjesë kanë qenë mësimdhënësit e shkollës dhe përfaqësuesit e prindërve. Parashihet, d.m.th. mbrojtja publike, unë nënkuptoj që kjo është diçka publike, nuk e di se si është ndryshe. Dhe, për atë që ju përmendët, unë personalisht nuk i kam bërë asnjë kandidati, asnjë, dhe kjo është shumë publike, veç e përmendet, shumë mirë që nuk i ke informatat e sakta, po ta siguroj që nuk e ke të sakta. Unë kam marr pjesë vetëm në disa prej intervistave, vetëm si vëzhguese. E tëra që kam bërë është, që kam falënderuar komunitetin që ka marr pjesë në këto intervista dhe nuk kam bërë asnjë pyetje, asnjë ndërhyrje në proces. Nuk kam qenë në të gjitha proceset, kam qenë vetëm në disa prej tyre, kur kam pas kohë. Kanë marr pjesë nxënës, është e lejueshme. Në Gjimnazin "Sami Frashëri" kanë marrë pjesë nxënës. Tash mundem edhe unë me lexuar edhe një herë, se ndoshta paskështa harru, por edhe ju z. Shala, dhe e diskutojmë pastaj.

Kryesuesi: Ju lutem!
Urdhëro, Flamur!

Flamur Shala: E dini ju Ligjin e Arsimit Parauniversitar, përmendet formimi i Këshillit të shkollës dhe në mbledhjet e Këshillit të shkollës, bordit të shkollës, nuk merr pjesë nxënësi i asnjë niveli që është pjesë e Këshillit të shkollës kur flitet për profesorin, për zv. drejtorin, për Këshillin e shkollës. Ku i jepet e drejta një nxënësi të merr pjesë në mbrojtjen publike të planit zhvillimor të një drejtori! D.m.th. këtu lidhet logjikisht që nxënësi nuk duhet të jetë i ballafaquar me panelin dhe me një kandidat, i cili nesër bëhet drejtorë, zv.drejtorë ose mësimdhënës. Këtu është esenca.

Kryesuesi: Nuk kemi nevojë me bërë debat këtu. Ne do të kërkojmë interpretim ligjor prej Ministrisë, a është, apo jo. Drejtoresha thotë është, Flamuri nuk është, mundemi me kërkuar një interpretim ligjor.
Urdhëro, drejtoreshë!

Arbërie Nagavci: Zotëri Shala, Ligji për Arsimin Parauniversitar, neni 17, i cili rregullon punën e Këshillave drejtues të shkollës, parasheh se të gjitha institucionet edukativo-arsimore të nivelit të dytë dhe të tretë, gjegjësisht të shkollave fillore të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, duhet të kenë edhe përfaqësuesin nga radha e nxënësve. Përfaqësuesi nga radha e nxënësve merr pjesë në mbledhjet e rregullta të Këshillit drejtues të shkollës, me përjashtim të rasteve kur kemi të bëjmë me ndonjë çështje të ndjeshme, për të cilën Këshilli vendos që nxënësi nuk duhet të marrë pjesë. Kjo është decizivisht kështu e përcaktuar në ligj.

Kryesuesi: U kry, d.m.th. diskutimi, për këtë nëse mundemi të kërkojmë interpretim ligjor edhe prej Ministrisë së Arsimit ose atyre që kanë nxjerr ligje.
A ka dikush diçka lidhur me Informatën?
Ju lutem, shumë shkurt!
Nëse jo, atëherë dëgjuam informatën prej drejtoreshës, edhe atë me shkrim, edhe diskutimet.

Pika e katërbëdhjetë e rendit të ditës:

Faqe 98 nga 100

Informatë rreth mbjelljeve vjeshtore.

Kryesuesi: Urdhëro, drejtor!

Genc Bashota: Faleminderit!

Ju e keni këtë informatë së fundi, pas 8 ore, pra po e shkurtojë pak.

Është një informatë e shkurtër, të cilën e keni, nuk e di a është e arsyeshme me i ripërsëritur, por, atëherë po mundohem sa më shkurt. D.m.th. procesi i mbjelljeve vjeshtore është në vijim e sipër. Në komunën e Prishtinës janë planifikuar të mbillen 1245 ha, prej të cilave me grurë 1190 ndërsa 55 me bimë të tjera. Deri tani janë mbjell 65 apo afër 70% e sipërfaqes, përfundon diku në muajin nëntor. Komuna e Prishtinës i ka kryer të gjitha parapërgatitjet sa i përket të mbjellave vjeshtore, përfshirë edhe subvencionimin e fermerëve. Janë ndarë 110.000 € për Sektorin e bujqësisë për subvencionimin e fermerëve. Aplikimi për subvencionim ka zgjat prej 8 tetorit deri më 23 tetor. Ata do t'i marrin këto mjete diku nga gjysma e nëntorit. Përndryshe, do të përfitojnë të gjithë fermerët që kanë 1-2 ha tokë. Kjo ishte po më duket edhe në mbledhjen e kaluar si çështje, për shkak se Ministria po jep për mbi 2 ha, që mos me ardhur te ndonjë duplikim, ne e kemi qit si kriter 1-2 ha, që mos me marrë ata dy herë, d.m.th. me përfitua prej subvencionimit. Një problem që mund të veçohet, është vetëm kualiteti i farave dhe i plehrave, i cili vazhdimisht po përsëritet se është i nivelit të ulët, por kjo nuk është kompetencë e Komunës, është kompetencë e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë. Kjo është sa i përket kësaj informate të shkurtë. Nëse ka diçka, pyetje, komente, urdhëroni.

Kryesuesi: Faleminderit!

A ka dikush diçka të thotë?

Urdhëro, Sylejman!

Sylejman Pireva: Përkitazi, me të mbjellat e sezonit vjeshtor, që në fillim mund të them që mungesa e Drejtorisë së mirëfilltë të Bujqësisë në Komunë, mund të them që është një hendikep për të pasur një punë sigurisht më të suksesshme nga kjo Drejtori, sepse një sektor mendoj se nuk është e mjaftueshme për të përcjellë gjithë gjendjen e bujqësisë në territorin e Komunës së Prishtinës. Nga ekspertët e bujqësisë, thuhet se ndihet mungesë e mjaftueshme e mekanizmit bujqësor, kështu është konstatim i tyre. Thuhet se për shkak të motit të lig, në këtë vjeshtë ka pasur vonesë në korrje të misrit dhe nxjerrjes së patateve, sipërfaqe të cilat kanë qenë ndoshta të planifikuara që të mbillen edhe me grurë, dhe kjo mund të jetë vonesë ndoshta edhe një huqje e kësaj. Pastaj, mungesa e një afati më të gjatë për marrjen e subvencioneve nga bujqit dhe fermerët, konsiderohet se nuk është e mirë, dhe kjo është mirë të zgjatet për një afat më të gjatë. Tjetër, mungesa e kontrollit të mjaftueshëm të sipërfaqeve të mbjella dhe mospërputhja shpeshherë me gjendjen në terren me parcelat e mbjella dhe fletat poseduese që mund të arrihet në bazë të shfrytëzimit nga ortofotot e vitit 2009, vërehet që edhe kjo nuk është shumë e rregullt. Pastaj, mungesa e mjaftueshme e bashkëpunimit midis Sektorit të bujqësisë, por edhe Sindikatës së Bujqve, pastaj bashkëpunimi i Komunës me ekspertë të Fakultetit të

Bujqësisë përkitazi me sëmundjet e grurit, sidomos në periudhën janar-prill dhe Këshillimi i bujqve dhe fermerëve për masat që duhet ndërmarrë, pastaj kryerja e analizës së tokave në llojin e farës...

Po e lë atëherë pasi nuk ka interesim. E kreuva.

Kryesuesi: D.m.th. interesimi i të tjerëve është i vogël, e pash që edhe nuk po dëgjohet. Pra, e përkrahim si informatë.

Pika e pesëmbëdhjetë e rendit të ditës:

Pyetje - përgjigje

Kryesuesi :

A ka dikush diçka me pyet?

Jo.

Pika e gjashtëmbëdhjetë e rendit të ditës:

Të ndryshme

Kryesuesi: Të ndryshme?

Nuk kemi!

Ju faleminderit shumë për durimin që keni pasur!

Mbledhja përfundoi në orën 18:15.